

Rasti Sela Alimi dhe Zeqiri identifikojnë sulumuesit e Selës

Fq.5



"YAHYA KEMAL" Aty ku s'bëhet kompromis me cilësinë

Fq.7



E dija që në shtator se Siti do ta fitonte titullin

Fq.22



Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3343 · e martë 17 prill, 2018

11°C | 23°C

15 DEN



KOHA për
kulturë

Fq.12-15

EDITORIAL

Kufijtë e revoltës qytetare



Revolta qytetare paraqitet gjithmonë kur mbyllen ventilat e komunikimit dhe funksionimit në mes të institucioneve dhe njerëzve që kanë halle. Në lagjen Gjorge Petrov të Shkupit para dy netësh shpërtheu një revoltë mjaft e bujshme e banorëve të cilët protestonin pas aksidentimit të një fëmije nga ana e vozitësve të pakujdesshëm...

Fq.2

RAJON

Iranianët që kërkojnë azil në Beograd

Fq.16

GLOBI

Turqia në BE më larg se kurrë

Fq.17

FORUM

Menduh Thaçi!

Fq.10



SOT PUBLIKOHET RAPORTI PËR BALLKANIN PERËNDIMOR

KËSAJ RADHE PA KUSHTE



Në Raport thuhet se dëmi që është bërë gjatë viteve të kaluara nuk mund të rregullohet brenda natës, por se Maqedonia e ka tejkalar krizën e thellë, ndërsa reformat strukturale janë proces i komplikuar që mund të zgjasë. "Për përparim të mëtejme, të rëndësishme janë realizimi dhe thellimi i procesit për zbatimin e reformave urgjente prioritare", citojnë mediat Raportin e progresit për Maqedoninë

Fq.3

Nis shqyrtimi i ankesave, hiqen 10 projekte

Shkup, 16 prill - Shqyrtimi i ankesave për projektet me interes nacional që kanë konkurruar në Programin vjetor të Ministrisë së Kulturës tashmë ka filluar. Nga ky institucion nuk japin ndonjë informacion lidhur me numrin e ankesave të cilat iu janë drejtuar, përveç se rezultatet për projektet e rishikuara do të jenë gati pas dy javësh. Një prej komisioneve, ai i veprimtarisë skenike i ka gati rezultatet, ndërsa

pritet të fillojnë ato të Muzikës, Folklori, Botimet..., ku edhe vëllimi i punës do të jetë më i madh. Një ditë më parë, ministri i Kulturës, Robert Allagjozovski, gjatë një vizite në burgun e Shutkës, ka lënë të kuptohet se rishqyrtimi i një pjese të ankesave kushtëzohet nga mundësitë financiare që ka Ministria e Kulturës. "Sa i takon ankesave, për momentin komisionet janë duke i marrë në shqyrtim..."

Fq.4



EDITORIAL

KUFIJTË E
REVOLTËS QYTETARE

Emin AZEMI

Revolta qytetare paraqitet gjithmonë kur mbyllet ventilat e komunikimit dhe funksionimit në mes të institucioneve dhe njerëzve që kanë halle. Në lagjen Gjorqe Petrov të Shkupit para dy netësh shpërtheu një revoltë mjaft e bujshme e banorëve të cilët protestonin pas aksidentimit të një fëmije nga ana e vozitësve të pakujdesshëm. Aksidente të ngjashme në këtë lagje kishte patur edhe më herët dhe pakënaqësia mund të jetë gjithmonë evidente kur një dukuri negative përsëritet. Banorët e kësaj lagjeje të Shkupit protestën e tyre e kishin shndërruar në demonstrim publik të një revolte, e cila mundet të manifestohej edhe në forma të tjera. Një peticion ka mjaftuar të fokusojë gjithë brengat e këtyre banorëve, duke insistuar që pjesëmarrësit në trafik të tregohen më të vëmendshëm, por në anën tjetër duke kërkuar nga organet kompetente që të forcojnë masat ndëshkuese ndaj gjithë atyre që shkaktojnë fatkeqësi në këtë lagje, por edhe në lagjet tjera. Kjo revoltë e banorëve të Gjorqe Petrovit nuk do të na bënte kësaj radhe gjithaq përshtypje, sikur të mos na kujtoheshin pamjet e para 3 viteve, kur u dogjën dyqanet e shqiptarëve po në këtë lagje pas një zënke që kishin patur dy të rinj shqiptarë dhe maqedonas, e cila kishte përfunduar tragjikisht me humbjen e jetës së të këtij të fundit.

Çka është puna me këta banorët e Gjorqe Petrovit, të cilët të gjitha mosmarrëveshjet duan ti zgjidhin, ose me bllokim rrugësh, siç ndodhi para dy ditëve, ose me djegie të dyqaneve të shqiptarëve, siç ndodhi para tre viteve. Në Kumanovë, para dy viteve një fëmijë shqiptar 4 vjeçar u godit për vdekje nga një bashkëqytetar maqedonas me kombësi serbe. Historia e kësaj ngjarjeje tash më është e njohur për gjithë opinionin publik, mirëpo askush nga shqiptarët nuk dogji ndonjë prone të maqedonase. Pati vetëm protesta civile, shume dinjitoze dhe me dedikim të veçantë, që diferenconte përgjegjësitë institucionale nga ato individuale. Nëna e djaloshit të vrarë madje mbajti një fjalim mjaft dinjitoz, që linte të kuptojë se humbja e fëmijës së saj nuk duhej të na shërbejë për hasmëri të reja, por gjithsesi fajtori duhej të merrte dënimin e merituar, në mënyrë që fëmijët tjerë të shpëtonin nga vrasësit potencial që mund të kenë mbrojtjen e institucioneve.

Kufijtë e revoltës qytetare nganjëherë kalojnë nëpër fusha të minuara që qytetarët qëllimisht i vendosin për të shumëfishuar pakënaqësitë. Ajo çka kishte ndodhur në Gjorgje Petrov mund të ndodhë në çdo rrugë urbane të Parisit, Berlinit, Londrës, madje bilanci i viktimave atje mund të jetë më i lartë, mirëpo menaxhimi i pakënaqësive ndjek një ritëm dhe fizionomi tjetër sociale e urbane. Në Perëndim, pakënaqësitë qytetare mund të jenë edhe më brutale, mirëpo kjo ndodhë vetëm atëherë kur prishen balancet e drejtpeshimit në mes të institucioneve dhe qytetarëve. Në Gjorgje Petrov askush nga institucionet nuk kishte refuzuar të ndjekë shkelësit e trafikut, duke i sjellë ata edhe para drejtësisë për kundërvajtjet që i kishin bërë. Në Gjorgje Petrov banorët duan të na tregojnë se ata vetë janë shteti dhe sa herë t'u tekton mund të djegin e shkatërrojnë, dhe për këtë të mos japin kurrfarë përgjegjësie. Sikur këta banorë të kishin marrë dënimin e merituar para tre viteve kur dogjën e shkatërruan pronat e shqiptarëve, ata sot nuk do të guxonin të tregohen kaq arrogant me pushtetin vendor, shoqëruar edhe me bllokim rrugësh.

Mirëpo kur janë në pyetje banorët maqedonas të lagjeve të Shkupit, gjithçka është e lejuar, madje edhe atëherë kur ngelin të pandëshkuar pas një sërë rrahesh të nxënësve shqiptarë nëpër autobusët urbane të këtij qyteti. Kështu është kur pakënaqësia qytetare merr ngjyrim banditesk, kurse shteti praktikon qasje selektive, duke toleruar "kau-bojt" urban të bëjnë ligjin nëpër lagje të caktuara ku gjuha shqipe as zyrtarisht as privatisht nuk mund të dëgjohet publikisht. Atje pronarët e gjuhës nuk guxojnë të tregojnë se janë shqiptarë sepse mund t'iu digjen shtëpitë dhe dyqanet. Edhe ky është një "progres" që duhet ta evidentojë Komisioni Europian.

TRANZIT NË VENDIN TONË?

"Në Kosovën tonë vetëm çdo i katërti qytetar i aftë për punë është i punësuar, dy prej tre të rinjëve nuk janë të punësuar dhe vetëm çdo e teta grua ka një vend pune. 3/4 e të papunëve janë të papunë afatgjatë, pra për më shumë se 12 muaj. Dhe, 1/3 e të rinjëve të moshave midis 15 dhe 24 vjeç nuk janë as të punësuar, as në shkollim e as në ndonjë trajnim. Shkalla e punësimit tek këta është vetëm 8,5%. Shumica e të punësuarve në Kosovë nuk janë të punësuar në profesionet e tyre dhe mbi 20 mijë të diplomuar në universitet janë të papunë. Arsimin e kemi të dobët, ekonominë e kemi të dobët, lidhjen e arsimit me ekonominë e kemi të dobët. Kur bisedoj me qytetarë të komunave e moshave të ndryshme, asnjëri prej tyre nuk më thotë që don para, dhe, pothuajse të gjithë më thonë se duan punë.

Njerëzit tanë duan të fitojnë me punë, nuk janë hajna, nuk duan të vjedhin. Ndërkohë, qeveritarë që kanë nga disa vende pune vjedhin për vete e nuk punojnë. Partnerë e ish partnerë të koalicioneve qeverisëse kanë hall vetëm se a do t'i bie autostrada e re kah tokat e tyre të blera rishtas, a do ta marrin hisen e tyre nëpër borde agjencish e ndërmarrjesh, a do ta fitojë filan tenderin fistek biznesmeni i afërt me ta...

Me këso qeverish më shumë kanë frikë të punësuarit që do të mund ta humbin vendin e punës sesa që kanë shpresë të papunët që do të mund të gjejnë një vend pune. Përqendrimi i qeverisë në autostrada është si të shesësh shtëpinë për të blerë veturë. Pra, s'ka më shtetndërtim e zhvillim, sepse s'ka punësim e siguri, arsim e shëndetësi, por ka veçse mundësi qarkullimi e udhëtimi, thua se jemi tranzit në vendin tonë! Sipas të dhënave nga tetori i vitit 2016 i Raportit të FMN World Economic Outlook, 85% e ushqimit në botë është prodhim vendës, prandaj ushqimi përbën vetëm 8% të tregtisë globale. 30% e punëtorëve në botë punojnë në agrikulturë. Toka e punuar nga ajo e punueshme në Azi është 98%, kurse në Evropë është 90%. Mesatarja botërore është 80%. Në Kosovë, mezi 50%. Kosova i ka 74.000 hektarë për ujti mirëpo vetëm 12.000 hektarë ujiten. Kjo është arsyeja pse në Kosovë mbillen aq shumë gruri e misri të cilave nuk u nevojitet ujti përveç shirave.

Për pasojë, raportin eksport/import me Serbinë e kemi 1/13 ndërsa edhe me Bosnje dhe Hercegovinën e kemi 1/10!

Tejet të shtrenjta janë këto qeveri të njëjta, për të tashmen e për të ardhmen tonë. Sigurisht që nuk ua kishim borxh. Sigurisht që nuk ia vlen barra qiranë", shkruan Albin Kurti në profilin e tij në Facebook.

AKTET E DHUNËS DHE SHTETI LIGJOR

"Aktet dhunuese të zyrtarëve të BDI-së tregojnë se shteti ligjor aspak, nuk funksionon, pasi që nuk mbahet mend një njeri i mbrojtur i BDI, ti përgjigjet ligjit dhe drejtësisë. Ndodhi vrasja në Reçicë të Vogël, u rrahën profesorët në shkollë në Gostivar me mjete të forta duke përfunduar në spitale, shtrohet pyetja cili është caku i ardhshëm i njerëzve të pandërgjegjshëm të BDI-së?!", shkruan në profilin e tij në Facebook, kryetari i Komunës së Gostivarit, Arben Taravari.



MEDIACitate

TË NDRYSHOJË
BALLKANI
PRAKTIKAT E JO
BE-JA

Kryeministri i Bullgarisë, Boyko Borissov i cili sot dje kishte arritur në Kosovë, takimin e parë e kishte realizuar me presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, ndërsa është prituri edhe nga kryeministri Ramush Haradinaj. Thaçi në një konferencë për medie me Borissov, e falënderoi atë dhe shtetin bullgar për fqinjësinë e mirë, pajtimin, paqen dhe stabilitetin. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi ka dekoruar edhe me medalje kryeministrin bullgar, Boyko Borissov. Thaçi e dekoroi me medaljen presidenciale të 10 vjetorit të pavarësisë. Borissov u ka bërë thirrje liderëve të Ballkanit Perëndimor që të lënë me një anë egoizmat personale ngase kjo sipas tij, është fatale për të ardhmen e këtyre shteteve. Borissov tha se Kosova dhe Serbia janë të obliguar të zgjidhin problemet e tyre. "Kaluan shumë vite, para disa viteve kam ardhur këtu për të vizituar dhe ne kemi për përparimin që është arritur gjatë këtyre 10 viteve dhe keni zgjedh rrugën e drejtë. Kur jam në Beograd me miqtë e mi gjithmonë e përmend shokun tonë Hashim Thaçi. Prandaj duhet të vazhdojë dialogu, sepse në Bashkimin Evropian do të pranohen shtete pa probleme. Nuk keni alternativë, ju jeni të obliguar të zgjidhni problemet me Serbinë. Nuk duhet të kthehemi në të kaluarën. Shpresoj sinqerisht që midis Shkupit dhe Athinës të zgjidhin problemet. Ne me Maqedoninë dhamë shembullin e mirë. Ju jeni të detyruar bashkë me Serbët t'i zgjidhni mosmarrëveshjet atëherë Bashkimi Evropian do të shoh me sy tjetër pjesën tonë. Tani i propozoj kryeministrin që të organizoj një vizitë në Bullgari me ministra kosovarë, të vizitojnë edhe sektorin e turizmit sepse në Kosovë ka vende shumë të mira dhe mund të ndihmojmë me investime. Borissov thotë se perspektiva Evropiane e Ballkanit është e padiskutueshme, por për këtë qëllim duhet të ndryshoj Ballkani praktikat dhe jo BE-ja për hir të Ballkanit", tha ai, transmeton Koha.net.

(Koha DITORE, 16 prill)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

Çfarë dihet për Maligradin?

Maligradi është ishull i vogël i pabanuar në liqenin e Prespës së Madhe, ku në shek.XIV është ngritur një kishë brenda një guve shkëmbore. Është e përmendur për ansamblin me piktura bizantine të stilit paleolog. Piktura në fasadë e veçanërisht portreti monumental, i vendosur përballë rindërtuesit të kishës, princit Çezar Novak të plakur, shënon një nga arritjet më të larta të pikturës bizantine të kohës.



Ansambli dëshmon për gjallërimin e jetës artistike të feudalëve të vegjël pas vdekjes së car Stefan Dushanit (viti 1355) në kohën e principatave të pavarura shqiptare.

KE SOT PUBLIKON RAPORTIN E PROGRESIT PËR BALLKANIN PERËNDIMOR

KËSAJ RADHE I PAKUSHTËZUAR

Në Raport thuhet se dëmi që është bërë gjatë viteve të kaluara nuk mund të rregullohet brenda natës, por se Maqedonia e ka tejkaluar krizën e thellë, ndërsa reformat strukturale janë proces i komplikuar që mund të zgjasë. "Për përparim të mëtejshëm, të rëndësishme janë realizimi dhe thellimi i procesit për zbatimin e reformave urgjente prioritare", citojnë mediat Raportin e progresit për Maqedoninë



KUKAN, PROGRES I KONSIDERUESHËM I MAQEDONISË

Eurodeputeti Eduard Kukan i ka thënë Dojçe Veles se Maqedonia ka bërë një progres të konsiderueshëm në vitin e fundit. Ai shton se kryeministri aktual Zoran Zaev po drejton një politikë të jashtme dinamike dhe po përpiqet t'i zgjidhë çështjet e hapura. "Ndodh shpesh që shtetet anëtare nuk i bazojnë pozicionet e tyre në

rezultatet që arrin një shtet në procesin e integritimit evropian, por në çështje politike dhe bilaterale. Unë do t'i bëja thirrje Këshillit që t'i vlerësojnë në mënyrë objektive rezultatet e arritura nga Shqipëria dhe Maqedonia në rrugën e tyre drejt BE", tha Kukan.

tiv, meritat i takojnë edhe Lëvizjes BESA që me deputetët e saj në Parlament kanë bërë të mundur kalimin e ligjeve reformuese. "Nga ajo që është bërë deri më tani, presim që Maqedonia të marrë vlerësim pozitiv në Raportin e progresit që do të publikohet nesër (sot) nga Komisioni Evropian. Ka edhe shumë punë për të bërë, sidomos në gjyqësi dhe në shërbimin inteligjent. Padyshim që meritat në rast të raportit pozitiv janë edhe të Lëvizjes BESA, e cila përmes deputetëve të saj në Parlament, ka bërë të mundur kalimin e ligjeve reformuese", tha deputeti Rexhep Memedi nga Lëvizja BESA. Ndërkaq deputeti i ASH-së, Syrja Rashidi, tha se partia e tij ishte vendimtare në formimin e Qeverisë reformatore, por që më pas, siç shtoi ai, nuk u çmua si duhet roli i ASH-së nga ana e kryeministrit Zoran Zaev.

"Reformat në gjyqësor edhe përkaj kuadrit ligjor që ka filluar të ndryshohet, shkojnë ngadalë. Qeveria ka një qasje selektive ndaj trajtimit të shqiptarëve në shumë sektorë, sidomos në atë të drejtësisë. Duhet punë dhe vullnet më i madh që të zbardhen shumë raste të montuara nga të cilat kanë pësuar më së shumti shqiptarët. Nuk mund të pretendojmë BE-në pa u sqaruar shumë dilema dhe me shqiptarë të pafajshëm në burgjet e Maqedonisë", tha deputeti Rashidi.

Ekspertët në përgjithësi, pavarësisht Rekomandimit pozitiv, thonë se Maqedonia ende është larg standardeve të konvergencës, siç është borxhi i jashtëm, inflacioni, deficitin... Sa i përket marrëdhënieve ndëretnike, ende ka shumë punë për të bërë drejt avancimit të tyre, meqë sipas kriterit politik, Maqedonia duhet të jetë stabile si brenda - ashtu dhe në raport me shtetet tjera, gjë që nuk ka ndodh deri më tani siç presin në mënyrë konstante nga BE, vlerësim ky i ekspertëve të çështjeve evropiane.

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 16 prill - Maqedonia pritet të marrë Rekomandim të pakushtëzuar për fillimin e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian, ndërkaq nga vendet tjera - vetëm Shqipëria do të fillojë negociatat për anëtarësim në BE njëjtë siç ndodhi me Malin e Zi dhe Serbinë vitin e kaluar. Një ditë para se të publikohet Raporti i progresit për vendet e Ballkanit Perëndimor, Brukseli zyrtar ka theksuar se kur bëhet fjalë për Maqedoninë, Raporti do të jetë përgjithësisht pozitiv duke u vlerësuar puna e Qeverisë së re reformatore të Zoran Zaevit, si dhe do të inkurajohet e njëjta për zgjidhjen e çështjes së emrit me Greqinë, si dhe çuarjen përpara të reformave strukturore në vend.

Në Raport thuhet se dëmi që është bërë gjatë viteve të kaluara nuk mund të rregullohet brenda natës, por se Maqedonia e ka tejkaluar krizën e thellë, ndërsa reformat strukturale janë proces i komplikuar që mund të zgjasë. "Për përparim të mëtejshëm, të rëndësishme janë realizimi dhe thellimi i procesit për zbatimin e reformave urgjente prioritare", citojnë mediat Raportin e progresit për Maqedoninë. "Është fakt se kemi punuar dhe me të vërtet Maqedonia meriton rekomandim pa kushte nga Brukseli", deklaroi të hënën kryeministri Zoran Zaev në lidhje me shpalljen e Raportit të Komisionit Evropian (KE) dhe ardhjes në Shkup të përfaqësueses së lartë për

Punë të Jashtme dhe Siguri Politike, Federica Mogherini dhe eurokomisarit Johannes Hahn.

"Të rëndësishme për mua janë fjalët e Rekomandimit, se për ne do të jenë inkurajim ose dekurajim. Kjo është e rëndësishme edhe për qytetarët dhe për të gjithë proceset reformuese. Pas këtij Rekomandimi, Maqedonia vazhdon me reformat. Nëse vërtet vërtetohet ajo se çka është punuar, presim Rekomandim të pastër pa kushte. Besoj se me meritë do ta marrim dhe kjo do të jetë një motivim për vazhdimin e mëtejshëm të reformave", deklaroi Zaev pas përfundimit të seancës gjyqësore për rastin "Ryshfeti". Si për vendet tjera të Ballkanit Perëndimor, ashtu dhe për Maqedoninë, kritikantët e Brukselit do të jenë në drejtim të luftës kundër korrupsionit, krimin të organizuar dhe sundimit të Ligjit si lirive dhe të drejtave të njeriut dhe mediat e lira. KE përsëri në shumë raste e përdor shprehjen "shtete të kapura" për vendet e Ballkanit Perëndimor.

"Administrata publike në ven-

det e rajonit mbetet e dobët dhe pak ose aspak nuk ka përparim në fushën e lirisë së shprehjes", qëndron më tej në Raport. Vlerësime pozitive, siç njofton edhe Radio Evropa e Lirë, ka marrë edhe Shqipëria, madje nga vendet e rajonit, mund të thuhet se Tirana zyrtare është shpallur "kampionë" në implementimin e reformave. Raporti për Kosovën dhe Bosnjën është me i keqi, ndërsa theksohet se reformat e filluara janë ngadalësuar. Për Malin e Zi thuhet se ka përparim në letër, por në praktikë - ka ngecur. Serbisë do t'i rekomandohet që mund të arrijë BE vetëm me reforma dhe dialog me Kosovën. Ndryshe, një ditë pas shpalljes së Raportit për Maqedoninë, më 18 prill Shkupin do ta vizitojnë dy zyrtarët e lartë të BE, Federika Mogherini dhe Johannes Han në kuadër të qëndrimit të tyre në Ballkanin Perëndimor, ku përveç Maqedonisë - do të vizitojnë edhe Shqipërinë, Malin e Zi dhe Serbinë. Vizita do të pasojë diskutimet për Ballkanin Perëndimor në Këshillin për politikë të Ja-

shtme në Luksemburg më 16 prill dhe miratimin e pakos së zgjerimit që do të paraqitet nga zonja Mogherini dhe komisionari Johannes Hahn në Strasburg më 17 prill. Vizita ndodhë një muaj para takimit të lartë ndërmjet Bashkimit Evropian dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor në Sofje të Bullgarisë më 17 maj. Në prag të vizitës, zonja Mogherini tha se Ballkani Perëndimor është Evropë dhe do të jetë pjesë e së ardhmes së BE-së, një bashkimi më të fortë më të qëndrueshëm e më unik.

"Është interes i përbashkët dhe përgjegjësi e përbashkët e BE-së dhe e vendeve të rajonit, për të mirën e të gjithë qytetarëve tanë. Është momenti për ndryshime pozitive, në mënyrë që të arrihet përparim i pakthyeshëm drejt Bashkimit Evropian. Kur jemi tek Raporti i progresit, nga Lëvizja BESA presin Rekomandim pozitiv nga ana e KE për Maqedoninë, por thonë se Qeveria duhet të jetë më këmbëngulëse në implementimin e ligjeve reformuese. Në rast vlerësimi pozi-

Haradinaj të mërkurë viziton Shkupin



Më 18 prill (e mërkurë), kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj do të realizojë vizitën e parë të tij në Maqedoni, ndërsa i njëjti do të pritet nga kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev dhe zyrtarë tjerë të lartë të shtetit. Haradinaj dhe Zaevit, sipas burimeve zyrtare të gazetës KOHA, do të diskutojnë me Zaevin për marrëdhëniet ndërfqinjësore, ndërsa do të definohet data e mbledhjes së përbashkët qeveritare midis Maqedonisë dhe Kosovës.

PROGRAMI VJETOR I KULTURËS 2018

NIS SHQYRTIMI I ANKESAVE, HIQEN 10 PROJEKTE

Nga ky institucion nuk japin ndonjë informacion lidhur me numrin e ankesave të cilat iu janë drejtuar, përveç se rezultatet për projektet e rishikuara do të jenë gati pas dy javësh. Një prej komisioneve, ai i veprimtarisë skenike i ka gati rezultatet, ndërsa pritet të fillojnë ato të Muzikës, Folklori, Botimet..., ku edhe vëllimi i punës do të jetë më i madh

Koha

Evis HALILI

Shkup, 16 prill - Shqyrtimi i ankesave për projektet me interes nacional që kanë konkurruar në Programin vjetor të Ministrisë së Kulturës tashmë ka filluar. Nga ky institucion nuk japin ndonjë informacion lidhur me numrin e ankesave të cilat iu janë drejtuar, përveç se rezultatet për projektet e rishikuara do të jenë gati pas dy javësh. Një prej komisioneve, ai i veprimtarisë skenike i ka gati rezultatet, ndërsa pritet të fillojnë ato të Muzikës, Folklori, Botimet..., ku edhe vëllimi i punës do të jetë më i madh. Një ditë më parë, ministri i Kulturës, Robert Alagjovovski, gjatë një vizite në burgun e Shutkës, ka lënë të kuptohet se rishqyrtimi i një pjese të ankesave kushtëzohet nga mundësitë financiare që ka Ministria e Kulturës.

"Sa i takon ankesave, për momentin komisionet janë duke marrë në shqyrtim dhe po vendosin. Mënyra sesi ne do të kemi mundësi që t'i përgjigjemi këtyre ankesave, varet nga mjetet financiare që do të kemi në dispozicion",



ka thënë ministri. I pyetur lidhur me projektet që shkaktuan një zinxhir debatesh dhe reagimesh pas shpalljes së rezultateve, ai tha se dhjetë prej tyre janë tërhequr nga Programi pas revizionit të Komisionit të Ministrisë së Kulturës, që do të thotë 8.500.000 denarë më shumë që mund të përdoren për të korrigjuar defektet për projekte që ia vlen të marrin një mbështetje më të madhe financiare. Bëhet fjalë për projektet: Festivali i këngës shqipe "Event" i Shoqërisë kulturore-artistike "Event 2012) nga Tetova, "Erë

poetike" i Shoqatës "Inovacion", Festivali folklorik i fëmijëve i Shoqatës "Ble AND" nga Tetova, "Duke i njohur vlerat tona" e Lidhjes së artistëve shqiptarë ART - Tetovë, "Afirmimi i kulturës shqiptare përmes promovimit të kuzhinës së Gostivarit në Francë" i Shoqatës DRITA AGV - Gostivar, "Afirmimi dhe qëndrueshmëria e kulturës shqiptare përmes promovimit të traditave tradicionale të synetit shqiptar në Maqedoni" nga Shoqata Drita AGV - Gostivar, "Pjesëmarrje në Festivalin e 19-të ndërkombëtar" të Ansam-

blit "Tingujt e Karshiakës", si dhe dy projekte për realizim të koncerteve të Shoqatës Kulturore-Artistike "Alegretto". "Për momentin komisionet i shqyrtojnë dhe vendosin sipas raportit të negociatave. Mënyra në të cilën do të mund të përgjigjemi në negociata do të varet nga mjetet që do t'i kemi në dispozicion", sqaroi Alagjovovski në pyetjen e gazetarëve për projektet e Programit vjetor për të cilat kishte reagime në opinion dhe për të cilat ishte kërkuar revizion. Por nuk përjashtohet që pas shqyrtimit të ankesave në Pro-

gram, të futen projekte që janë refuzuar.

Rezultatet e Konkursit Vjetor për financimin e projekteve me interes nacional u shpallën në mes të muajit shkurt, ndërsa shpërndarja e vendimeve për të gjithë aplikuesit nisi një juaj më vonë, për shkak të volumit të aplikimeve. Në konkursin e këtij viti që u shpall në muajin shtator (30 shtator - 15 nëntor) janë dorëzuar 5018 aplikime, prej të cilave u miratuan më shumë se gjysma. Sektorët me numrin më të madh të projekteve ishin ato të artit figurativ, muzikës, folklorit dhe dramës me një rritje prej 25 për qind më shumë sesa vitin e kaluar. Si risi të këtij viti gjatë shpalljes së rezultateve ishin publikimi i emrave të anëtarëve të komisioneve, së bashku me shumat e kërkuara për realizimin e projekteve dhe atyre të miratuara nga komisionet përkatëse të të gjitha projekteve fituese. Po ashtu, risi ishte edhe aplikimi për projekte interdisiplinare. Në ndërkohë Ministria e Kulturës deklaroi tërheqjen e tetë projekteve fituese, pas një serie publikimesh nga gazeta KOHA për parregullsi të natyrave të ndryshme, konflikte interesash, përqendrim të buxhetit të kulturës në shoqata, individë, e të tjera.

Sa i takon fondit që Programi vjetor i 2018 cakton për projektet për kulturën shqiptare arrin në 170 milionë denarë, që do të thotë 25 për qind e buxhetit të përgjithshëm. Tek pjesa e investimeve kapitale, për këtë vit si kryesore mbeten ndërtimi i Teatrit dhe Bibliotekës së Tetovës (210 milionë denarë), përfundimi i punimeve rikonstruktive të Teatrit Shqiptar të Shkupit (250 milionë denarë), vazhdimi i punimeve për Shtëpinë e Kulturës në Mateç (36 milionë denarë), si edhe krijimi i Ansambllit shtetëror me një fond prej 48 milionë denarë.

10 PROJEKTET DISKUTABILE QË JANË HEQUR NGA PROGRAMI I KULTURËS

Dhjetë projekte të Programit vjetor të Ministrisë së Kulturës për vitin 2018 me vlerë të tërësishme prej 8.500.000 denarë janë tërhequr pas revizionit të Komisionit të Ministrisë, ka informuar ministri i Kulturës, Robert Alagjovovski. Bëhet fjalë për projektet: Festivali i këngës shqipe "Event" i Shoqërisë kulturore-artistike "Event 2012) nga Tetova, "Erë poetike" i Shoqatës "Inovacion", Festivali folklorik i fëmijëve i Shoqatës "Ble AND" nga Tetova, "Duke i njohur vlerat tona" e Lidhjes së artistëve shqiptarë ART - Tetovë, "Afirmimi i kulturës shqiptare përmes promovimit të kuzhinës së Gostivarit në Francë" i Shoqatës DRITA AGV - Gostivar, "Afirmimi dhe qëndrueshmëria e kulturës

shqiptare përmes promovimit të traditave tradicionale të synetit shqiptar në Maqedoni" nga Shoqata Drita AGV - Gostivar, "Pjesëmarrje në Festivalin e 19-të ndërkombëtar" të Ansambllit "Tingujt e Karshiakës", si dhe dy projekte për realizim të koncerteve të Shoqatës Kulturore-Artistike "Alegretto". "Për momentin komisionet i shqyrtojnë dhe vendosin sipas raportit të negociatave. Mënyra në të cilën do të mund të përgjigjemi në negociata do të varet nga mjetet që do t'i kemi në dispozicion", sqaroi Alagjovovski në pyetjen e gazetarëve për projektet e Programit vjetor për të cilat kishte reagime në opinion dhe për të cilat ishte kërkuar revizion.

MEMORANDUM I KULTURËS ME BURGUN E SHUTKËS

Të burgosurit shembullorë në ngjarje kulturore!

Shkup, 16 prill - Përmbajtje kulturore artistike për të dënuarit në Burgun e Shutkës parashikon Memorandumi për bashkëpunim që të hënën e nënshkruan ministri i Kulturës, Robert Alagjovovski dhe drejtori i ENP Burgu Shkup, Gjoko Kotevski. Siç sqaroi ministri Alagjovovski, me masat parashikohen vizita të ngjarjeve kulturore artistike për të dënuarit më shembullor, pasurimin e bibliotekave, organizimin e punëtorive dhe ngjarjeve kulturore artistike për vetë entin nga të dënuarit dhe me mysafirë artistë. "Me këto aktivitete jo vetëm që do të mundësojmë risocializim më të

mirë dhe atmosferë më të mirë në këtë institucion, por me përmirësimin e kushteve kontribuoam edhe drejt plotësimit të standardeve ndërkombëtare në vendet ku qëndrojnë persona të privuar nga liria", theksoi Alagjovovski. Ai paralajmëroi se Ministria është në dispozicion t'u ndihmojë enteve ndëshkuese përmirësuese në këtë drejtim dhe përdërisa ky pilot program tregohet si i suksesshëm do të zbatohet edhe në entet e tjera ndëshkuese përmirësuese në Maqedoni. Drejtori i burgut sqaroi se Memorandumi përfshin edhe lidhje aktive të personave të dënuar në projekte për ruajtjen

e mjeshtrive të caktuara, siç janë drugdhendja, skulptura, piktura, për të cilat, siç tha, do të trajnohen personat e dënuar për periudhën pas daljes nga burgjet. Masa e re do të fillojë me realizimin e vizitës së manifestimeve kulturore artistike, ndërsa më vonë me shoqatat e qytetarëve dhe institucioneve të cilat do të ofrojnë ndihmë do të fillohet edhe me punëtoritë e paralajmëruara në të cilat do të marrin pjesë të burgosurit. Burgu është formuar dhe filloi me punë në vitin 1968 dhe kjo është masa e parë e llojit të tillë e cila vendoset si program artistik kulturor.

Për tre muaj, 1200 maqedonas marrin shtetësi bullgare

Shkup, 16 prill - Ndryshojnë rregullat, tani më lehtë deri tek pasaporta bullgare. Prej janarit e deri tani, 1200 shtetas të Maqedonisë kanë marrë shtetësi bullgare, ndërkohë që prej vitit 2001, 71.524 persona kanë marrë shtetësi bullgare në Republikën e Maqedonisë. Kështu ka deklaroi nënkryetarja e Bullgarisë, Iliana Jotova, ndërsa ka thënë se nga fillimi i mandatit të kryetarit Rumen Radev, në janar të këtij viti, edhe 1184 qytetarë të Maqedonisë janë pajisur me shtetësi bullgare. Me këtë rast, ajo ka thënë premtim se në të ardhmen, do të lehtësohet regjimi për të arritur deri tek shtetësia bullgare. "Ju premtojmë se së shpejti do të lehtësohen procedurat për të fituar shtetësi bullgare", është shprehur Jotova për televizionin shtetëror bullgar.

VAZHDON GJYKIMI PËR TENTIM-VRASJEN E KREUT TË ASH-së

ALIMI DHE ZEQRIRI IDENTIFIKOJNË SULMUESIT E SELËS

Abdulfetah Alimi tha se para se ta nxjerrin nga pres-salla, e ka parë Selën se si qëndron pranë derës. Herën tjetër kur e ka parë Selën, ai veçmë ka qenë i tëri i mbuluar me gjak dhe i shtrirë përtokë në klubin e deputetëve



Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 16 prill - Dëshmitari Abdulfetah Alimi i ka njohur dy të akuzuarit për sulmin ndaj deputetit Zijadin Sela në Parlamentin e Maqedonisë më 27 prill të vitit të kaluar. Alimi i cili ishte sjellë në seancë nga paraburgimi si dëshmitar i prokurorisë, i ka identifikuar Aleksandar Janevskin - Toshta dhe Kire Georgievskin. Alimi i cili ka qenë pjesë e sigurimit në Parlament më 27 prill, tha se ka ardhur në media-qendrën e Parlamentit prej se ka hyrë turma. Ka vërejtur sulm ndaj deputetëve të papërgatitur. "Zaev veçmë kishte gjak dhe turma e njerëzve ka hedhur karrike dhe sende të tjera, ishte një kaos. Kërkohej gjak shqiptari, këto fjalë vinin nga turma. Aq sa mundëm me kolegët i mbrojtëm deputetët dhe gazetarët. Turma ishte aq e fuqishme sa që jeta jonë ishte e rrezikuar në çdo moment", tha Alimi. Nuk ka parë dikë se si personalisht e godet Selën, por ka parë se si gjuajnë me karrike. Potenco i se ka pasur edhe

njeri që ka qëndruar pranë Selës dhe ka luajtur ngrohtë-ftohtë, përkatësisht i ka qetësuar njerëzit nga turma, ndërsa me fytyrë ka qenë i kthyer drejt Selës dhe deputetëve. Tha se ai person është në seancë dhe gjykata konstatoi se ai është Aleksandar Janevski.

Dëshmitari e njohu edhe një person, i cili ka qenë në pres-qendrën dhe nuk ka pasur maskë - i akuzuari Kire Georgievski. Alimi tha se para se ta nxjerrin nga pres-salla, e ka parë Selën se si qëndron pranë derës. Herën tjetër kur e ka parë Selën, ai veçmë ka qenë i tëri i mbuluar me gjak dhe i shtrirë përtokë në klubin e deputetëve. Ka menduar se është i vdekur. Ka pasur shumë njerëz dhe njëri me bluzë të bardhë e ka goditur me shkëlqim Selën në anën e djathtë dhe ka thënë "lëreni ky është i vdekur". Tha se nuk kujtohet për personin por mendon se ai person ka pasur bluzë të bardhë në kokë. Pastaj së bashku edhe me dy persona të tjerë e kanë dërguar Selën në bufe, ia kanë dhënë ndihmën e parë mjekësore dhe kanë pritur të

vijë mjeku. Nëpër dritaren e bufësë e kanë nxjerrë Selën, i cili mezi ka ecur dhe nuk ka qenë në vetëdije dhe vetëm ka pyetur në gjuhën maqedonase se ku e dërgojnë, ndërsa ai ia ka kthyer se është në duar të sigurta. E kanë dërguar Selën në një zyrë në katin e tetë dhe kanë thirrur mjek. Pas ndihmës së parë mjekësore, Sela është dërguar në bodrumin parlamentar, e kanë maskuar si polic dhe me automjet të blinduar të policisë e kanë dërguar në spital.

Para gjykatës, të hënën ka dëshmuar edhe deputeti i LSDM-së, Muhamed Zeqiri, ndërsa në sallën gjyqësore e njohu të akuzuarin Aleksandar Janevski-Toshta. Zeqiri theksoi se Sela është goditur me gjësend të fortë dhe se nuk ka mundur të shohë se kush e ka hedhur. Sipas tij, i akuzuari Janevski i cili atë ditë ka mbajtur jelek të zi dhe syze, e ka tërhequr Selën për dore dhe e ka nxjerrë jashtë sallës së media qendrës. Gjatë marrjes në pyetje, Zeqiri tha se kur turma ka hyrë në media-qendrën në Parlament, ai ka qenë në njërin

prej kabinave për përkthim në galeri dhe se pasi Selën e kanë nxjerrë nga salla e media-qendrës, nuk e ka parë më. Zeqiri theksoi se një pjesë e deputetëve të cilët e kanë parë Selën, kanë menduar se bëhet fjalë për të, pasi që të dy kanë flokë të gjata. "Prej një koleges gazetare në celularin tim pranova mesazh nëse është e vërtetë se Sela është i vdekur. Unë u përgjigja se nuk e di", tha Zeqiri. Ai e potencoi edhe të akuzuarin Sasho Senkov, për të cilin tha se pasi i pari e ka kapur për dore, i është afruar së bashku me disa persona të tjerë me qëllim që ta nxjerrin jashtë prej media qendrës. Zeqiri tha se edhe prej kabinës ku ka qenë, ka dëgjuar se si turma e ka kërkuar atë. "Unë personalisht nuk u sulmova pasi që turma nuk arriti te unë", theksoi Zeqiri, duke shtuar se ka qenë në galeri derisa nuk ka filluar evakuimi. Në këtë rast të akuzuar janë edhe Kire dhe Ceko Gjeorgievski, Oliver Oshavkovski, Sasha Cenkov, Nikollçe Dimitrievski, Aleksandar Janevski-Toshta, Andrej Micov, Nikolla Vojminovski, Kosta Delov dhe Stojan Pavlovski-Kobra. Të akuzuarit për tentim vrasje të deputetit Zijadin Sela në seancat paprake u prononcuan të pafajshëm. Ata para Gjykatës thanë se e kuptojnë akuzën, por nuk ndjehen fajtorë dhe se ata do ta dëshmojnë në procedurën e mëtejshme. Në gjykimin e kaluar që zgjati gjashtë orë, ishin dërguar tre dëshmitarë, kryetari i Parlamentit të Maqedonisë, Talat Xhaferi, ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Damjan Mançevski dhe deputeti i LSDM-së, Aleksandar Kiracovski.

KRONIKË

Aksidenton tetovarin dhe ikë nga vendi i ngjarjes

Një tetovar i moshës 31 vjeç të dielën në mesnatë është aksidentuar në bulevardin e rrugës Industriale në Tetovë, nga një veturë e panjohur deri më tani. Sipas policisë, pasi që vozitësi ka aksidentuar 31 vjeçarin me iniciale S.S nga Tetova, e ka lëshuar vendin e ngjarjes. Këmbësori me lëndime trupore është dërguar në Klinikën e Tetovës, ku edhe i është dhënë ndihma e parë.

Nga policia bëjnë të ditur se shkak për këtë aksident ka qenë shpejtësia me të cilën ka lëvizur automjeti deri më tash i panjohur.

Policia ka marrë masa për zbardhjen e plotë të rastit dhe për identifikimin e autorit të aksidentit.

Aksidentohet motoristi në Zhelinë

Të dielën në mesnatë, në afërsi të Zhelinës, në autostradën Tetovë-Shkup, është regjistruar një aksident trafiku kur një motoçikletë pa targa që e ka drejtuar 25 vjeçari S.I nga fshati Rogle, është aksidentuar me një Audi me targa të Shkupit, që e ka drejtuar 51 vjeçari XH.I nga fshati Gërçec. Vozitësi i veturës e ka dërguar në spital motoristin që ka marrë lëndime në këtë aksident.

Me motoçikletë aksidenton një fëmijë

Një aksident tjetër ku është përfshirë një motoçikletë është regjistruar në qytetin e Tetovës, gjatë ditës së diel. Nga Policia e Tetovës njoftuan se një 17 vjeçar ka aksidentuar një fëmijë 7 vjeçar dhe më pas edhe një veturë Mercedes të parkuar me targa të Tetovës pronë e 34 vjeçarit N.A nga Tetova. Këmbësori dhe motorist janë dërguar për ndihmë mjekësore në Tetovë me automjet tjetër. Shkak për këtë aksident ka qenë mos përshtatja e shpejtësisë me kushtet në rrugë.

TARAVARI PËR INCIDENTIN NË GOSTIVAR

SULMI NDAJ PROFESORËVE, TURP I PAPANË

Costivar, 16 prill - Dhuna që ndodhi në oborrin e gjimnazit të Gostivarit është turp i paparë që asnjëherë nuk ka ndodhur në historinë e Gostivarit, është vlerësimi i kryetarit të Komunës së Gostivarit, Arben Taravari për ngjarjen kur të premtën dy profesorë kanë marrë lëndime trupore në zënkën fizike me dy persona të tjerë. Ai kërkoi që Ministria e Arsimit t'ia kthejë kompetencat kryetarit të komunës, ndërsa organet kompetente të bëjnë zbardhjen e plotë të rastit dhe dhunuesit të marrin dënimin e

merituar. "Ne thamë që marrja e ingerencave në arsim do të sjellë pasoja dhe ja ku i shohim pasojat. Ne kërkojmë nga ministri i Arsimit që të na i kthejë kompetencat, të suspendohet drejtori i shkollës së mesme të gjimnazit si orkestrues i këtij sulmi, kërkojmë që Ministria e Arsimit të informojë komunën se çfarë hapash janë ndërmarrë për rastin konkret. Ne si komunë kemi formuar komision i cili po merret me hulumtime se përse ka ardhur deri në këtë incident të dhunshëm ndërsa nga MPB

kërkojmë që të mos i mbrojnë banditët dhe ta zbardhë rastin. Unë jam shumë i sigurt se nëse atë ditë, sulmues do të ishin aktivistë të ASH-së, ata sot do të ishin në burg. Ndërsa dy personat që rrahën profesorët, shëtitin lirshëm dhe u kanosen qytetarëve dhe aktivistëve të tjerë të ASH-së", deklaroi Taravari. Taravari kërkoi gjakftohtësi nga të gjithë qytetarët ndaj provokimeve të këtilla. Ai tha se nuk dëshiron hakmarrje, por se insiston që organet kompetente ta kryejnë detyrën në favor të drejtësisë.

"Fatkeqësisht, shteti shpesh ka insistuar që shqiptarët të kenë luftë mes njëri-tjetrit. Unë këtë nuk do ta lejoj. Unë kam kërkuar tolerancë nga të gjithë qytetarët por edhe nga anëtarët e ASH-së që të jenë gjakftohtë ndaj provokimeve të këtilla, me qëllim që organet kompetente t'i zgjidhin këto punë", tha ai. Ai tha se do të dëshironte që dega e BDI-së në Gostivar të udhëhiqej nga një njeri meritor me të cilin do të bashkëpunonin dhe do të ndërtonin strategji të përbashkëta në favor të qytetarëve.

Qeveritë do të duhet të përballen me tranzicione, pabarazi dhe biznese me fuqi konsumatore të tkurrur, në rast se nuk marrin masa paraprake për të ndërtuar fuqi punëtore, e cila iu përshtatet kushteve të ardhshme, thotë Klaus Shvab, drejtor Ekzekutiv i Forumit Botëror

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 16 prill - Kur flasim për profesionet e së ardhmes, shumica e njerëzve mendojnë kryesisht për programuesit dhe specialistët e teknologjisë informatike. Megjithatë ekzistojnë edhe shumë profesione të tjera për të cilat në të ardhmen do të ekzistojë kërkesë e madhe. Në të ardhmen do të rritet rëndësia e më shumë profesioneve që do të fokusojnë shumë shkathtësi dhe njohuri të ndryshme. Ekspertët presin që një pjesë e profesioneve të së ardhmes të orientohen ndaj problemeve që njerëzimi akoma nuk ka arritur ti zgjidhë siç janë: ndryshimet klimatike, problemet e terrorizmit si dhe siguria në internet dhe rrjetet sociale apo sajber siguria. Studimi i Forumit Botëror Ekonomik, "E ardhmja e tregut të punës", parashikon shkurtimin e pothuajse 5 milionë pozicioneve të punës përpara vitit 2020 si pasojë e zëvendësimit me robotë, nanoteknologji, inteligjencë artificiale dhe faktorëve të tjerë socio-ekonomikë. Lajmi i mirë është, që po këto teknologji të reja, do të krijojnë rreth 2.1 milionë vende të reja pune. Nëse i kthehemi gjendjes në Maqedoni dhe shtetet e rajonit, edhe pse kemi ngecje ekonomike dhe shoqërore, megjithatë nuk mund të anashkalohe fakti se zhvillimi i hovshëm teknologjik, gradualisht po ndikon edhe në ekonominë dhe përditshmërinë tonë si dhe në zgjerimin gradual të profesioneve dhe tren-

PROFESIONET E REJA



TEKNOLOGJIA DIKTON NDRYSHIME

deve të reja edhe në shtetet e Ballkanit Perëndimor. Edhe këtu vërehet se me avancimin e pagesave elektronike do të zhduken gradualisht nevoja për punëtorët në pikëpagesat e autostradave. Një pjesë e bankave kanë filluar të ofrojnë shërbimet elektronike ku të gjitha shërbimet realizohen përmes kompjuterit duke përjashtuar faktorin njeri. Gradualisht në një të ardhme të afërt do të ulet dukshëm edhe numri i punëtorëve në sportelet e bankave që do të zëvendësohen me bankierin në zyrë që do të ofrojë shërbime të specializuara dhe konsulente. Në ndërkohë, analizat tregojnë se për të konkurruar sa më mirë në tregun e ardhshëm të punës, punëtorët, madje edhe ata, profesionet e të cilëve janë më pak të prekur nga automatizimi, do të duhet të përditësojnë aftësitë, thuhet më tej në raportin e Forumit Botëror Ekonomik.

"Qeveritë do të duhet të përballen me tranzicione, pabarazi dhe biznese me fuqi konsumatore të tkurrur, në rast se nuk marrin masa paraprake për të ndërtuar fuqi punëtore, e cila iu përshtatet kushteve të ardhshme", thotë Klaus Sh-

vab, themelues dhe Drejtor Ekzekutiv i Forumit Botëror Ekonomik. Vlerësohet se përkundër zhvillimit të inteligjencës artificiale, megjithatë shkathtësitë që kërkojnë punë konkrete në situatat konkrete akoma kërkojnë njerëz. Sistemi arsimor do të modernizohet, por megjithatë akoma do të nevojiten edukator, mësues, dhe profesorë. Industritë e ndryshme çdo herë shënojnë rënie dhe ulje, por çdo herë do të ketë nevojë për ekspertë që analizojnë dhe orientojnë rrjedhat financiare. Gjithashtu, një nga profesionet më të kërkuara në të ardhmen do të jenë edhe inxhinierët e elektron, të kimisë dhe makinerisë për shkak se rritet nevoja për prodhimin e

energjisë nga burimet e rinovueshme si uji, era apo dielli.

Plakja e popullatës në botën perëndimore si dhe hapja e shtëpive të pleqve do të rrisin kërkesën edhe për përkuqjesje më të madhe të popullatës së moshuar. Zhvillimi i hovshëm i teknologjisë, humtimet për shërimin e sëmundjeve gjenetike si dhe çrënjosja e sëmundjeve të ndryshme ngjitëse dhe të tjera, do të rrisë kërkesën edhe për mjek dhe farmacistë.

Rritja e rëndësisë së rrjeteve sociale për njerëzit dhe kompanitë do të imponojë edhe kërkesën se vjen e më të madhe të specialistëve të marketingut dhe profileve të tjera. Megjithatë në të ardhmen me si-

guri se nuk do të zhduken profesionet si avokatët, politikanët, shkrimtarët, apo artistët e profileve të ndryshme. Vendorsja e teknologjive të reja dhe mënyrës së re të punës përfshi edhe biznesin ndërkombëtar do të imponojë nevojën për njerëzit që kuptojnë dhe mund të definojnë ligjet dhe rregullat sipas të cilave do të funksionojnë rregullat e reja të lojës të biznesit në tërë botën. Si rrjedhojë e ndryshimit në profesionin e marketingut do të kërkojnë shkrimtarë të specializuar për blogje, artikuj në ueb faqe dhe raporte të ndryshme si dhe nevoja për ekspertë të marketingut që do të gjejnë mënyrë dhe ide të reja për prezantimin e shërbimeve të ndryshme.

PROFESIONET QË JANË TË LIDHUR ME ZHVILLIMIN TEKNOLOGJIK

Zhvillues softuerik, analist i sistemeve kompjuterike, kërkues tregu dhe specialist marketingu parashikohen që të shënojnë një rritje pesëfish më të madhe në 2024, por për këto profesione, zhvillimi teknologjik do të jetë shumë i rëndësishëm. Profesionet e mjekëve dhe fizioterapistët, gjithashtu pritet që të shënojnë rritje sidomos në një shoqëri në plakje. Inteligjenca sociale dhe emocionale dhe të kuptuarit e

platformave të reja të mediave dhe mbi të gjitha komunikimi në mënyrë efikase, do të vlerësohen shumë në një të ardhme, sidomos atëherë kur robotët të luftojnë për t'i zotëruar ato. Në një botë e cila po ndryshon me ritme shumë të shpejta, vendet e punës në fushën e arsimit dhe trajnimit pritet të shënojnë rritje. Rritje do të shënojnë edhe analistët e menaxhimit, kontabilistët dhe specialistët revizor apo të auditit.

Benzina më e shtrenjtë për gjysmë, dizeli për një denarë

Shkup, 16 prill - Çmimi i benzinës me pakicë prej mbrëmë në mesnatë do të rritet për 0.50 denarë, ndërsa çmimi i dizelit dhe vajit ekstra të lehtë për 1 denarë. Sipas vendimit të Komisioni Rregullator për Energjetikë, çmimi i ri i Eurosuper BS-95 do të arrijë 68 denarë, e Eurosuperit BS-98 do të jetë 69,50 denarë, i Eurodiseli do të shtet me çmim prej 60 denarë për litër ndërsa çmimi i vajit ekstra të lehtë për amvisëritë për 48,50 denarë. Sipas vendimit rritet edhe çmimi me pakicë i mazutit dhe do të jetë 28,72 denarë për kilogram. Çmimi mesatar i naftës së papërpunuar në tregun botëror në 14 ditët e kaluara ishte 68,9 dollarë për barel ndërsa kursi i denarit në raport me dollarin 50.003 denarë.

Me arbitrazh zgjidhje e shpejtë e kontesteve ekonomike

Shkup, 16 prill - Biznesmenët ta shfrytëzojnë arbitrazhin në kontestet në vend se të shkojnë nëpër gjykata, sepse me atë do të kursejnë kohë dhe para, apelojnë nga Gjykata e Përhershme e Arbitrazhit pranë Odës ekonomike të Maqedonisë. Prej atje potencojnë se arbitrazhi është një nga mënyrat më të shpejta dhe më të mira për zgjidhjen e kontesteve ekonomike dhe përdërisa shfrytëzohet, palët do të shpenzojnë shumë më pak mjete financiare se sa në kontestet gjyqësore të cilat janë edhe afatgjate. Në Maqedoni, kompanitë ende nuk e shfrytëzojnë sa duhet arbitrazhin si zgjidhje të kontesteve, por nga Gjykata e Përhershme e Arbi-



trazhit pranë Odës ekonomike të Maqedonisë shpresojnë se në të ardhmen ajo do të shfrytëzohet më shumë. Kryetari i Gjykatës së zgjedhur të përhershme - Arbitrazhi pranë Odës ekonomike të Maqedonisë, Goran Rafajlovski thotë se kohëve të fundit numër gjithnjë e më i madh i kompanive vendore vendosin në

marrëveshjet klauzolë për arbitrazhin. "Mendoj se numri i kontesteve do të rritet. Në vit zgjidhen mbi 10 konteste, por kur të shohim se viteve të fundit në Maqedoni zgjidhen jashtëzakonisht numër i vogël i kontesteve ekonomike në gjykata, konsideroj se besimi në sistemin gjyqësor komplet është humbur dhe e jona

është të provojmë të ndihmojmë që ajo të kthehet në tërësi", theksoi Rafajlovski në konferencën e sotme për shtyp. Mesatarja e tërësishe e kontesteve me arbitrazhin është shtatë muaj. Zgjidhja që do të silllet është ekzekutive dhe palët nuk kanë të drejtë të ankesave dhe përsëritje të procedurës.

RRJETI I SHKOLLAVE PRIVATE TË "YAHYA KEMAL"-IT

CYK, ATY KU S'BËHET KOMPROMIS ME CILËSINË

Janë të parët në listën e shkollave sipas suksesit të maturës shtetërore. 30 për qind e maturantëve regjistrohen në universitetet jashtë Maqedonisë. Këtë vit u regjistrua nxënësi i tetë në Universitetin e Jalës, ndërsa nga gjashtë studentë nga Maqedonia të regjistruar në Harvard, tre janë nxënës i këtij kolegji



Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 16 prill - Kanë mbetur edhe pesë ditë nga përfundimi i afatit për dorëzimin e dokumenteve për regjistrim në paralelet e mesme të Kolegjit "Yahya Kemal" (CYK) të shpërndara në Karposh dhe Butel të Shkupit, në Gostivar, Strugë, Strumicë dhe Tetovë. Megjithatë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) kanë të drejtën e regjistrimit pa limit të nxënësve në arsimin e mesëm, është vetë CYK që i ka vendosur kufizime vetes për numrin e nxënësve dhe paraleleve të reja që do të formohen për vitin e ardhshëm shkollor 2018/2019. "Sepse, bëjmë kujdes që të mos cenohet cilësia e shkollimit", thotë Suria Tauk, përgjegjësi për komunikim me publikun. Kështu, për vitin tjetër, thotë se është caktuar të formohen vetëm 4 paralele në Karposh, nga 3 paralele në Butel, Strugë, Tetovë dhe Strumicë, si dhe 2 paralele në Tetovë. Në të gjitha shkollat ku ka edhe paralele të arsimit fillor, gjysma e vendeve janë të rezervuara për nxënësit e tyre, ndërsa gjysma tjetër për kandidatët që vijnë prej shkollave tjera. Regjistrimi i nxënësve do të bëhet me provim pranues, i cili do të organizohet në datën 22 prill (të dielën) në të gjashtë kampuset e këtij kolegji, që në Maqedoni ka kapërcyer 23 vite të funksionimit.

Kontribut që nuk janë kursyer ta japin deri tani është promovimi i multietniciteti dhe përfaqësimi dinjitos i Maqedoni në botë. "Maqedonia është një shtet multietnik dhe jam shumë i sigurt se në drejtim të bashkëjetesës, kemi dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm. Në shkollat tona, të gjithë shkollohen bashkërisht. Pjesa më e madhe e nxënësve janë shqiptarë e maqedonas, por në tërësi kemi nxënës nga 11 përkatësi të ndryshme etnike. Gjithashtu e përfaqësojmë Maqedoninë në mënyrën më të mirë të mundshme edhe në arenën ndërkombëtare, përmes projekteve arsimore dhe garave të diturisë, prej ku nxënësit tanë kthehen çdoherë me medalje dhe çmime të fituara", shprehet Ismail Erdil, drejtori i CYK në Karposh të Shkupit. Ai thotë se nuk kanë frikë nga konkurrenca lokale, jo vetëm sepse konkurrenca e rrit cilësinë, por edhe sepse janë të sigurt në cilësinë që ata ofrojnë. Vite me radhë, nxënësit e këtij kolegji qëndrojnë të parët në listën e shkolla-

ve sipas suksesit në provimet e maturës shtetërore në Maqedoni.

"Edhe pse jemi shkollë private, gjithçka është në kontrollin e MASH-it dhe inspektorëve të arsimit. Diploma që marrin nxënësit tanë është e barabartë me diplomatat e të gjitha shkollave të mesme në Maqedoni. Përparësia është se këtu u mundësohet nxënësve mësimi i shkëlqyer i gjuhës angleze, dhe i dy gjuhëve tjera të huaja (tur-

qishtes dhe gjermanishtes), krahas asaj që nxënësit kanë mundësi të shkollohen në gjuhët e tyre amtare, shqip dhe maqedonisht", vëren Erdil. Të dhënat statistikore tregojnë se 30 për qind e maturantëve në CYK e vazhdojnë arsimin e lartë në universitetet jashtë Maqedonisë. Sot janë mbi 350 doktorë shkencash, të cilët paraprakisht kanë qenë nxënës në CYK. Këtë vit, në Universitetin e Jalës u regjistrua

studenti i tetë nga CYK, ndërkaq nga gjashtë studentë nga Maqedonia që kanë arritur të regjistrohen gjithsej në Universitetin e Harvardit, tre kanë kryer të mesmen në CYK.

Janë edhe dhjetëra nxënës të tjerë që kanë fituar bursa studimi nëpër universitetet tjera prestigjioze, përmes projekteve dhe garave të ndryshme ndërkombëtare ku ata marrin pjesë.

Drejtori Erdil thotë se çelësi i të gjitha sukseseve është cilësia e shkollimit. "Me pagesën e shkollimit është i garantuar vetëm 1-shi. Notat tjera nxënësit duhet t'i fitojnë vetë, duke mësuar dhe duke u aktivizuar në projekte arsimore dhe kërkimore", shprehet ai, pa anashkaluar si element mjaft të rëndësishëm edhe ofrimin e kushteve të larta për mësim.

Si në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm, CYK ofron shkollim sipas standardeve të larta, qëndrim tërëditor, mësim me tabela elektronike, paralele me mesatarisht 20 nxënës në klasë, mësim kabinetik dhe laboratorë moderne për informatikën, kiminë, fizikën dhe biologjinë, këndin zbulimeve dhe të ngjashme.

CYK RIMERR VETEN NGA PRESIONET E ANKARASË ZYRTARE

Fërkimet politike dhe presionet që vinin në Maqedoni nga Ankaraja zyrtare, lëkundën jo pak edhe shkollat e rreshtin e shkollave të CYK në Maqedoni, në drejtim të rënies së numrit të nxënësve, posaçërisht në vitin 2016/2017. Por shumë shpejt e rimorën veten dhe me interesimin e shtuar që presin të kenë këtë vit, thonë se do ta rikuperojnë "dëmin" e para dy viteve. CYK, në Maqedoni nis punë në vitin 1996 si shkollë e mesme private, për tu zgjeruar më vonë me formimin paraleleve të arsimit fillor nga viti 2008, si dhe me paralele të arsimit parashkollor nga viti 2015 edhe. Këta të fundit, janë hapur prej para tre viteve në kampusin e CYK në



Karposh dhe për momentin numërojnë 43 fëmijë të ndarë në grupet e fëmijëve që marrin përkujdesje në gjuhën shqipe dhe maqedonase. Vetëm në shqip dhe maqedonisht, në kampusin e Kaposhit janë edhe paralelet e arsimit fillor dhe të mesëm të cilat kanë momentalisht 515 dhe 215 nxënës. Në nivel shteti, CYK numëron rreth 2000 nxënës, pjesa më e madhe e të cilëve në kryeqytet. Drejtori Erdil nuk përjashton mundësinë e zgjerimit në arsimin e lartë. Madje, "sipas planeve tona duhet të ishte formuar Universiteti, pasi nga bankat e shkollave të mesme tani deri kanë diplomuar 3500 vetë", shprehet ai.

Qëllimshëm digjet piceria në Çairçankë

Shkup, 16 prill - Në Çairçankë të Çairit, në orët e hershme piceria "Pizza Shkupi" ka marrë flakë, ndërsa një shishe me benzinë është gjetur në kafiterinë "Princ". Fikren Osmani, pronar i picerisë, tregon se qëllimshëm me benzinë është djegur pronari e tij, ndërsa flakët e kanë përfshirë pjesa e përparme e picerisë, si dhe banesa sipër picerisë, ku edhe banon familja e tij. Fikreni thotë se për ngjarjen fillimisht është lajmëruar nga disa kalimtarë, ndërsa e kanë informuar edhe zjarrfikësat dhe forcat e rendit, të cilët kanë arritur ta parandalojnë depërtimin e zjarrit thellë në brendësi të picerisë si dhe banesës. "Papritmas ka ndodhur një zhurmë nga ora 3:30 e mëngjesit, ku edhe ka kapluar zjarri që ka zgjatur deri nga ora 4. Të

dhënat e para janë se i është vënë flaka me benzinë, këtë e dimë, tjetër gjë jo. Ka nisë me u djeg nga një skaj për t'u përhap mandej gjithandej. Informata shtesë nuk kemi akoma, por policia ka marrë shënime", thotë Fikreni, ndërsa mohon të ketë patur probleme me ndonjë person që ka mundur t'i shkaktojë probleme. "Nuk e dimë shkakun, sepse as nuk kemi patur probleme me rrymën, as edhe nuk është shkaku aty. Këtë e ka bërë një njeri keqberës. Thash, ne nuk kemi patur asnjë mosmarrëveshje me askënd. Vetëm objekti është shkatërruar tërësisht, nuk ka të lënduar, por ndërtesa sipër shihet që ka nisur të digjet, por falë zjarrfikësve u ndalu më e keqja. Aty ka banorë që jetojnë, sipër picerisë, ku



edhe kanë patur disa probleme, por janë jashtë rrezikut. Fëmijët tashmë janë dërguar në spital. Tymi ka ndikuar keq tek ata. Tashmë jemi në pritje të të dhënave nga policia, e cila pasi ta përfundojë bërë ekspertizën, mund ta zbulojnë au-

torin", thotë pronari i picerisë "Pizza Shkupi". Kjo piceri ka 12 vite që funksionon, ndërkohë që Fikren Osmani e udhëheq të njëjtën katër vite me radhë. Ndryshe, një shishe me benzinë është gjetur edhe 30 metra më larg, konkretisht në kafe-

terinë "Princ" përball shkollës "Liria". Sipas pronarit të kësaj kafiterie, është gjetur një shishe me benzinë brenda kafiterisë, ndërsa me thikë është, ndërsa me thikë çarë tenda e lokalit. Policia tashmë ka nis hetimin edhe në këtë lokal. (D.K)



KOMUNA E BUTELIT
Nr. 09-825/12 e datës 16.04.2018
Shkup

Në bazë të nenit 35, ndërsa në lidhje me nenin 51 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 199/2014, 44/2015, 193/2015, 31/2016, 163/2016 dhe 90/2017), Kryetari i Komunës së Butelit në vijim publikon

LAJMËRIM

Lajmërohen qytetarët dhe subjektet juridike se Kryetari i Komunës së Butelit ka sjellë Vendim për organizim të:

PREZANTIM PUBLIK DHE ANKETË PUBLIKE

Për Projektin arkitektonik-urbanistik për formim të parcelës ndërtimore 7.1. të PK 257/2, për qëllim G4 – depo për materiale ndërtimore në Bllokun 7, nga PUJVB për zonën industriale Vizbeg/përpunim të Bllokut 12/, KK Vizbeg, Komuna e Butelit – Shkup

Hapësira e definuar për përpunimin e Projektit arkitektonik-urbanistik për formim të parcelës ndërtimore 7.1. të PK 257/2, për qëllim G4 – depo për materiale ndërtimore në Bllokun 7, nga PUJVB për zonën industriale Vizbeg/përpunim të Bllokut 12/, KK Vizbeg, Komuna e Butelit – Shkup, me pozitën e saj gjendet në territorin e Komunës së Butelit. Përfshirja projektuese që është lëndë e këtij dokumentacioni kapë hapësirën me sipërfaqe prej 876,8672 m² ose 0,0877 ha.

Përfshirja projektuese e këtij Projekti arkitektonik-urbanistik është e definuar me **x dhe y koordinatat** në vijim:

X	Y
X=7533040.2498	Y=4655379.2703
X=7533029.5624	Y=4655370.0727
X=7533076.8208	Y=4655318.7876
X=7533085.5098	Y=4655322.6603
X=7533071.2750	Y=4655342.0018
X=7533064.2698	Y=4655351.5203

Projekti i përpiluar Arkitektonik-urbanistik me shtojcat grafike do të ekspozohet në vend publik në lokalet e Komunës së Butelit në Sallën e Takimeve (Salla e Vogël).

Anketa publike do të mbahet prej më 23.04.2018 deri më 27.04.2018 (pesë ditë pune), çdo ditë pune prej ora 08.30 deri në ora 15.30 në lokalet e Komunës së Butelit në Sallën për takime (Salla e Vogël).

Në afatin e caktuar subjektet e interesuara juridike dhe fizike mund të parashtrajnë vërejtje në listat anketuese në formë elektronike përmes sistemit informatik e-urbanizam ose në formë me shkrim.

Listat anketuese për pjesëmarrje në Anketën publike mund të merren në Komunën e Butelit (sportel).

Lajmërimi për organizim të anketës publike është publikuar në Shtypin ditor Nova Makedonija dhe Koha, në sistemin informatik e-urbanizam dhe në ueb faqen e Komunës së Butelit.

Prezantimi publik në lidhje me Projektin arkitektonik-urbanistik për formim të parcelës ndërtimore 7.1. të PK 257/2, për qëllim G4 – depo për materiale ndërtimore në Bllokun 7, nga PUJVB për zonën industriale Vizbeg/përpunim të Bllokut 12/, KK Vizbeg, Komuna e Butelit – Shkup, do të mbahet në lokalet e Komunës së Butelit, në Sallën e Takimeve (Salla e Vogël) më datë 25.04.2018 me fillim në ora 10:00.

KRYETARI I KOMUNËS
Velimir Smilevski



KOMUNA BUTEL
Nr. 09-1207/7 nga data 16.04.2018
Shkup

Sipas nenit 35 dhe lidhur me nenin 51 nga Ligji për Planifikim Hapsinor dhe Urbanistik (Gazeta Zyrtare e RM numër 199/2014, 44/2015, 44/2015, 193/2015, 31/2016, 163/2016 dhe 90/2017), Kryetari i Komunës Butel lëshon këtë:

NJOFTIM

Njoftohen qytetarët dhe personat fizik se Kryetari i Komunës së Butelit ka sjellë vendim për organizimin e:

Prezantimit Publik dhe Ankandit Publik

Për Projekt Arkitektoniko- Urbanistik për krijimin e parcelave ndërtimore në pajtim me PUJV për zonën industriale Vizbeg / përpunim i bllokut 12/ KK Vizbegovë, komuna Butel-Shkup në Bllokun 1 të PK 1634/1 me klasën për qëllim A1- strehim në shtëpi banimi

Hapësira e definuar për hartimin e Projekti Arkitektoniko- Urbanistik për krijimin e parcelave ndërtimore në pajtim me PUJV për zonën industriale Vizbegovë / përpunimi i bllokut 12/ KK Vizbegovë, komuna Butel-Shkup në Bllokun 1 të PK 1634/1 me klasin për qëllim A1- strehim në shtëpi banimi ndodhet në komunën Butel. Sipërfaqja e mbuluar nga projekti kap 3218 m².

Hapësira e definuar për hartimin e Projektit Arkitektoniko- Urbanistik mbulon parcelën e kadastrit nr. 1634/1 në komunën e kadastrit Vizbeg, komuna e Butelit. Në kufi të parcelës së kadastrit parashihen katër parcela ndërtimi. Sipërfaqja e mbuluar nga projekti kap 3218 m². Terreni është në rënie nga veriu në jug.

Shtirija e projektit nga ana veriore kufizohet me parcelën e kadastrit në pronësi private ku ka të ndërtuar objekte për banim individual, ndërsa nga ana perëndimore dhe jugore kufizohet me tokë ndërtimore të pandërtuar, ndërsa nga ana lindore kufizohet me rrugë të arritshme. Qasja deri tek parcelat është siguruar përmes anës lindore, më saktë nga rruga e re e planifikuar „1“.

Projekti Arkitektoniko- Urbanistik i hartuar me shtojcat grafike do të publikohet në vend publik në hapësirat e Komunës Butel në Sallën e Takimeve (Salla e Vogël).

Ankandit publik do të mbahet nga data 23.04.2018 deri 27.04.2018 (pesë ditë pune), çdo ditë pune nga ora 08:30 deri 15:30 në hapësirat e Komunës Butel në Sallën e Takimeve (Salla e Vogël).

Listat anketuese për pjesëmarrje në ankandin publik mund të merren në Komunën Butel (në hyrje).

Njoftimi për organizimin e ankandit publik është shpallur në gazetën ditore "Nova Makedonija" dhe "Koha," në sistemin e informimit e-urbanizëm dhe në ueb faqen e Komunës Butel.

Prezantimi publik për Projektin Arkitektoniko- Urbanistik për krijimin e parcelave ndërtimore në pajtim me PUJV për zonën industriale Vizbegovë / përpunim i bllokut 12/ KK Vizbegovë, komuna Butel-Shkup në Bllokun 1 të PK 1634/1 me klasën për qëllim A1- strehim në shtëpi banimi, do të mbahet në hapësirat e Komunës Butel në Sallën e Takimeve (Salla e Vogël), më datë 25.04.2018, me fillim në ora 11:00.

KRYETAR KOMUNE
Velimir Smilevski

Në bazë të nenit 21 dhe 22 të Ligjit për punësuarve në sektorin publik dhe nenit 22 dhe 23 prej Ligjit të marrëdhënieve të punës, Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë, boton Shpallje për punësim me kohë të caktuar deri më 31.12.2018

1. Për nevojat e themelimit të marrëdhënieve të punës për kohë të caktuar në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë për vendin e punës siç vijon:

1. Bashkëpunëtor për shërbime për orientacioni profesional në Qendër e punësimit-Strumicë (1) një realizues;

Kandidati duhet t'i plotësojë edhe kushtet e veçanta siç vijojnë :

- Arsim i lartë – Psikologji;
- Së paku 2 (dy) vjet përvojë pune në profesion;
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë zyre;
- Njohje aktive të një prej tri gjuhëve që përdoren në Unionin Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht);
- Rroga neto për vendin e punës është 23 230 denarë.

2. Bashkëpunëtor shërbimeve për mbështetjen e punësimit në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë – Qendra e punësimit në qytetin e Shkupit – një realizues

Kandidati duhet t'i plotësojë edhe kushtet e veçanta siç vijojnë:

- Arsimin e lartë, përkatësisht të ketë së paku 180 kredi të arritura sipas EKTS-së ose të ketë mbaruar shkallën VII/1;
- Të ketë së paku dy vjet përvojë pune në profesion;
- Të ketë njohje aktive të programeve kompjuterike për punë zyre;
- Të ketë njohje aktive të një prej tri gjuhëve që më së shpeshti përdoren në Unionin Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht);
- Rroga themelore neto për vendin e punës do të jetë 23.230,00 denarë

3. Referent i shërbimeve për mbështetjen e punësimit në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë – Qendra e punësimit në qytetin e Shkupit – një realizues;

Kandidati duhet t'i plotësojë edhe kushtet e veçanta siç vijojnë:

- Të ketë arsim të lartë ose të mesëm
- Të ketë së paku dy vjet përvojë pune në profesion;
- Të ketë njohje aktive të programeve kompjuterike për punë zyre;
- Të ketë njohje aktive të një prej tri gjuhëve që më së shpeshti përdoren në Unionin Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht);
- Rroga themelore neto për vendin e punës do të jetë 14.900,00 denarë

Bashkë me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë edhe:

- Dëftesën/diplomën për mbarimin e nivelit arsimor;
- Vërtetimin/dëshminë për përvojën e punës;
- Vërtetimin/dëshminë për njohjen e programeve kompjuterike për punë zyre;
- Vërtetimin/dëshminë për njohje aktive të gjuhëve
- Dëshminë se nuk është shqiptuar ndalesë për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Vërtetimin e shtetësisë;

II. Marrëdhënia e punës themelohet me orar të plotë pune – 40 orë në javë, nga e hëna deri të premten; ndërsa orari i punës ditore është prej 07:30 deri 15:30.

III. Bashkë me fletëparaqitjen, kandidatët duhet të dorëzojnë dëshmi me të cilat vërtetohet plotësimi i kushteve të parapara.

IV. Shpallja do të jetë e hapur pesë ditë pune, duke filluar nga data e botimit në shtypin ditor.

V. Fletëparaqitjet me dokumentacionin e nevojshëm duhet të dorëzohen në arkiv nëpërmjet postës në adresën siç vijon: Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë – shërbimi qendror, rruga "Vasil Gjorgov" nr. 43, Shkup

Në bazë të Programit për aktivitetet në fushën e sportit dhe rinisë në qytetin e Shkupit për vitin 2018 ("Lajmëtar zyrtar i Qytetit të Shkupit" nr. 01/18 të datës 01 shkurt të vitit 2018), Kryetari i Qytetit të Shkupit e shpall këtë:

THIRRJE PUBLIKE
PËR NDARJEN E BURSAVE PËR SPORTISTËT – NXËNËSIT E SHKOLLAVE TË MESME NË TERRITORIN E QYTETIT TË SHKUPIT PËR VITIN 2018

Qyteti i Shkupit me qëllim të zmadhimit të motivimit të sportistëve të rinj dhe të talentuar – nxënësit e shkollave të mesme, si dhe për përkrahjen e zhvillimit dhe avancimit të sportit rinorë të nxënësve të shkollave të mesme, implementon dhënie e bursave për sportistë – nxënës të shkollave të mesme, që janë banorë të qytetit të Shkupit dhe të cilët mësojnë në shkollat e mesme në territorin e qytetit të Shkupit.

Në bazë të kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Rregulloren e posaçme për dhënie e bursave për sportistët e talentuar – nxënës të shkollave të mesme, banorë të qytetit të Shkupit, që mësojnë në shkollat e mesme në qytetin e Shkupit, do të jepet bursa për 100 sportistë, nxënës dhe nxënës të shkollave të mesme në territorin e qytetit të Shkupit.

Vlerësimi përcaktohet në bazë të:

Të drejtën e fitimit të bursës e kanë nënshtetasit e RM-së, që kanë statusin e nxënësit të rregullt ose të çrregullt në shkollën e mesme në territorin e qytetit të Shkupit, me kushtet vijuese:

Të jenë banorë të qytetit të Shkupit;
Të jenë nxënës në shkollat e mesme në territorin e qytetit të Shkupit;
Të jenë sportistë dhe sportiste aktive, anëtarë të klubeve sportive të regjistruara në territorin e qytetit të Shkupit dhe të jenë të regjistruar në federatat kombëtare sportive në Maqedoni;
Të manifestojnë arritje të larta sportive gjatë vitit të kaluar 2017 dhe 2018, deri në kohën e përfundimit të thirrjes publike.
Këta 100 bursistë, do të fitojnë bursa gjatë tetë muajve të vitit në vijim 2018.

Aplikantët, përkaj dokumenteve të lartpërmendura, në fletëparaqitjet duhet t'i plotësojnë edhe qëllimet dhe kriteret që janë dhënë si shtojcë të thirrjes publike që është shpallur në ueb faqen e Qytetit të Shkupit. www.skopje.gov.mk

Në procedurën e ndarjes së bursave nga programi për aktivitetet në fushën e sportit dhe rinisë në qytetin e Shkupit gjatë vitit 2018, në procesin e përzgjedhjes do të hyjnë ata aplikantë – nxënës të shkollave të mesme, sportiste dhe sportistë, të cilët në bazë të kriterëve do të sigurojnë së paku 50 nga gjithsej 100 pikë të mundshme.

Aplikimi në Thirrjen publike kryhet nëpërmjet deponimit të fletëparaqitjes së posaçme të plotësuar që mund të merret në arkivin e Qytetit të Shkupit (baraka 16) ose të merret nga ueb faqja zyrtare e Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk

Aplikuesit, përveç fletëparaqitjes në mënyrë të detyruar duhet t'i deponojnë edhe dokumentet e mëposhtme:

- kopje e letërnjoftimit të prindërve/kujdestar;
- kopje nga certifikata e lindjes e aplikuesit;
- vërtetim nga shkolla e mesme se është nxënës i rregullt ose jashtëm i shkollës në vitin shkollor 2017/2018;
- kopje nga dëftesa e vitit shkollor 2016/2017;
- biografi e shkurtër e aplikuesit;
- vërtetim nga klubi sportiv se është anëtar i të njëjtit;
- vërtetim nga federata nacionale amë se është anëtar përfaqësues i gjeneratës së vet;
- vërtetim nga federata nacionale amë për arritjen e rezultateve sportive nga 01.01.2017, deri në përfundimin e shpalljes publike.

Thirrja publike zgjat gjithsej 10 ditë, nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik.

Thirrja publike publikohet më 17.04.2018 dhe zgjat deri më 26.04.2018.

Fletëparaqitje duhet të deponohen deri te Qyteti i Shkupit, nëpërmjet postës në adresën: Bul. "Ilinden" nr. 82, 1000 Shkup, ose në Arkivin e Qytetit të Shkupit (baraka 16), më së voni deri më 26.04.2018 deri në orën 15:00 në ditën e fundit nga përfundimi i Thirrjes publike, me emërtimin: për "THIRRJE PUBLIKE PËR NDARJEN E BURSAVE PËR SPORTISTËT – NXËNËSIT E SHKOLLAVE TË MESME NË TERRITORIN E QYTETIT TË SHKUPIT PËR VITIN 2018".

Fletëparaqitjet duhet të deponohen në zarf të mbyllur dhe të vulosur, pa shenja të aplikuesit i cili deponon fletëparaqitjen.

Fletëparaqitjet të cilat nuk janë deponuar në mënyrën siç kërkohet në tekstin e lartpërmendur, pikërisht përmbajnë të dhëna jo të plota dhe dokumentacion jo të plotë, si dhe ato që nuk do të deponohen në afatin e përcaktuar, nuk do të shqyrtohen.

Informacione plotësuese mund të merrni përmes telefonit në: 02/ 3297-238 dhe 3297-320.

QYTETI I SHKUPIT

Pagesa sipas orëve në kujdestari, e jo për turn të natës

Shkup, 16 prill - Unioni i Shoqatës së Infermiereve kërkojnë që turni i natës të paguhet sipas orëve për kujdestari, e jo për turn të natës, siç parashikon neni 2016 nga Ligji për mbrojtje shëndetësore. Kryetarja e Unionit të gjashtë shoqatave të infermiereve dhe të Shoqatës së infermiereve, teknikëve dhe mamive, Gordana Beshliovska, në konferencën për shtyp theksoi se këtë kërkesë e kanë parashtruar dhe për këtë kanë diskutuar me kryetarin e Degës së Sindikatës për Shëndetësi, Lubisha Karanfilovski, i cili tashmë ka filluar bisedime me Ministrinë e Shëndetësisë për nënshkrim të aneksit të Marrëveshjes kolektive në pjesën e punës së natës dhe kujdestarive. Ajo theksoi se në Unionin e tyre janë të anëtarësuar mbi 5.500 anëtarë, por meqë nuk janë të organizuar në odë nuk kanë përfaqësues të tyrin juridik në bisedime. Elaboroi se sipas mënyrës aktuale të llogaritjes së turnit të natës ata marrin rritje të 65 përqindëve nga norma, ndërsa me rritjen e paralajmëruar 65 për qind nga norma, do të merrnin rritje vetëm 80 denarë, që thonë është e pranueshme. Me probleme përballen edhe infermieret - koncesionere. Siç sqaroi Snezhana Spirovska, përfaqësuese e infermiereve - koncesionere, pas pensionimit të mjekëve - koncesionerë ata mbeten pa punë, ndërsa bëhet fjalë për punonjësve shëndetësore edhe me 30 vjet stazh pune. Kërkojnë që pjesa më e madhe e infermiereve - koncesionere të kthehen në Shtëpinë e shëndetit.

KËRKOHET RINGJALLJA E KOMPLEKSIT TË VJETËR

HARROHET "SARANDA"



Nga gjithsej 70 lokale sa kanë funksionuar në fillim kur u hap kjo qendër, tashmë kanë ngelur vetëm disa biznese të vogla që funksionojnë, por edhe ata ankohen se puna gjithnjë është më e pakët. Pjesa dërmuese e lokaleve janë të mbyllura dhe shihen mbishkrimet "Jepet me qira"

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 16 prill - Pronarët e lokaleve që punojnë në qendrën tregtare "Saranda" që njihet edhe si kompleksi i vjetër, ankohen se nëse nuk merren masa që të rivitalizohet e njëjta me infrastrukturë të nevojshme, atëherë këtë kompleks e presin ditë të zeza dhe nuk përjashtohet mundësia të mbyllet përgjithmonë. Që kur është ndërtuar e deri më tash nuk është bërë asnjë investim në këtë pjesë. Nga gjithsej 70 lokale sa kanë funksionuar në fillim kur u hap kjo qendër, tashmë kanë ngelur vetëm disa biznese të vogla që funksionojnë, por edhe ata ankohen se puna gjithnjë është më e pakët. Pjesa dërmuese e lokaleve janë të mbyllura dhe shihen mbishkrimet "Jepet me qira", madje pjesa më e madhe e tyre në të kaluarën kanë qenë biznese profitabile, kurse sot janë lënë nën mëshirë të fatit. "Dikur ka funksionuar shumë mirë

kompleksi, tashmë kohëve të fundit nuk ka vizitorë, nuk ka ndriçim publik, nuk ka tualet publik, duhet edhe pak komuna që të shoh se ku janë mangësitë dhe të bëjë investime. Popullata ikën nga komplekset tjera, ndërsa kompleksin 'Saranda' e kanë harruar tërësisht, me një fjalë është lënë në mëshirë të fatit", ankohen pronarët. Kjo qendër e ndërtuar në fillim e viteve 90-ta, qendra e vjetër tregtare "Saranda" në Tetovë po përjeton ditët më të vështira. Kjo qendër tregtare me dhjetëra lokale në fillim shkëlqente, ku të gjitha lokalet dhe bizneset e vogla punonin dhe kishte mjaft vizitorë. E njëjta u bë një pikë referimi për qytetarët e Tetovës dhe më gjerë duke qenë një qendër e vogël, por atraktive dhe e dëshiruar nga të gjithë. Kryetarja e Komunës së Tetovës, Teuta Arifi, premtan se gjatë këtij mandati pritët që kjo qendër të ringjallet.

"Në fakt, ato janë objekte për të cilat është dhënë status privat,

domethënë nuk kanë status publik dhe në këtë rast - meqenëse kanë status privat dhe me pronarë privat, është jo shumë e thjeshtë për të filluar që ju të bëni aktivitet atje, mirëpo meqenëse ne tani pas kalimit të Këshillit komunal e dhamë edhe detyrën projektuese për planin gjeneral, në kuadër të planifikimit gjeneral të qytetit normalisht në diskutim me të gjithë pronarët e të gjitha lokaleve atje dëshirojmë të japim disa propozime për rigjallërim të atyre vendeve dhe shpresoj që brenda këtij mandati, do të hasim në mirëkuptim, por edhe në bashkëpunim për t'i bërë edhe ato vende po ashtu të shërbyeshme më të sigurt dhe më efikase për qytetarët", deklaroi Arifi.

Pas ndërtimit të kompleksit të ri, përkatësisht Qendrës së re Tregtare "Triada" në qendër të Tetovës, ku u hapën me qindra lokale dhe biznese të ndryshme, qendra e vjetër filloi teposhtëzën. "Ato pak biznese që punojnë në këtë qendër

kërkojnë që Komuna e Tetovës të mendojë edhe për këtë qendër dhe të rregullojë të paktën parkingun dhe ndriçimin publik. Arsytet janë të shumta që nuk vijnë vizitorët, kushtet nuk janë si më parë, apo siç ka qenë në fillim, tregtarët ikin prej këtu, janë hapur qendra të reja. Fillimisht nuk ka parking të mirëfilltë, që 5 vite tualete publike nuk ka, kushtet janë mizore, duhet komuna të rregullojë parkingun, ndriçimin publik dhe ndoshta klientela e vjetër do të kthehet. Shumë herë janë marrë iniciativa, por kanë dështuar", thonë pronarët të lokaleve. Me kalimin e kohës u pakësuan vizitorët, u mbyllën shumë lokale, ndërsa e njëjta gjithnjë e më pak frekuentohej, kurse pronarët e lokaleve dhe ato që ishin me qira u larguan. Ngelën vetëm disa prej tyre, të cilët e mbajtën gjallë këtë kompleks, duke mos patur rrugëdalje tjetër dhe duke punuar sa për të mbijetuar.

MË SË SHPESHTI NË RRUGË DHE OBJEKTE HOTELIERIKE

PËR TRE MUAJ, 126 SHKELJE LIGJORE NË GOSTIVAR

Costivar, 16 prill - Në tre muajt e fundit të këtij viti, në rajonin më të gjerë të Pollogut janë regjistruar gjithsej 126 shkelje të rendit dhe qetësisë publike. Numri më i madh i tyre (76) kanë ndodhur në rajonin e Gostivarit, ndërsa të tjerat (50) në rajonin e Tetovës. Sipas analizave të Sektorit për Punë të Brendshme në Tetovë, nga shkeljet në tremujorin e parë të vitit, në numër më të

madh janë sulmet fizike. "Nga gjithsej pesëdhjetë, 31 janë regjistruar në rajonin e Gostivarit, ndërsa 19 të tjerat në rajonin e Tetovës. Në këtë periudhë, ka pasur tetë përlëshje (në Tetovë shtatë dhe në Gostivar një). Në mesin e shkeljeve, janë regjistruar raste të grindjeve, bërtitjeve dhe sjelljes së pahijshme. Nga gjithsej 13, nëntë ishin në Gostivar, ndërsa të tjerat në Tetovë", thotë zëdhënësi

i SPB Tetovë, Marjan Josifoski.

Si shkelje të rendit dhe qetësisë publike, janë regjistruar edhe dhjetë raste të ofendimit dhe poshtërimit të personit të autorizuar zyrtar (në Tetovë tre dhe në Gostivar shtatë).

Në raportimet, si shkaktarë, gjegjësisht shkelës potencohen 145 persona. Numri më i madh i shkeljeve, janë zbardhur plotësisht dhe kanë përfunduar me 108

kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse. Sipas vendit të ndodhës së këtyre shkeljeve edhe këtë vit më shpesh janë rrugët dhe objektet hotelierike, derisa numri më i madh i shkelësve janë meshkuj të moshave të ndryshme.

Në tre muajt e fundit të këtij viti, shkelje të rendit dhe qetësisë publike ka pasur edhe rreth institucioneve arsimore, ndërsa tre ra-

ste të tilla ka pasur edhe gjatë organizimit të garave sportive. Për shkeljen e rendit dhe qetësisë publike, janë paraparë gjoba të cilat varësisht nga pasojat lëvizën nga 300 deri në 500 euro në kundërvlerë denari për përlëshje, për sulm fizik nga 600 deri 800 euro. Për ofendim dhe poshtërimit të personit të autorizuar zyrtar, është paraparë gjobë në vlerë prej 600 deri 800 euro. (U.H)

Menduh Thaçi!

Nga

Adelina MARKU



Gjyshi im, Baba Din, gjithë jetës ishte marrë me tregti. Ishte burrë i fisëm! E mbaj mend të shtyrë në moshë më, tek ngjitej rrugëve te Budulecit (në Dibër) e mbante në dorë tespi dhe një libër të vogël fare, si tip libërth xhepi e që në atë kohë nuk dija se përse e lexonte vetëm atë. Për më shumë, e lexonte çdo ditë! Unë ia çoja karanfilin e preferum. E donte erën e karanfilit, ndërsa e mbante gjatë karanfilin tim fijeve të librit "misterioz", për të cilin sot e kam kuptuar se ishte Kurani.

Gjyshi im ishte i pasur! Ndërsa kur erdhën partizanët të shndërruar tani në komunistë qeveritarë, ia morën të gjithë pasurinë! Do ia jepnin popullit, ashtu thanë!

Nuk prishi gjakun im gjysh edhe kur mbeti si i thonë "pa asnjë kacidhe". Si është i mundur i gjithë ai durim!? Tan' ajo gjakftohtësi?! Kam bindjen se, janë do perspektiva të rralla që e bajn jetën dhe njeriun në të, madhështore. Si për shëmbull, kjo mbi gjakftohtësinë e gjyshit! Urtësi i thonë! Ndër shumë, gjyshi la një t'spikatun mendim të tipit: "më mirë të të dalë syni se sa emri i mirë!". Më gjasë kur njeriu zgjedh me e ulë në trunin e zemrën e vet gjakftohtësinë në vend të hidhnmimit e vetëshkatërrimit, e kur këtë zgjedhje e ban në momente kur të tjerët ia denatyrojnë rritën e fuqisë e zhvillimit, atëherë ky njeri lyp me hap monologun e madh! Ndihej zërat nga brenda monologut sepse e ndërtojnë ngjarjen e kohës përmes vijës së gjakftohtësisë, prandaj them se asht mjaft e kuptueshme logjika e gjyshit tim mbi synin që donte me e ruajt! Sepse gjithmonë ore burrë, opo pikërisht gjithmonë, dikush ka me fol keq për ty sado i mirë të jesh! Prandaj, mbaje synin! Syni nevojitet...për më vonë! Ndërsa për zanin e mirë ki me dijt vetëm TI dhe varri yt!

Oh shumë gjatë kohë nuk e lidhja dot këtë vullunterizëm për me nxjerr synin para mundimit me mbajt reputacionin e mirë! Por kur kjo thanie arkaike lidhet me një tjetër mbi Liderët politik e që thotë: "Duhesh me qen pak i/e krisun për me mar n'shpin tan' përgjegjës in e fatit t'dynjasë!", sendet më qartësohen ngadalë. Nga kjo perspektivë, do provoj të analizoj sa "i krisun" është lideri i PDSH-së Menduh Thaçi! Do e filloj me këtë lider, sepse po na mbijnë thinja nga dilema e stërgjatë se a do hyn e pse do hyn në

qeveri ky e pikërisht në një kohë klariteti banal të trendit aliahmetian të tipi "oligopushtet"! Për më shumë, në këto ditë kur ky bëhet pjesë e një qeverie që shkon majtë, e Menduhi është i djathtë!? Por, kur të gjithë presin që Menduhi të ngulfatet thellë e djathtë e teposhtë, ky do kapërcen n'lug majtistësh! I tillë është, i paparashikueshëm! Ose që t'a kemi të qartë, ky lider ka ndërtuar sistem strategjie nga paparashikueshmëria gjëmuse e tij! Ose siç do thoshte e bukura Claire Forlani: "I am na unpredictable journey!"

Nëse ke harru i/e nderum/e lexis/e, ki shumë kohë që po jeton ndër pushtet e ideologji oligopushteti aliahmetizmi, apo! Unë madje, diku në 28 Janar të 2002 i pata botuar një pamflet këtij lideri në ardhje, në të atëherëshmen "Fakti" ndërsa veten e kisha pas mbajt gjithë Xhaferiste, me demek gjith'pdshiste! Mundohem të cilësoj motivet se përse ia kam pat shkruar këtë pamflet liderit që solli aliahmetizmin e nga kjo perspektivë kuptoj se ky shkrim i ngjan një tendence vetanake e shumë të zorshme për me u divorcu nga "procesi pjekan i Xhaferit", sepse Ali Ahmeti na kish përsheptu rrugëtimin përmes luftës e duhesh me qen ma i mirë (thoshin trimat konformistë të pasluftës!...). Por, ishte gjykim imi ky plot ambiguitete e


perverzisht sipërfaqësor e hipokrit, nxitan që s'më ngjite në asht tru! Sigurisht që zhgënjimi është galaktik, ndërsa pushteti aliahmetist vazhdon të jetë apokaliptik, e unë s'kam si e fshij atë pamflet që e kisha shkruar mbi Aliun. Dëgjo, fundja them, le turpnohet Aliu nga ajo se si e kam parë atëbotë, e jo unë, sepse krejt ndryshe mbaroi kumti i tij i filimit!

Nga perspektiva sot gjykoj se e vërteta e pamfletit me gjasë qëndronte tek Menduh Thaçi, lideri i paparashikueshëm i epokës sonë. Shumë nga neve pdshistëve, ky njeri na e kish robëruar, pothuajse përvetësuar besimin nga ajo ide e madhe. Ai mbarsej vazhdimisht me vetidenë e liderit të fortë e me cilësi të spikatuna organizative, kontroluese dhe makiaveliste! Për më shumë, as nuk e shifte të nevojshme të ngjyroste ndryshe lidshimin e tij! Shpesh, na loconte orbitave të vëmendjes së tij, e kjo na bënte të hutum kam e kry! Ndihej absolut, padyshim...ose, e shihnin si absolut njëkohësisht. Shumë nga ne insistonim të shihnim Liderin në të, e jo Absolutin! Kur e them këtë, e them me gjith' mend, sepse këtu qëndronte edhe gabimi i tij: nuk mund të përvetësosh ideologjinë sipas shijëve që t'i imponon fuqia e pushteti apo, nevojitet t'a lësh të lirë e t'a

sfidosh ndërmbështetësit e pafund, që të besojnë e lartësojnë e jo atyre që të qëndrojnë urtë e pabuksh! Menduhin e tërbonte ideja e fracioneve në parti! Mitet për të atëbotë ishin pothuajse sharllatanisht të gatume në një kuzhinë antipdshiste (këtë e them me bindje të plotë!), por përplot efekt në opinion: i korruptuar, përçarës, agresiv, i shërbimeve, dominant, intrigus, kaçak, ...iiii, s'kish fjalë të mirë për të! E pikërisht këtu më kujtohet gjyshi dhe thania e tij mbi synin; Menduhi as që mendohej të ndryshojë këtë perceptcion mbi të e që ish mitizuar ndër publikun e gjërë, ai madje ende tërbohej në krijim imazhi të një lideri krisplot! Me gjasë, del sypatrembur edhe kur gabon, ose ose, ky ndihej rrehat në lëkurën e vet! Gjakftohtësi në ardhje do e quaja këtë origjinalitet të tij! E përse atëherë të na sfidojë kaq shumë thinjështrimja gjithane e pritjes sonë syveshë nëse ky do hyka në qeveri ose jo?! E para përgjigje qëndron në faktin se politika shqiptare në Maqedoni është anemizu dhe adrenalina e një "të krisuri" do i mavijoste damarët e saj aty për aty. Përgjigja e dytë qëndron tek tërheqja e tij e gjatë nga vendimarrja politike ofanzive! Kështu e shoh unë këtë prurje të re në petkun thaçist. Shkëputja e Ziadinit nga korpusi i madh i pdshistëve ish-

te në fakt një mësim syçelje për Mendunë mbi vetë energjinë e madhe të PDSH-së, të cilën ai nuk arriti në kohën e duhur t'a pranojë e t'a sfidojë edhe më fuqishëm madje edhe përmes harlisjes së vet origjinale! E vërteta që të mburr është se korpusi i PDSH-istëve doli të jetë më i fuqishëm edhe se Menduhi por edhe se frakcionuesit, zgjedhje e zgjedhje me rradhë! Ky realitet në politikë quhet: ARGUMENT I GJALLË! Aq i fuqishëm sa lyp origjinën në momente kur denatyrimi nga aliahmetizmi është shndëruar në të pakry e prandaj lodhës edhe për vetë Alinë! Menduhi nuk është i mistershëm më, përkundrazi është shumë i lexueshëm për një vëzhgues si puna ime. Unë i kam parë gjithmonë si një tandem të përkryer tek ishin bashkë, Arbni ishte koka, ky ishte qafa! Kahmot kam dalur me gjykime se roli i PDSH në tan' historinë e pavarësisë së këtij shteti ka qenë strategjist, për më shumë e në paçim harruar edhe në dy momente të mëdha të gjëmimit të shqiptarëve në kohën e luftës së Kosovës por edhe në 2001. Siç do thoshte Arbni, PDSH modernizoi retorikën e luftës dhe e shtriu në legjislacion! Këtë e thotë edhe Aliu, nëse i referohem të vërtetës së Koço Danaj, në librin e tij " Kryengritje e pambarruar". Përsëri PDSH-ja e ktheu proce-

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovaska lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distributimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e hënë 16 prill | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distributim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

sin, sado instrumentat e shtetit-prandaj dhe opinioni, orkestralisht mohonin rolin e saj. Përsëri e ktheu te burimi i PDSH, tek besimi në proces. E njëjta u dëshmuar edhe tani, gjatë Përzhinës! Pikërisht aty ku fillimisht e mbante PDSH-ja "light motivin" e ideologjisë së vet, e padyshim koka nuk punonte pa lëvizjet e qafës apo. S'ka përse amnistoj Arbnin më tuj gjyku shtrembër Menduhin! Madje edhe sekularizmi ishte në vepër, sepse ky dinte të mbronte islamin shqiptar! Po, dinte t'a mbronte nga dhuna e tëhujzimit të instrumentalizum! Do ishte e pandershme sikur të gjykoja ndryshe, apo! Storja u acarua edhe më tej, sulmin e rrëndomtë politik e pothuajse shfarosës që ia gatoi bomba e kryeministrit të tanishëm mbi "besnikërinë" e devotshme menduhiane (!?) ishte pothuajse kataklizmike për Thaçin. Prandaj ky, tërheqjen e shndëroi në strategji! Heshti e përsëri heshti gjatë! Një makiavelizëm me vetëdije! Opinioni kuptoi heshtjen e tij sikur ai s'ka ç'të thotë më e se ka ardhur koha të ikë nga skena politike.

E vërteta është se heshtja e tij është përsëri paparashikueshmërisht strategjike, ngase s'ka tjetër më krisshëm guximtar në kuptimin e paparashikueshmërisë së shtetit ku jetojmë ne dhe synimit tonë në të. Ai, është lider që simbolin politik për veten dhe gjëmat e veta e krijoi pikërisht përmes Strategjisë mbi Paparashikueshmërisë! Dhe nuk u turpnua asnjëherë t'a pranojë si strategji politike. Madje as ta modelojë për tjetër! Si i paturpshëm që është, shqiptarët kanë filluar t'a kërkojnë amplitudën e parrehatshme të lidërshipt të tij e të pyesin, çka fshihet pas heshtjes së madhe të tij? Tanimë kur ky rebel i tërbuar i skenës politike të shqiptarëve të Maqedosnië ka ulur vetëdijshmëm gjakftohtësinë në karrikën e fuqisë personale e namit të dikurshëm, flet saktë mbi besimin e tij të fortë (e jo doemosdoshmërisht të drejtë!) se të gjitha kurset e veprimt janë të rrezikshme kështuqë matura nuk qëndron në shmangien e rrezikut (është e pamundur!) por në llogaritjen e rrezikut dhe në veprimin e vendosur. Thaçizmi, dorën në zemër, u ndërtua përmes gabimeve të ambicies e jo gabimeve nga përtacia e mosdija ose inferioriteti, prandaj me gjasë kësaj here ky do sfidojë paparashikueshmërinë e lidërshipt të vet duke parë të zhvillojë forcën mbrothuse për të bërë gjëra të guximshme dhe jo forcën për të vuajtur! Një si tip teknike gjarpni e quajnë startegjistët politikë!

Me gjasë... çdo vendim tjetër do rrëshqiste në kënetë të re! Për më shumë, me një dozë thaçizmi në këtë oqean zaevist gjërat do duke-shin përsëri... SFIDUSE, këtu jemi dakord besoj!

(Autorja është kolumniste e rregullt e gazetës KOHA)

SAMITI I SOFJES OFRON MË PAK SE AI I SELANIKUT PARA 15 VJETËSH

A është diçka sukses apo dështim varet nga pritjet. Kështu do të jetë edhe me vlerësimin e Samitit të Sofjes, ku pritet të mblidhen liderët e 28 shteteve të BE-së dhe "partnerët" nga Ballkani Perëndimor. Jo, nuk është gabim, vërtet në letër presidentët apo kryeministrit e BE-së do të jenë nga "shtetet", ndërsa ata të Ballkanit nga "parterët". Kjo qëllimisht për shkak të Kosovës, e cila nuk njihet si shtet i pavarur nga të gjitha vendet e BE-së, dhe si pasojë as nga BE-ja.

Kjo ka bërë që, sikur në vitin 2000 në Samitin e Zagrebit, dhe në vitin 2003 atë të Sofjes, pjesëmarrja e Kosovës dhe forma me të cilën do të trajtohet ajo të jetë tema kryesore politike në përgatitjet e këtij samiti. Kjo dëshmon edhe një herë se sa pak serioze BE-ja është në politikën e saj ndaj rajonit të Ballkanit Perëndimor kur nuk ka ende përgjigje as në pyetjen se sa shtete ekzistojnë në rajon, dhe si pasojë sa kandidatë për anëtarësim të ardhshëm në BE. Debatit tash e sa javë më shumë është zhvilluar rreth asaj se për çfarë nuk bën të jetë ky samit, sesa për çfarë do të jetë. Kështu, në përgatitjet e samitit, siç i kanë konfirmuar "Kohës Ditore" disa burime diplomatike, duhet adresuar shqetësimet e Spanjës dhe të disa shteteve të tjera që nuk e kanë njohur Kosovën, dhe po ashtu edhe kërkesat e disa shteteve shumë të rëndësishme të BE-së që në asnjë mënyrë nuk duan që ky samit të jetë për zgjerim.

Në draftin e përgatitur për këtë samit, në të cilin janë duke punuar strukturat e BE-së dhe të vendeve anëtare, para se të konsultohen edhe "partnerët" nga Ballkani Perëndimor, nuk përmendet në asnjë vend "zgjerimi i BE-së", por vetëm programe dhe projekte të konektivitetit, luftës kundër terrorizmit dhe radikalizmit, ripajtimi dhe agjenda digjitale për Ballkanin Perëndimor. Do të ketë shumë kërkesa për "partnerët" nga Ballkani Perëndimor, që nga lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, bashkëpunimi në çështjet e migracionit, e deri te tejkalimi i problemeve që kanë mbetur nga e kaluara. Më së shumti në samit pritet të përmendet konektiviteti dhe të gjitha dimensionet e tij nga transporti, energjia, konektiviteti socioekonomik, digjital, ekonomik dhe njerëzor.

Pjesëmarrja e Kosovës ka qenë mjaft e diskutueshme edhe në dy samitet historike të BE-së me Ballkanin. Në Samitin e Zagrebit në vitin 2000, Kosovën e kishte përfaqësuar Bernard Kouchner, shefi i atëhershëm i UNMIK-ut, dhe atë jo në të gjitha takimet formale. BE-ja në atë kohë nuk donte ta irritonte Serbinë. Në Samitin e Selanikut, Kosovën e kishin përfaqësuar së bashku shefi i atëhershëm i UNMIK-ut, Michael Steiner, së bashku me presidentin e atëhershëm Ibrahim Rugova dhe me kryeministrin Bajram Rexhepi. Greqia si organizatore nuk kishte pranuar shantazhet e Serbisë që, nëse ftohet Kosova ata nuk do të merrnin pjesë. Por në Deklaratën e Samitit, pjesëmarrja e Kosovës nuk figuron, por vetëm pjesëmarrja e të dërguarit të posaçëm të sekretarit të përgjithshëm të OKB-së në Kosovë. Por të dy këto samite ishin zhvilluar në kohën kur Kosova ende nuk kishte status, ndërsa tash pjesëmarrja e Kosovës duket të jetë edhe më problematike sesa më parë, për shkak se në BE nuk ka unitet rreth Kosovës. Kështu, në fund, i tërë debati për mënyrën e pjesëmarrjes do të vërë në hije përmbajtjen e vërtetë të këtij samiti, i cili mund të jetë sukses konkret në temat që do të diskutohet, por dështim në aspektin politik, sepse më shumë sesa unitet BE-ja do të dëshmojë ndasitë që ekzistojnë jo vetëm rreth Kosovës, por në përgjithësi rreth procesit të zgjerimit.

Pa marrë parasysh se si do të zgjidhet dilema për të siguruar pjesëmarrje "inkluzive", pra edhe të të gjitha vendeve të BE-së e edhe të gjithë "partnerëve" nga Ballkani Perëndimor, ata që kanë pritur shumë nga ky samit në aspektin e procesit të zgjerimit të BE-së do të jenë të zhgënjyer. Nga ky samit nuk do të dalë asgjë konkrete, as e re. Madje sa i përket perspektivës së avancimit drejt anëtarësimit në BE do të jetë shumë më pak ambicioz sesa që ishte para 15 vjetësh, në kohën kur u zhvillua samiti në Neo Marmaras afër Selanikut. Kjo shihet qartë nëse bëhet një krahasim i Deklaratës së Samitit të Selanikut me atë që pritet të miratohet në Sofje. Deklarata e Samitit të Selanikut thoshte mes të tjerash:

"BE-ja rithekson mbështetjen e pazezervë për perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor. E ardhmja e Ballkanit është në Bashkimin Evropian. Zgjerimi që po

vazhdon dhe nënshkrimi i Traktatit të Athinës (traktati i anëtarësimit në BE për 10 shtete) në prill 2003 frymëzojnë dhe inkurajojnë shtetet e Ballkanit Perëndimor që të ndjekin të njëjtën rrugë të suksesshme. Përgatitjet për integrim në strukturat evropiane dhe anëtarësimi final në Bashkimin Evropian, përmes adoptimit të standardeve evropiane, janë tash një sfidë e madhe përpara".

Ndërsa sa janë zvogëluar ambiciet 15 vjet më vonë shihet nga ajo se çfarë përmban tash drafti i Deklaratës së Sofjes, ku nuk përmend as zgjerimin e as mbështetjen për anëtarësim në BE, por vetëm në mënyrë abstrakte dhe filozofike flet për "perspektivën evropiane" apo edhe më abstrakte për "rrugën evropiane". "BE rithekson mbështetjen e pazezervë për perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor. Rruga evropiane mbetet e bazuar në kriteret e vendosura dhe në meritat individuale. Partnerët nga Ballkani Perëndimor rikonfirmojnë përkushtimin për perspektivën evropiane si zgjidhje e tyre e vendosur strategjike, dhe rforcojnë përpjekjet e tyre për të arritur këtë qëllim".

Përderisa Deklarata e Samitit të Selanikut u referohej në disa raste "zgjerimit", "anëtarësimi në BE", "integriteti në BE", në Deklaratën e Sofjes, nëse nuk ndryshon diçka ndërkohë, asnjë nga këto terme të sakta nuk do të përdoret, por vetëm terme boshe si "perspektiva evropiane" dhe "rruga evropiane". Kjo e bën këtë samit të jetë shumë larg edhe nga ajo që vendeve të Ballkanit Perëndimor u ishte ofruar në Selanik para 15 vjetësh, edhe pse do të ishte më e logjikshme që tash t'u ofrohet më shumë dhe një perspektivë më e qartë se para 15 vjetësh. Edhe pse kanë shumë probleme vendet e rajonit, me gjithë procesin e ngadalshëm, kanë bërë, megjithatë, një rrugë të konsiderueshme drejt integritetit. Në kohën e Samitit të Selanikut asnjë nga vendet e Ballkanit nuk kishte as status kandidati, ndërsa vetëm Kroacia, dhe atë vetëm dy muaj para këtij samiti, kishte aplikuar për anëtarësim. Kosova nuk e kishte të zgjidhur statusin dhe Deklarata e samitit mbështeti qasjen "standardet para statusit". Tash katër shtete kanë status kandidati (Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia), një është në procedurën e marrjes së statusit të kandidatit (Bosnjë-Hercegovina). Mali i Zi dhe Serbia



Nga Augustin PALOKAJ

kanë avancuar në negociatat e anëtarësimit, ndërsa Shqipëria dhe Maqedonia presin t'i nisnin këto negociatat. Kosova ka një Marrëveshje të Stabilizim-Asociimit dhe po mendon të aplikojë për anëtarësim në BE. Shumë pak nëse merret parasysh se kanë kaluar 15 vjet, por megjithatë është një rrugë e kaluar. Kroacia është e vetmja që bëri tërë rrugën dhe tash e 5 vjet është anëtare e BE-së. Por tash mungesa e entuziazmit për zgjerim në BE është shumë e qartë. Arsyet pse është kështu janë të qarta. Së pari, është mungesa e liderëve guximtarë dhe vizionarë në BE sot krahasuar me 15 vjet më herët. Së dyti, është ndryshimi i disponimit në vendet e BE-së dhe tek qytetarët evropianë rreth zgjerimit. Ish-presidenti i Komisionit Evropian, Romano Prodi, këtë e pati definuar para 5 vjetësh kështu: "Në kohën tonë kishim Evropën e shpresës e sot kemi Evropën e frikës". Dhe Prodi, si mbështetës i fuqishëm i zgjerimit, e i tillë ka mbetur edhe sot, kishte të drejtë. Vërtet zgjerimi i BE-së atëherë shihej si projekt paqeje, si shpresë, si ideal i një gjenerate e cila po e bashkonte Evropën. Zgjerimi sot shihet më shumë si frikë se mos në BE po hyjnë vendet e pazhvilluara të Ballkanit, ku lulëzojnë krimi i organizuar dhe korrupsioni. Liderët e sotëm të BE-së nuk kanë guxim të kërkojnë përsheptimin e anëtarësimit të Ballkanit në BE, me çka do të përmbylej përfundimisht edhe projekti i bashkimit të Evropës, e as të premtojnë se një gjë e tillë është e mundur në të ardhmen. Ata nuk kanë guxim as të thonë se zgjerimi nuk është në plan në një të ardhme. E dinë se perspektiva e anëtarësimit në BE ndihmon në qetësimin e rajonit, por problemi qëndron në faktin se edhe politikanët e rajonit e kanë mësuar lojën, flasin për integritet në BE dhe për "standarde evropiane", por në anën tjetër punojnë për të shkruar në drejtim të kundërt nga këto standarde.

(koha.net)



FILMI "KTHIMI" I KASTRIOT ABDYLIT VJEN PËR PUBLIKUN E SHKUPIT

Filmi "Kthimi" i regjisorit Kastriot Abdylit Premierën do ta ket më 18 prill në Cineplexx (City Mail), dhe prej 19 Prillit do të jetë në repertuarin e rregullt në Cineplexx. Film është koprodukcion i parë mes Maqedonisë dhe Kosovës, realizuar nga "Dardania Film" Shkup & "Shkupi Film" Prishtinë

Filmi është një dramë që ngërthen kontardita mes kulturës përëndimore dhe asaj shipatrë që shkaktojnë situata komike.

Në rolet kryesore paraqitet Delphin Depardieu, aktorja nga Franca (njëherit nbesa e aktorit me famë botrore Xherard Depardeu në rolin e Sabinë. Krahas saj në rolet kryesore paraqiten Selman Lokaj, Hazir Sh. Haziri, Liridona Shehu, Safete Rogova, Sefedin Nuredini.

Skenarin e filimi e ka bërë Kastriot Abdylit së bashku me Isa Qosën. Drejtori i Fotografisë Vlatko Samoilovski, Kostumograf Izet Curri, Skenograf Zeni Ballazhi, Kompozitorë Memli Kelmendi, Montazhier Kastriot Saqipi dhe Blagoje Nedelkovski, Producent Ekzekutiv Simeon Damevski

Në rolet tjera paraqiten: Xhevat Qoraj, Shkëlqim Islami, Ismail Kasumi, Labinot Lajqi, Valon Bujupi, Virus Shala, Venera Lumani, Zijadin Murtezi, Teuta Ajdini,



Hamdi Rashiti, Muqbjadin Qamili, Nikola Kumev, Avdullah Gjokoka, Ellhame Bilall, Beqir Nuredini, Shota Baraliu, Muzafer Etemi, Fle-

rentina Ademi, Valdete Ismaili, Donika Ahmeti, Enver Halimi, Agim Sulejmani, Ramadan Malaj, Abdurahman Rahman, Shkup Abdylit,

Jon Saqipi, Arb Abdylit, Rron Grajqevci, Nadire Ismaili Salihu, Burhanedin Salihu Metush Agjani, Shoqëria Kulturo Artistike "Karshiaka".

"Ngjarja zhvillohet në një fshat shqiptarë. Ilir, një i ri shqiptar nga Maqedonia që emigroi në Francë, ka vendosur të martohet me një franceze me emrin Sabine. Për shkak të çështjeve ligjore (Iliri hyri në Francë në një vizë të rreme) ai duhet të kthehet në fshatin e tij të lindjes për t'u martuar. Kjo duket si një mundësi e madhe për ta parë familjen e tij përsëri pas shtatë vjet mungese dhe për Sabine që të mësojë më shumë për rrënjët e tij. Sidoqoftë, vizita e tyre e papritur bëhet e tharë kur babai i Ilirit, një burrë tradicional i moshuar, e kupton se djali i tij është kthyer vetëm për t'u martuar me një grua të huaj dhe pastaj për t'u larguar, duke thyer "Besën" që ai i kishte bërë Bardhës, një vajze nga fshati i tyre.



ART I ROMANIT TË MILAN KUNDERËS

Në vitet 1980 të gjithë lexonin "Lehtësia e padurueshme e të qenit" dhe "Libri i të qeshurës dhe harresës". Por, teksa ai po boton një roman për herë të parë pas dymbëdhjetë vjetësh, çfarë emri gëzon sot shkrimtarit çek dhe a është dëmtuar në mënyrë të pakthyeshme për shkak të mënyrës si i portretizon gratë?



Në faqen e parë të romanit të ri të Milan Kunderës botuar në Francë vitin e kaluar, kur autori i saj ishte 85 vjeç, dikush po ecte nëpër një rruqicë pariziane, në qershor, pikërisht në kohën kur "dielli i mëngjesit po dilte nga retë". Emri i tij është Alain. Nuk e dimë ç'moshë ka, apo si duket, por dimë se është intelektual, sepse teksa kalon përbri vajzave të reja me kërtizën jashtë, pamja e tyre e fut në një mori përsiatjesh që orvaten "të përshkruajnë dhe përcaktojnë veçantinë" e "orientimeve erotike" të ndryshme.

E kush tjetër mund ta kishte shkruar këtë pjesë, përveç Milan Kunderës? Dy prej figurave letrare kryesore të romaneve të tij janë të pranishme e të sakta dhe zënë faqen e parë dhe gjysmën e faqes së dytë: së pari, ato shprehin zotërimin e vështrimit mashkullor, i ngulitur mbi trupin e femrës, i "magjepsur" prej tij, duke ngritur një teori të përpunuar mbi bazën e asaj që sheh. Së dyti, majat e larta të kësaj teorie, e cila krijohet "në qendër të fuqisë joshëse femërore", jo siç perceptohet nga "një burrë", por nga "një epokë", dëshmojnë për ambicien e një romancieri, i cili e ka bërë detyrë të jetës së tij që të farkëtojë lidhjet midis ndërgjegjes individuale, rrymave të historisë dhe politikës. Pas më shumë se një dhjetëvjeçari do të botohet në anglisht i pari roman i Milan Kunderës. Libri "Panairi i kotësisë", është përfaqësues tipik, në mos klasik i artit të Kunderës. Është libri i një plaku dhe ndërsa në të rrëzëllejnë shenja të një urtësie të arrire e të gjallë, do të ishte e habitshme sikur në të të mos kishte diçka vjeshtake. Po t'u hedhim një vështrim kopertinave të pasme të romaneve të Kunderës të publikuara nga shtëpia botuese "Faber", zbulojmë një mori citimesh prej autorëve të të njëjtit kalibër si: Ian McEwan, Selman Rushdi dhe Karlos Fuentes, shumica e të cilëve janë 30 vjet më të mëdhenj se ai, duke na kujtuar se emri i tij kishte arritur kulmin në vitet 1980,

një dhjetëvjeçar kur gjithkush lexonte veprën Libri i së Qeshurës dhe Harresës dhe Lehtësia e Padurueshme e Qenies.

Na duket e drejtë të themi që emri i tij do të bazohet mbi tre romane madhështore të "moshës së mesme": Libri i së Qeshurës dhe Harresës, Lehtësia e Padurueshme e Qenies dhe Pavdekësia. Para këtyre veprave kemi një triptik të romaneve serio-komike si: Shakaja, Jeta Është Diku Tjetër dhe Valsi i Lamturmirës, që të sjellin në mendje Çekoslovakinë e pasluftës dhe të epokës komuniste, pa përmendur pretendimin për origjinalitet që do të bëhej vula e Kunderës.

Më pas, kemi treshen e novelave të shkurtra, të vogla: Ngadalësia, Identiteti dhe Padituria, të cilat vetëm me titullin nxjerrin në pah sa priret filozofike, aq edhe statusin e tyre si trillime letrare. Megjithatë, janë librat e moshës së mesme ata që zbuluan se Kundera gjeti jo vetëm zërin e veçantë letrar, por edhe formën e tij të përsosur. Ato janë romane të mërgimit, të shkruara në mërgim. Ai u largua nga Çekoslovakia në vitin 1975, pasi ishte hequr nga puna si mësimmëdhënës, pa të drejtën për të punuar dhe pasi

pa që romanet e tij u ndaluan në bibliotekat publike. Ardhja e tij në Paris, përkoji me një ndryshim të rëndësishëm të drejtimit letrar. Vepra e tij Libri i të Qeshurës dhe Harresës shmang rrëfimin tradicional linear dhe në vend të saj shpaloset si pjesë historish të ndërlydhura, të mbajtura së bashku pjesërisht nga karaktere të përsëritura, por më fort nga tema, fjalë dhe motive të rimarra. Ishte sikur teksa peshonte spirancën e atdheut, Kundera çlironte edhe veten nga prangat e rregullave të zakonshëm. Romani kishte një rrjedhshmëri të pabesueshme, një lehtësi për t'u pasur zili në kalimet e saj nga të rrëfyerit e një tregimi, te të shkruarit e eseve dhe anasjelltas.

Nëpërmjet kësaj historie dhe të tjerave që lidhen me të, vepra Libri i së Qeshurës dhe Harresës, ndriçon bukur kulmet e jetës sonë, ku identiteti, thelbi i vërtetë i vetes sonë përmes kujtesës, gërshetohet me forcat politike që janë në konflikt me të. Kjo është një temë e pandashme nga konteksti në të cilin u rrit Kundera, bota e komunizmit të epokës sovjetike, një kontekst që magjepsit dhe në një farë mase traliti vëzhguesit perëndimorë në vitet '70 dhe '80 dhe mbi të cilin romanet

e tij dukej se hapnin një dritare unike, duke nxjerrë në pah kompleksitetin e tij përzier me ironi të pashoqe, me melankoli dhe ashpërsi intelektuale. Nuk është çudi që kur u botuan për herë të parë, këto romane dukej se ishin ndër dokumentet më të rëndësishme letrare të kohës së tyre. Pikërisht në gjurmë të këtyre romaneve erdhi një libër që ndër të tjera rrekej t'i shpjegonte këto vepra të mëparshme: Arti i romanit, një koleksion prej shtatë esesh, ku Kundera parashtronte konceptimin e tij mbi traditën romaneske europiane dhe vendin e tij brenda saj. Teksti kyç në analizën e tij ishte vepra Somnambulët nga Hermann Broch, një trilogji të cilën në atë kohë lexuesit bfitanikë e njihnin pak dhe sot lexohet edhe më pak. (Në fakt, në këtë vend nuk gjen dot botime të këtij libri në treg.) Në këto libra edhe Broch u përpoq të bënte një sintezë të llojeve të ndryshme, por sipas pikëpamjes së Kunderës "disa elemente (vargu, rrëfimi, aforizmi, reportazhi, eseja) janë më shumë të ndodhura pranë e pranë, sesa të përziera në një unitet të vërtetë 'polifonik'. Nën dritën e këtij uniteti, është e vështirë të mos shohësh të gjithë veprën e Kun-

derës të shkruar pas mërgimit, si një përpjekje për të vazhduar detyrën që kishte filluar Broch dhe si një triumfues në kuptimin që, përzierja që u bën ai këtyre elementeve duket vërtet e përsosur dhe organike. e tij nuk janë, por kur erdhi radha për të përcaktuar se çfarë janë, ai ishte më pak i qartë.

Nga shkrimet e tij, duket se Kundera nuk do ta konsideronte veten si pjesë e kësaj tradite të shkrimtarëve "vërtet të mëdhenj", drejt të cilëve pa dyshim synonte edhe Banville. Shumë nga romancierët e tij të preferuar, Stern, Didero, Broch, Musil, Gombrowicz, me të vërtetë i përkasin asaj rryme ironikësh, me shkrimet plot nënkuptime, ku autorët janë aq të vetëdijshëm për kontradiktat, grackat dhe prapaskekat e natyrshme në aktin e krijimit të trillimeve letrare, sa në një pikë vetë librat e tyre shndërrohen në parodi, ose në një marrje në pyetje të vetvetes. Vendi i Kunderës brenda këtij panteoni të veçantë duket i sigurt, por me një paralajmërim të rëndësishëm: më pak e pranishme se kudo, ndjenja e Banville për "jetën e jetuar" gjendet në portretizimin që u bën Kundera personazheve femra.

ORNELA VORPSI, ARTISTJA QË SJELL JEHONË NDËRGJEGJEGJE



Tirana gumëzhinte këtë javë që po mbylлим nga deklarata e artistes Ornela Vorpsi, e cila e ftuar në një emision, tha se Parisi u impresionua nga Edi Rama dhe se ajo e kishte dashuruar nga larg, pasi ishte profesori i saj. Nëse bën disa kërkime, kupton se Ornela dhe Rama kanë disa të përbashkëta. Përveç pasionit dhe talentit për artin, ai për pikturën dhe ajo për fotografinë, ata kanë një ngjyrë të preferuar, të kuqen. Ashtu si Rama i cili veshi zyrën e tij me të kuqe kur ishte kryetar Bashkie, edhe Ornela Vorpsi kur fotografon nudo, ka të spikatur të kuqen, madje edhe shtëpinë e saj e ka të lyer me të kuqe.

E zbulon këtë detaj "Figaro", një revistë franceze e cila ka bërë një shkrim për të kur ajo publikoi librin e saj të parë me nota autobiografike. Artistja e njohur, e cila prej vitesh jeton në Paris, bëri shumë bujë kur botoi romanin e saj të parë "Vendi ku nuk vdes kurrë". Pak nga historia dhe adole-

shenca e saj në diktaturë, me një baba të dënuar politik dhe e kaluara e shqetësuar, Ornela Vorpsi e derdh në të kuqe. Ja çfarë shkruante në atë kohë "Figaro magazine" për artisten shqiptare.

"Kësulëkuqja e vogël nuk ishte e kuqe. Ndërsa ujku, ai po, ishte i kuq. Quhej Enver Hoxha, si diktatori komunist shqiptar. Ai nuk do t'i përpinte vajzat e vogla. Jo, nuk ua kish-

te nevojën, për aq sa ato nuk kishin as pite, as poçe me gjalpë për t'ia çuar gjyshes së tyre. Kjo ishte, mbretëria e Hoxhës: mung-ese për gjithçka. Dhe burg për ata që guxuan të ankohen. Kështu, shumë vogëlushe shqiptare u gjendën papritur pa baba, ashtu si tregimtarja e "Vendit ku nuk vdes kurrë".

Kjo adoleshente, e quajtur njëra pas tjetrës, Elona, Ornela apo

Eva, fiton çdo ditë eksperiencë nga ajo fjala e urtë shqiptare që në rrëfimin e saj kthehet në një lajtmotiv: "Jeto që të të urrej dhe vdis që të të qaj". Hirushja e vogël duke pritur zanën e saj të mirë, ndan mjerimin e përditshëm me një nënë në shoqërinë e njëfarë melankolie, e pangushëlluar që nuk mundi të kishte për burrë një Alen Delon. Elona-Ornela-Eva ka trashëguar buku-

rinë e saj, çka do të thotë një pasuri e madhe, e rëndë, në një shoqëri ku akuza për 'imoralitet' ndynte fytyrat e bukura dhe shtynte siluetat shtatderdhura. Ajo shqiptonte fjalët e saj të para si fjala e fundit që do vuloste destinin e saj: "Nuk do të jetë vonë për t'u bërë një kurvë e bukur, he he..."

Nga këto fjalë poetike të ëmbla e të hirshme, "Vendi ku nuk vdes kurrë" u stërpik nga yjet. E lexon këtë roman dhe një lëmsh të mblidhet në fyt, sytë të njomen, i mahnitur nga talenti i autorit të librit. Ornela Vorpsi, të jetë vallë produkt i imagjinatës sonë? Jo, ajo ekziston vërtet. E takuam një mbrëmje dhjetori. Është një grua e bukur me të qeshurën femërore dhe sy të shqetësuar, e cila jeton në Paris në një apartament ve-shur në të kuq. Si ajo e kuqja e tablove që pikturon – "për të shprehur shqetësimin". Esh-të fotografë!" – shkruan revista franceze. (PanoramaPlus)

JETA DHE VEPRA

Federico García Lorca u lind në Fuente Vaqueros një fshat në Granda një qytet në Spanjë dhe vdiq në vitin 1936 në Granda. Ai ishte poet, shkrimtar, dramaturg, drejtor teatri. Fredriko Garsia Lorca është i njohur ndërkombëtarisht për pjesëmarrjen e tij në luftën civile spanjolle ku udhëhoqi forcat anti-fashiste për të penguar forcat fashiste të udhëhequra nga Gjenerali Francisco Franco. Mendohet se Garsia Lorca është vrarë nga forcat ushtarke anti-komuniste në fshatin Alfacar në Granada, edhe sot e kësaj dite shumë gjëra janë të paqarta mbi vdekjen e Garsia Lorkës.

Në vitin 1909 kur Garsia Lorca ishte 11 vjeç familja e tij u zhvendos në qytetin Granada në jug-perëndim të Spanjës pastaj Garsia Lorca ndoqi dhe u diplomua në shkollën e mesme dhe ndoqi studimet në Universitetin Sacred Heart ku studioi artin dhe letërsinë ku dhe nxori veprat e para poetike.

Në fillim të viteve '20 në Madrid është i afërt me artistë të famshëm si Dalí, Buñuel e sidomos Jimenez. Pas diplomimit jeta e tij është plot krijimtari dhe aktivitete si dhe miqësi të reja, nga Pablo Neruda tek Ignacio Sánchez Mejías. Udhëton shumë, sidomos në Kubë e SHBA, ku përballat me kontrastet tipike të një shoqërie të zhvilluar. Krijon grupe teatrale të pavarura dhe i kushtohet jetës kulturore spenjolle.

Më 1936, pak para shpërthimit të luftës civile, Garcia Lorca përplilon dhe firmos, bashkë me Rafael Albertin (poet tjetër i shquar) edhe me 300 intelektualë të tjerë spanjollë një manifest në mbështetje të Frontit Popullor, i cili botohet në gazetën komuniste Mundo Obrero më 15 shkurt, një ditë para zgjedhjeve të fituara për pak vota nga e majta.

Më 17 korrik 1936 shpërthen kryengritja e armatosur kundër qeverisë së Republikës, që kishin dalë nga zgjedhjet e 15 shkurtit: fillon kështu lufta civile spanjolle. Më 19 gusht Federico García Lorca, i cili ishte fshehur në Granada tek disa miq, gjendet, rrëmbehet dhe dërgohet në Viznar, ku pak hapa larg një burimi të njohur si Burimi i Lotëve, vritet brutalisht pa asnjë proces. Përmbledhjet poetike:

1918 - Impresiones y paisajes

1921- Libro de poemas

1921 - Poema del cante jondo

1923 - Suites

1924 - Canciones

1928 - Romancero gitano

1928 - Odes

1930 - Poeta en Nueva York



FEDERICO
GARCÍA LORCA

NËSE DUART E MIA DO TË KËPUTNIN GJETHET

*Unë shqiptoj emrin tënd
netëve të errëta,
kur yjet vijnë të pinë
në burimin e hënës,
kur degëve të fshehta
dremitin gjethnajat.
E unë ndihem si një zgavër
tingujsh pasioni dhe muzike.
Sahat i çmendur që këndon
orët e vdekura që kanë ikur.*

*Unë shqiptoj emrin tënd
këtë natë të errët pus,
dhe emri yt më tingëllon
më i largët se asnjëherë.
Më i largët se të gjithë yjet,
më i përvajshëm se shiu i butë.
A do të të dua përsëri,
siç të desha dikur?
O zemër, sa paske gabuar!
Nëse mjegulla davaritet,
çpasion tjetër më pret?
A do të jetë i butë e i kulluar?
Ah, sikur gishtat e mi, o hënë,
të këputnin dot gjethet e tua!*

DËSHIRË

*Vetëm zemra jote e nxehtë,
Dhe asgjë më shumë.*

*Parajsa ime, një fushë
Pa bilbila
As lira,
Me një lum të fshehtë
Dhe një burim të vogël.*

*Pa shpurë erë
Mbi gjethnajtë,
Pa yllin që dëshiron
Të jetë gjethe.*

*Një dritë e madhe
Që ishte
Xixëllonja
E një tjetre,*

*Në një fushë
Me shikime të prishura.
Një prehje e qetë
Dhe atje puthjet tona,
Tinguj hënor
Të jehonës,
Hapen shumë larg.*

*Dhe zemra jote e nxehtë,
Dhe asgjë më shumë.*

VALSI I DEGËVE

*Ra një gjethe
dhe dy
dhe tre*

*Në hënë notonte një peshk.
Uji fle një orë
dhe deti i bardhë njëqind fle.*

*Një zonjë e re
ishte e vdekur nëpër degë atje.*

*Një murgeshë
këndonte brenda në një qitro.*

*Një vogëlushe
nëpër boçe ikte në pishë.*

*Dhe pisha vraponte
majën e cicërimës kërkonte.*

*Por bilbili i ri
qante për qark plagët e tij.*

*Dhe unë poashtu
sepse ra një gjethe
dhe dy
dhe tre.*

*Dhe një kokë kristali
dhe një violinë prej letre
dhe bora do mundej me botën
nëse bora do të flinte një muaj përdhe,
dhe degët do luftonin me botën
një nga një,
dy nga dy,
dhe tre nga tre.*

*Oh fildish i fortë prej mishrash të padukshëm!
Oh gji pa milingona në agim!
Me fësh-fësh-in e degëve në pemë,
me ah-un e zonjave po them,
me kuak-un e bretkosave që gjen
dhe me klluk-un e të verdhit mjalt.*

*Do të vij një hije trangu
i kurorëzuar me dafina nga lart.
Do të jetë një qiell për erën
i fortë si një mur
dhe degët e shqyera
do të shkojnë të kërcëjnë me të si dikur.*

*Një nga një
përreth hënës,
dy nga dy
përreth diellit,
dhe tre nga tre
për fildishet që të qetë flenë.*

Fataliteti i marrëdhëniesve serbo-shqiptare

“Do të kalojnë breza derisa emocionet dhe armiqësitë të qetësohen.” “Kujtime në shishe” kjo metaforë, e vënë në mënyrë domethënëse si titull e si frymë që e përshkon gjithë novelën, të kujton praktikën e njohur botërore të futjes së kujtimeve në shishe dhe hedhjen e tyre në det, për t’u gjetur e lexuar e vërteta e ngjarjeve të

kobshme drejtpërdrejt nga protagonistët, kushedi se kur.

Fataliteti i marrëdhëniesve serbo-shqiptare, në novelën në fjalë, pëson një krisje të madhe, gati si të ëndërrt, në kontekstin e zhvillimeve politike-diplomatike, ekonomike, fetare etj. Dhe kjo “krisje e madhe” apo një Bing Bang i ri në marrëdhëniet serbo-shqiptare të

Kosovës, lind nga mendjet e kthjella e të pafajshme rinore.

Novela, që tashmë “vështron” më në brendësi të teatrit të luftës dhe fokusohet me realizëm e vërtetësi në çeljen e kapitujve të rinj të këtyre marrëdhëniesve, sidomos ndër brezat e rinj të pafajshëm për atë çka ndodhur, pa e bartur armiqësinë brez pas brezi, por ama me



“Kujtime në shishe”. Autori Mimir Ferko eksploron artistikisht në një zonë tepër delikate, që pa ngurrim mund të quhet tabu.



Alice Munro, një fuqi padëgjuar krijimi

Lumturi? Tej mase lumturi? Në vrasjen e trefishtë të “Dimensione” apo në atë të “Radikale të lira”?

Lumturia në këto nëntë tregime të Alice Munro qëndron në një fuqi të padëgjuar krijimi, në forcën e mosparagjykimit dhe lirisë që të jep pleqëria, kur mund të shohësh gjithnjë e më thellë puseve të jetës tënde.

E nëse pastaj lumturia tejkalohet, mbesin historitë, brenda të cilave “idetë dhe faktet marrin një formë të re, duke u shfaqur përmes një inteligjence të përkorë”.

Alice Munro është fituese e çmimit Nobel për letërsinë në vitin 2013, u rrit në Wingham, Ontario.

Ka botuar 13 përmbledhje me tregime dhe një roman. Ka fituar më se tri herë çmimin letrar Governor General’s Literary Award, National Book Critics Circle Award, l’O. Henry Award dhe Man Booker International Prize.

FJALOR UDHËZUES PËR MISTERIN E DOSJEVE

“... përmbajtja e dosjeve nuk njihet, është mister, që mund të zgjidhet vetëm duke u njohur përmbajtja e të gjithave njëherësh, në të njëjtin çast dhe si të ishte një dosje e vetme... Përndryshe, ky ‘Fjalor’ do të ishte i panevojshëm”.

Në këtë libër, të shkruar në formë fjalori, lexuesit i paraqiten një galeri personazhesh e situata-

sh: një ish-punonjës i çmendur i Arkivit sekret, një gazetar investigativ, një sozi i Enver Hoxhës dhe Pasardhësi i Enver Hoxhës, një projekti për ndërtimin e Bllokut të nëndheshëm, një biznesmen i çuditshëm nga Moska që vjen në Shqipëri për të kërkuar një baba të panjohur, një linjë ndërkombëtare korrupsioni, dy krime seksuale

identike dhe të njëkohshme që shoqërojnë zhurmën për këtë linjë korrupsioni, një teori konspirative për një zyrë të fshehtë, reale ose imagjinare, për të cilën thuhet se lëviz çdo fije të ngjarjeve në Shqipëri... Të gjitha këto, ndërthurur me motive mitologjike nga më të ndryshmet, lidhen me njëra-tjetrën si shtigjet e një labirinti, në



qendrën e të cilit është misteri i dosjeve, shprehje të marrëzisë së kontrollit totalitar.



Armëpushimi, Primo Levi

Një histori dhimbjeje dhe shpresë, mbijetesë dhe dashurie për jetën. Marrëzia gjermane, Aushvici dhe kampe të tjera simotra mbollen frikë dhe vujatje po aq sa shprese dhe etje për te jetuar për ata që për fat mbijetuan. Vuajtjet e hebrenjve nuk morrën fund me shperberjen e kampeve. Pas ardhjes se ruseve përvencë gezimt të fitores mbi torturat, dhomat e gazit dhe vdekjen autori dhe mijra të tjerë mbeten skllever të lirise se tyre në kerkim të kthimit në shtëpi. Rruga

e kthimit ishte një sfidë me vete, sfidë me të ftohtin, urine, nevojat bazike dhe anarkinë e përgjithshme. Dëshira për të mbijetuar të bën mjek pa qene i tille, perkthyes edhe pse njeh pak fjale te gjuhes, tregëtar për te gjetur ushqim dhe për te pasur pak para...

Një liber që nuk duhet humbur. Kur e lexon ndjen një brejtje ndërgjegje për atë që njerezimi ka bërë keq dhe për atë që vazhdon ta bëjë keq ndoshta edhe thjesht duke mos vepruar.

Çaste lumturie dhe palumturie të papërfillshme

“Lumturitë e papërfillshme të Piccolo-s e kanë zanafillën tek arti i vetëpranimit. Ta pranosh vetveten jo sepse e çmon atë në mënyrë të pakushtëzuar, por përkundrazi, sepse arrin ta zotërosh kodin e vetvetes edhe nëpërmjet ceneve dhe dobësive” shkruan Michele Serra në gazetën “La Repubblica”.

A mund të ekzistojnë lumturi të papërfillshme? E si mund t’i quash ndryshe ato kënaqësi të thekshme e ikanake që shënojnë ditët tona, duke përflakur minutat si fjetet e shkrepësive në errësirë? Me shkrepësime rrufeje, fshikullima kamxhiku dhe histori, Francesco Piccolo nxjerr cullak me një humorizëm të pamëshirë vetëtimat më verbuese të ngazëllimit, regëtimat, të fshehtat e

strukura në skutat më të thella me të cilat herë a vonë të gjithë duhet të përballemi. Faqe pas faqeje, çast pas çasti, përfshihesh nga një shkullim i pandalshëm hareje, inteligjence dhe çmëritjeje.

Pas suksesit të madh që korri Çaste lumturie të papërfillshme, Francesco Piccolo kthehet të tregojë ngazëllimin e çasteve që përbëjnë jetën, vetëm se këtë radhë orvatet t’i shohë nga ana e gabuar. Duke i qëmtuar me kujdes ditët derisa zbulon se si në çdo kleçkë të beftë që të ndodh, qoftë edhe më e bezdisshmja, fshihet diçka e paçmuar: një shkëndijë sfiliteze zbavitjeje dhe vitaliteti.

Secili prej nesh provon gjatë ditës një mijë e një forma të papërfillshme (dhe jo të parëndë-

sishme) trishtimi. Por të lind dyshimi që është “si shkopinjte e shangait”: nëse do të tërhiqja gjënë që më pëlqen më pak nga njeriu që dua, do të rrezohej edhe ajo që më pëlqen më shumë.

Të qeshësh me çastet e trishtimit është një kontradiktë nga ato që mund të të ndryshojnë ditën. E megjithatë, po t’ua gesh anën, kleçkat e papritura, aksidentet, dhimbjet therëse të çastit, shpesh rezultojnë tejet zbavitëse. Nëse janë të papërfillshme për nga rëndësia dhe përjetohen me ngazëllim, përfshihen me të drejtë te gëzimet e jetës.

Dhe askush s’di ta rrëfejë më mirë se Francesco Piccolo, i cili me çastet që e përbëjnë jetën krijon një enciklopedi finoke e fort zbavitëse që mund ta marrë-



sh me vete gjithkund. FRANCESCO PICCOLO jeton dhe punon në Romë. “Çaste lumturie dhe palumturie të papërfillshme” në shqip e botoi Dudaj.



Ashtu siç pritej, Gjukanoviqi fiton mbi 53 për qind

Lideri veteran, Millo Gjukanoviq ka fituar 53.8 të votave në zgjedhjet presidenciale të mbajtura të dielën më Mal të Zi, ka bërë të ditur Qendra për Monitorim dhe Kërkim (CeMi). Sipas kësaj qendre nuk do të ketë raund të ri të zgjedhjeve pasi fitues tanimë është Gjukanoviq. Biznesmeni Mlladen Bojaniq, i mbështetur nga partitë opozitare, duke përfshirë edhe disa grupe pro-ruse ka fituar 34.1 për qind, ka njoftuar CeMi. Këto votime janë cilësuar vendimtare për Malin e Zi, lidhur me atë nëse do të vazhdojë rrugën Perëndimore për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian apo do të kthehet mbrapa në orbitën e Rusisë. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi ka uruar Gjukanoviqin për fitoren e tij në zgjedhje. Përmes një postimi në Twitter, ai ka thënë se kjo është fitore për Malin e Zi dhe për tërë rajonin që ka synim integrimin në NATO dhe Bashkimin Evropian.



Rusia ndihmon Serbinë kundër Kosovës në Interpol

Në prag të Asamblesë së Përgjithshme të Interpolit, e cila në muajin nëntor do të mbahet në Emiratet e Bashkuara Arabe, Serbia tashmë ka filluar aktivitetet e veta diplomatike për të penguar pranimin e Kosovës në këtë organizatë. Siç përcjell "veçernje novosti", Moskë edhe tash është partneri kryesor i Begogradit. Ajo në Lyon, ku gjendet selia e Interpolit, do të llobojë që lutja Kosovës të mos futet në rendin e ditës të Asamblesë që do të përcaktohet në vjeshtë. Në selinë e Interpolit kohë më parë ka qëndruar edhe delegacioni i Serbisë i udhëhequr nga Vladimir Rebiq, drejtor i policisë, i cili, pas kthimit ka thënë se Serbia do të bisedojë me të gjitha vendet me qëllim që t'i bindë ato se anëtarësimi i Kosovës nuk është në interesin e Serbisë, e madje, siç thonë mediet serbe, as në interesin e Interpolit. Për përgatitjen e rendit të ditës të Asamblesë së Përgjithshme të policisë botërore është i ngarkuar Komiteti Ekzekutiv e atë kryeson Meng Honguej nga Kina. 12 anëtarët tjerë janë nga Algjeria, Kореja, Rusia, Kanada, Franca, Belgjika, Brazili, SHBA-ja, Moldavia, Singapori, Afrika Jugore dhe Nigeria.

IRANIANËT QË KËRKOJNË AZIL NË BEOGRAD



Iranianët mund të udhëtojnë pa vizë në Beograd. Përmes itinerarit të Ballkanit shumë prej tyre shpresojnë të hyjnë në Europë. Por për mijëra iranianë kjo ëndërr përfundon në një kamp refugjatësh

Katër netët e fundit ai ka fjetur në një park. Në Beograd, 3700 kilometra larg shtëpisë. Më në fund. Arashi është i gëzuar që do të ketë një strehë mbi kokë në kampin e refugjatëve. "Kam lindur dhe jam rritur në Teheran, si miqtë e mi". Arashi dhe katër shokët e tij kanë ardhur para disa ditësh në Beograd. "Vendosëm të largohemi nga Irani, fillimisht shkuam në Turqi, nga aty erdhëm në Serbi, sepse është një vend më i mirë për të hyrë në BE". Iranianët lejohet të udhëtojnë pa vizë në Turqi. Prandaj Turqia është stacioni i parë për iranianët që duan të largohen nga vendi. Pas kësaj udhëtimi vazhdon në stacionin tjetër. Me avion për në Serbi. Nga nëntori i vitit 2017 qytetarët iranianë lejohen të udhëtojnë pa vizë në Serbi. Arsyeja: Duam të nxisim turizmin dhe të lehtësojmë kushtet për investitorët e huaj.

MUNDËSI TË REJA UDHËTIMI

E nxitja për të ardhur me sa duket pati efekt: gjithnjë e më shumë iranianë janë të entuziazmuar nga mundësitë e reja për udhëtim. Një rol këtua ka luajtur edhe Rozbeh Roozbahani. Fotografia i njohur udhëtoi në vjeshtë nëpër Serbi dhe u tregoi ndjekësve të tij në rrjetet sociale pamje nga "bukuria e paprekur në juglindje të Europës": "Serbia është momentalisht një destinacion mjaft i preferuar", thotë So-

mayeh, që punon në një agjenci udhëtimesh në Teheran. "Klientët tanë udhëtojnë në Tajlandë, Dubai, Indi, Kinë. Tani ata gëzojnë që mund të udhëtojnë në Europën Juglindore pa vizë". Këta iranianë me dëshirë për udhëtim dhe kurioz janë njerëz të një shtrese të vogël e me të ardhura të mira. Arashi dhe miqtë e tij nuk bëjnë pjesë këtu.

NË KËRKIM TË NJË JETË MË TË MIRË

Hendeku mes të varfërve dhe të pasurve në Iran është shumë i thellë. Papunësia, sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar, (FMN) arrin 12%, por sipas llogaritjeve të tjera është dyfish më e lartë. Tek të rinjtë pakënaqësia është shumë e madhe. Arashi dhe shokët e tij iranianë, Afshini, Mehrani dhe Saeedi thonë se jeta e tyre në Iran "në një farë mënyre" rrezikohet. Afshin thotë se është dervish gonabadi, pjesë e një pakice fetare. Ata nuk kanë të drejta në Iran dhe nuk lejohet të studiojnë. "Isha në rrezik, më duhej të largohesha nga vendi", thotë Afshin. Ndërsa Saeedi thotë se "të gjithë e dinë si jetojmë ne në Iran. Nuk ka liri. Mua donin të më prisnin veshin sepse bëra një piercing". Nuk ka të ardhme për mua", thotë Saeedi.

Këta të rinj kërkojnë një jetë më të mirë. Jashtë vendit. "Është si një sekret që e dinë të gjithë, që në këtë park në Beograd dhe në këtë rrugë ka shumë kontra-

bandistë", thotë Stevan Tataloviç nga organizata Info Park në Beograd. Kjo organizatë këshillon migrantët që duan të vazhdojnë udhëtimin e tyre në Europën veriore. Sipas Info Park nga koha kur u hoq viza për qytetarët iranianë, nga vjeshta e kaluar, më shumë se 6000 "turistë iranianë" kanë hyrë në Serbi. Një numër i madh nuk kërkon të kthehet në vendlindje.

NË QORRSOKAK

"Ata vijnë si turistë dhe përpiqen të krijojnë lidhje me kontrabandistët që t'i çojnë në destinacionin e dëshiruar", thotë Tataloviç. Por ky plan nuk funksionon gjithmonë. Numri i iranianëve që kanë kërkuar azil në Serbi është rritur nga nëntori i vitit të kaluar, nga 290 në nëntor 2017 në 431 vetë në mars 2018. Edhe Arashi e miqtë e tij kanë bërë kërkesën për azil, prandaj mund të strehohen në një kamp refugjatësh në Preshevë. "Iranianët dinë shumë pak gjëra për Serbinë. Ata dinë vetëm, se nuk kanë nevojë për vizë", thotë Stevan Tataloviç. "Por ata janë shumë mirë të informuar, se duhet të prezantohen që t'u njihet azili. Shumica rrëfejnë për përndjekje politike dhe fetare. Mes udhëtarëve iranianë në Serbi gjen edhe pjesëtarë të LGBTQ-së. Por kur autoritetet pyesin më me hollësi, ata nuk arrijnë të bindin. Prandaj shumica e kërkesave për azil refuzohen", thekson Tataloviç.



KOMISIONI I BE-SË E VLERËSON SËRISH KEQANKARANË ZYRTARE

TURQIA NË BE MË LARG SE KURRË

Pengesa serioze lidhur me sundimin e ligjit, lirinë e shprehjes dhe drejtësinë - ky është thelbi i raportit të fundit të progresit për Turqinë. Anëtarësimi i Turqisë në BE duket më larg se kurrë

Komisioni i BE-së vazhdon ta përjashtojë pranimin e Turqisë si anëtare të BE-së. Turqia ka ndërmarrë "hapa të mëdhenj larg Bashkimit Evropian", thuhet në raportin për përparimin e Turqisë në lidhje me mbi gjendjen e negociatave të anëtarësimit. Disa media gjermane si Welt am Sonntag shkruajnë se sipas raportit ka "pengesa serioze" në fushat kyçe të sundimit të ligjit, të të drejtave themelore, të reformës së administratës publike dhe lirisë së shprehjes. "Në rrethanat e tanishme, hapja e kapitujve të rinj të negocia-

tave nuk duhet marrë në konsideratë," thuhet në raportin e Komisioni që do të prezantohet zyrtarisht në Strasburg sot (e martë). Në fund të marsit, presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan rishprehu dëshirën që vendi i tij të bashkohet me BE-në. Në raportin e përparimit, thuhet se Turqia konsiderohet si "partner kyç për BE-në" dhe konfirmohet si vend kandidat.

Por Komisioni kritikon mbi të gjitha masat e marra nga udhëheqja turke pas grushtit të dështuar të shtetit. Komisioni i bën thirrje qeverisë në Ankara të heqë

gjendjen e jashtëzakonshme që është në fuqi pa ndërprerje prej gati dy vjetësh. Nga ana tjetër Komisioni vlerëson pozitivisht politikën e migracionit të Turqisë. Turqia po bën "përparime të jashtëzakonshme" për të mbajtur më shumë se 3.5 milionë refugjatë sirianë të regjistruar, thotë Komisioni i BE-së. BE-ja mbetet e angazhuar për ta ndihmuar Turqinë në përmbushjen e këtyre sfidave. Komisioni gjithashtu konfirmoi propozimin e tij për zgjerimin dhe modernizimin e bashkimit doganor midis BE-së dhe Turqisë. Në

këtë kontekst ekspertët vlerësojnë gjithashtu ekonominë turke, e cila përshkruhet si një ekonomi tregu shumë e avancuar dhe funksionale.

Turqia shprehu ndërkohë dëshirën që për të liberalizuar sistemin e vizave me BE-në është e gatshme të ndryshojë disa ligje të tjera. Por për liberalizimin e vizave Turqia duhet të përmbushë 72 kritere. Pika më e diskutueshme janë deri tani ligjet kundër terroristëve, të cilat sipas Brukselit keqpërdoren edhe për përndjekjen e gazetarëve apo opozitarëve.

STOLTENBERG THIRRJE ALEATËVE PËR MË SHUMË MBËSHTETJE NDAJ TURQISË

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, duke vënë në dukje se NATO ka një prani serioze në Turqi për ta mbështetur atë, u ka bërë thirrje të gjithë aleatëve të ofrojnë më shumë mbështetje ndaj Turqisë. Stoltenberg iu përgjigj pyetjeve të gazetarëve në selinë e NATO-s në Bruksel përpara një

vizitë zyrtare që do të kryejë në Turqi më 16 prill. Ai deklaroi se Turqia është një aleat i vlefshëm dhe me rëndësi strategjike për NATO-n dhe ka theksuar se në kuadër të vizitës të tij do të bisedojë rreth shumë çështjeve kritike, si operacioni "Dega e Ullirit", lufta kundër terrorizmit dhe për krizën në Siri.

Stuhi bore në SHBA, tre të vdekur nga i ftohti

Stuhi e fuqishme me borë, shi, breshër dhe erë të fuqishme ka përfshirë pjesët qendrore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA), duke shkaktuar vdekjen e së paku tre persona-

ve, mes të cilëve edhe të një fëmije dy vjeçar. Për shkak të stuhisë janë anuluar së paku 400 fluturime në aeroportin ndërkombëtar në Minneapolis, në shtetin federal Minnesota, ku

dje janë matur rreth 33 centimetra borë. Reshjet e borës shkaktuan anulimin edhe të disa ndeshjeve të futbollit.

Autoritetet amerikane mbyllën disa rrugë në jugperëndim

të Minnesota-s për shkak të kushteve të rënda në rrugë. Për shkak të kushteve të këqija klimatike aeroporti në Sioux Falls, Dakota Jugore, është mbyllur tashmë dy ditë.

Putini dëshiron aleancë me Lidhjen Arabe

"Ne së bashku mund të ndihmojmë në përshtetimin e proceseve të zgjidhjeve politike dhe të ristrukturimit në Siri dhe Irak dhe mund të ndihmojmë në zgjidhjen e çështjeve në kushtet pas disfatës së forcave kryesore të DEASH"



Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, tha se pas disfatës së DEASH-it në Siri dhe Irak, me Lidhjen Arabe mund të ndihmojmë për procesin e zgjidhjes politike dhe

të ristrukturimit në rajon. Sipas një deklarate nga Kremli, Putin ka publikuar një mesazh me rastin e samitit 29-të të Lidhjes Arabe që mbahet në Arabinë Saudite.

Duke kujtuar se takimi po

mbahet kur Lindja e Mesme dhe Afrika e Veriut po kalojnë në një periudhë të vështirë, Putin tha se konfliktet e armatosura në Siri, Irak, Libi dhe Jemen vazhdojnë të marrin jetë. Putin theksoi se këto

vështirësi kërkojnë përpjekje kolektive, të koordinuara të komunitetit ndërkombëtar dhe se është rritur kërkesa për struktura shumëpalëshe si Lidhja Arabe.

"Ne së bashku mund të ndihmojmë në përshtetimin e proceseve të zgjidhjeve politike dhe të ristrukturimit në Siri dhe Irak dhe mund të ndihmojmë në zgjidhjen e çështjeve jetësore në kushtet që lindin pas disfatës së forcave kryesore të DEASH", tha Putin, duke theksuar se Rusia është gati për bashkëpunim me Lidhjen Arabe për sigurinë rajonale.

Pasi ka theksuar se duhet të vazhdohet lufta kundër grupeve terroriste nën respektimin e sovra-

nitetit dhe integritetit territorial të shteteve arabe, Putin është shprehur: "Normalizimi në afat të gjatë në Lindjen e Mesme është i pamundur pa zgjidhjen e problemit palestinez. Pozicioni i Rusisë është i pandryshuar. Të gjitha çështjet që lidhen me territoret palestineze, duke përfshirë edhe çështjen e Kudsit, duhet të zgjidhen brenda kuadrit të negociatave të drejtpërdrejta Palestinë-Izrael, bazuar në rregullat universale ligjore, duke përfshirë vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, dhe me përfshirjen e iniciativës paqësore arabe të Lidhjes Arabe."



Nuk ka më sulme të reja në Siri

Shefi i diplomacisë britanike, Boris Johnson, deklaroi se forcat perëndimore do të shqyrtojnë opsionet nëse pushteti i Sirisë sërisht do të përdorë armët kimike të ndaluara, por se aktualisht nuk ka plane për sulme të reja. Si një kundërpërgjigje ndaj sulmit me armë kimike në Duma më 7 prill, SHBA-të, Britania e Madhe dhe Franca, bombarduan objektiva të regjimit të Bashar al-Asadit në Damask dhe Homs, duke goditur depot e armëve kimike. Krerët e tre shteteve thonë se sulmet kanë qenë të kufizuara duke goditur vetëm depot e armëve kimike, dhe se qëllimi i tyre nuk ka qenë përmbysja e Asadit ose ndërhyrja në luftën civile.

I ftuar në emisionin e Andrew Marr në BBC, shefi i diplomacisë britanike Johnson, mbështeti vendimin e kryeministres së Britanisë, Therese May, për pjesëmarrje në sulm, duke theksuar se ishte një vendim i drejtë, i cili do të ndalojë përdorimin e armëve kimike në vazhdim. "Aktualisht nuk ka propozime për sulme të reja, sepse regjimi i Asadit nuk është aq i marrë sa të nisë një sulm tjetër me armë kimike. Nëse, dhe kur kjo të ndodh, atëherë do të diskutojmë me aleatët se cilat janë mundësitë", tha Johnson në BBC. Fjalët e tij janë në përputhje me deklaratën e ambasadores amerikane në OKB, Nikki Haley. Gjatë mbledhjes së jashtëzakonshme të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, Haley deklaroi se presidenti amerikan, Donald Trump, i ka thënë se SHBA-të janë të gatshme të godasin nëse regjimi sirian përsërit përdorimin e gazit helmues.

KATËR LLOJET E FARAVE MË TË FUQISHME KUNDËR KANCERIT



Ekzistojnë fara të ndryshme kundër kancerit, që mund ta parandalojnë atë, ose të ndihmojnë në trajtimin gjatë kimioterapisë, por se nuk duhet të përdoren si zëvendësim për trajtimin. Në hulumtimet për përmirësimin e trajtimit ndaj llojeve të ndryshme të kancerit, studime të ndryshme kanë treguar se natyra na dhuron substanca të forta kundër kancerit. Gjëja më e mirë në gjithë këtë është se nuk kanë efekte të dëmshme anësore. Disa nga opsionet natyrale, që forcojnë sistemin imun dhe luftojnë kancerin dhe përhapjen e tij, janë katër lloje të farave.

FARAT E MOLLËVE. Shumë ekspertë farat e mollëve i klasifikojnë si farat më të fuqishme kundër kancerit. Sikurse edhe në shumë raste të tjera, organizata të caktuara nuk dëshirojnë t'i publikojnë dhe të kuptohet, pasi që dëshirojnë të zhvillojnë ilaçe sintetike për të pasur fitime të mëdha. Këto fara është

vërtetuar se parandalojnë rritjen e qelizave malinje në disa lloje të ndryshme të kancerit, përfshirë kancerin e zorrëve, të mushkërive, prostatës, gjirit, stomakut.

FARAT E RRUSHIT. Ekstraktet nga farat e rrushit janë burim i pasur për antioksidues, flavonoide dhe substancën aktive të njohur si "B2G2". Kjo substancë mund të ndihmojë në luftimin e qelizave të kancerit. Në të kaluarën, substancat bioaktive të pranishme në rrush është besuar se sulmojnë grupe të caktuara të qelizave të kancerit, por se tani është vërtetuar se substanca "B2G2" e bën një gjë të tillë. Kjo substancë redukton rritjen e tumoreve malinje deri në 67 për qind.

FARAT E LIRIT. Falë përbërësve të saj, që i posedojnë, farat e lirit po ashtu mund të përfshihen në listën e farave, që luftojnë kancerin. Është vërtetuar se luajnë rol të rëndësishëm në parandalimin dhe trajtimin e kancerit të gjirit, për-

Në hulumtimet për përmirësimin e trajtimit ndaj llojeve të ndryshme të kancerit, studime të ndryshme kanë treguar se natyra na dhuron substanca të forta kundër kancerit. Gjëja më e mirë në gjithë këtë është se nuk kanë efekte të dëmshme anësore

derisa veprojnë edhe si fitoestrogjene. Ky përbërës, i cili është popullarizuar rreth një vit më parë, është i aftë në promovimin e apoptozës në qelizat e tumoreve, përderisa parandalon edhe metastazën. Po ashtu farat e lirit janë burim i aminoacideve omega 3, që vepron kundër kancerit dhe sëmundjeve të tjera kronike.

BËRTHAMA E PJESHKËS. Pjeshkat janë të pasura me një sasi të madhe me vitamina B17, i cili ka efekt kundër kancerit në trup. Kjo vitaminë është e shkëlqyeshme jo vetëm në parandalimin e kancerit, por se mund të jetë me shumë veti shëruese për ata pacientë, që tashmë vuajnë nga kanceri. Për ta përdorur, vetëm e thyni bërthamën me çekiç. Më pas e hani farën, që ka një formë të bajames.

Shtatë mrekullitë e mollës



Një mollë në ditë e mban mjekun larg nesh. Kjo është shprehja që e bën mollën të shihet si një frut i shëndetshëm. Por ky nuk është thjesht një proverb antik. Ekspertët nutricionistë sjellin një listë të mrekullive të vogla që molla bën kur e konsumojmë përditë. Molla ka vlera ushqyese dhe është një aleat i fortë i shëndetit. Në përbërje të saj janë: ujë, proteina, shumë pak yndyra, sheqer i disa llojeve si fruktozë, glukozë dhe sakarozë, fibra e kripëra minerale si potasi, fosfori, kalciumi, magnezi dhe vitaminat C, PP, B1, B2, A. Efektet pozitive në shëndet:

- Lufton astmën. Një studim amerikan ka treguar se sasia e madhe e vitaminave dhe elementëve ushqyës të molla ndihmojnë në reduktimin e simptomave të astmës. Substancat e pranishme të molla pastrojnë rrugët e frymëmarrjes.

- Ndihmon në diëta. Molla ka pak kalori dhe si e tillë është e përshtatshme të përdoret nga personat që duan të bien në peshë. Ajo krijon ndjesinë ngopjes dhe rregullon florën intestinale, falë sasisë së madhe të fibrave.

- Mban nën kontroll kolesterolin dhe gliceminë. Fibrat si pektina arrijnë të ulin nivelin e kolesterolit në gjak, duke zvogëluar rrezikun e iktusit apo sëmundjeve të zemrës. Gjithashtu, ajo ndihmon pacientët me diabet, pasi ul nivelin e glicemisë në gjak.

- Ndihmon në rastet e diareisë. Pektina, e cila gjendet tek molla, ka aftësinë të transformohet në një shtresë mbrojtëse për muret e stomakut, të cilat në rastet e diarresë janë të irrituara.

- Ka efekt laksativ. Molla njihet për vetitë e saj laksative në rast kapsllëku. Ekspertët sugjerojnë të konsumohet një mollë e pjekur në ditë, për të zgjidhur problemet e kapsllëkut.

- Redukton risqet e tumorit. Sipas studimeve, molla ul rrezikun e prekjes nga sëmundjet e rrugëve të tretjes, venave, varçeve dhe disa tipe të tumorit. E gjithë kjo falë polifenoleve, të cilat te molla janë me shumicë. Një studim italian i kohëve të fundit thotë se molla parandalon tumoret e gojës, ezofagut, qafës së mitrës, gjirit dhe prostatës.

- Aleat i bukurisë. Lëngu i një molle të freskët, i bashkuar me atë të limonit, tonifikon lëkurën. Një maskë e përgatitur me mollë të pjekur në qumësht ndihmon në shtrirjen e lëkurës, duke minimizuar rrudhat. Ndërsa lëkurat e thata bëhen më të buta me një maskë me mollë të grirë dhe kos.

Stevia shkatërron dëshirën për të pirë duhan

Personat që prej shumë vitesh janë konsumues të duhanit, e kanë shumë të vështirë të heqin dorë me lehtësi. Nikotina është ajo që në fakt krijon varësinë ndaj pirjes së duhanit dhe shkakton probleme në organizmin tuaj. Pra, sa më shumë pini duhan, aq më shumë trupi juaj ka nevojë për nikotinë. Por, kur ju vendosni të lini duhanin, sigurisht kjo është shumë e vështirë por ka një mënyrë për t'ju ndihmuar në këtë rrugë. Përdorni bimën

Stevia (bimë shkurrije në gjethin e së cilës gjenden shumë glikozide të ëmbla) për të hequr dorë nga duhani. Kjo



është përdorur si sheqer diabetik. Përdorimi i sheqerit diabetik bllokoi sinjalët që dërgon truri juaj nga mungesa e cigareve dhe ju nuk do të ndjeni shumë moskonsumimin. Stevia mund ta gjeni të lëngshme ose pluhur. Ju mund ta gjeni atë në supermarkete dhe dyqane të ushqimit të shëndetshëm. Stevia është gjithashtu e rekomandueshme për ata që janë duke u përpjekur për të humbur peshë dhe për rregullimin e presionit të gjakut.

Pse kur flemë shumë jemi edhe më të lodhur?



Është fundjavë, dhe normalisht pas një jave të gjatë punë dhe lodhje, të gjithë i gëzohemi orëve pa fund që mund ti kalojmë në gjumë. Epo mos ju gëzoni më! Sipas ekspertit të gjumit dhe autor i shumë librave, Dr. Michael Breus, jo domosdoshmërisht më shumë gjumë do të thotë më mirë për ju. Për të kuptuar se përse ndodh kjo, fillimisht duhet t'i shikojmë ciklet e gjumit dhe se sa orë gjumë i duhen një personi. Breus thotë se shumica e njerëzve kanë nevojë

për 7.5 orë gjumë. Por, nga vjen ky numër? Personat mesatarisht kalojnë përmes pesë cikleve të gjumit brenda nate.

Çdo njëri nga ato cikle është përafërsisht 90 minuta i gjatë. Pesë cikla nga 90 minuta mund të përkthehet në total prej 7.5 orëve. Sidoqoftë, Breus thotë se nuk është vetëm sasia e orëve të gjumit ajo që ka rëndësi, por edhe nga cili cikël i gjumit zgjoheni. Ekziston faza e parë e gjumit, faza e dytë, e tretë, e katërt dhe faza REM. Sipas

Breus, është më së lehti të zgjoheni nga gjumi kur jeni në dy ciklet e para të gjumit, faza REM është pak më e vështirë, ndërsa faza e tretë dhe e katërt janë më të vështira.

Kur flini një apo dy orë më shumë se zakonisht, mundësitë janë të zgjoheni nga cikli REM apo nga cikli i tretë e i katërt, gjë që do të thotë se do të ndjeheni më të lodhur gjatë ditës. Kjo gjithashtu e shpjegon faktin se një gjumë i shkurtër gjatë ditës është më efektiv sesa një gjumë i gjatë.

QATIP OSMANI FLET PAS SFIDËS ME PELISTERIN

DUARTROKITJET JANË MIRËNJOHJE PËR PARAQITJEN TONË

"Kur luan në mënyrë kaq bindëse, donë apo jo, edhe publiku do të pajtohet dhe duartrokitjet janë mirënjohje për paraqitjen tonë. Derisa, më gëzon fakti se Shkëndija shënon edhe me lojtarë tjerë përveç atyre që jemi mësuar të shënojnë", pohon Osmani



Shkup, 16 prill - Skuadra e Shkëndijës ka vazhduar ecurinë e sigurt drejt titullit të ditur në historinë e saj, derisa fundjavën që shkoi kuqezinjtë patën një tjetër performancë të shkëlqyer duke deklaruar me 6:0 Pelisterin në mes të Manastiritit. Ishte kjo fitorja e 22-të sezonale për skuadrën e trajnerit Qatip Osmani dhe e treta këtë kampanjë ku ekipi realizon 6-të gola pas triumfeve paraprake 1:6 me Renovën dhe 2:6 kundër Rabotniçkit. "Lojë dominuese, lojë e bukur që rezultoi me gjashtë gola.

Sigurisht se çdo fitore është e mirëseardhur, por në gëzon mënyra se si arritëm fitoren e sotme. Shënuam gjashtë herë përmes aksioneve të bukura, gjë që tentojmë ta bëjmë gjithmonë", thotë përfaqëuesi i klubit tetovar, transmeton

gazeta KOHA. Ndryshe, fitorja ndaj Pelisterit ishte ndeshja e tetë me radhë që Shkëndija nuk pranon gol. "Edhe ky fakt sigurisht se më gëzon. Ne edhe në afatin kalimtar të dimrit kërkonim përfortime për të përforcuar defensivën

që mendoj se ia arritëm qëllimit", shtoi më tej Osmani. Ai komentoi edhe faktin që publiku në Manastir pas paraqitjes së shkëlqyer ka duartrokitur futbollistët e tij. "Kur luan në mënyrë kaq bindëse, donë apo jo, edhe publiku do të pajtohet dhe duartrokitjet janë mirënjohje për paraqitjen tonë. Derisa, më gëzon fakti se Shkëndija shënon edhe me lojtarë tjerë përveç atyre që jemi mësuar të shënojnë". Fitorja e thellë ndaj Pelisterit ishte një paralajmërim i asaj që do të ndodhë në muajin maj kur këto dy ekipe do të luajnë për trofeun e Kupës. "Sigurisht se kjo që bëjmë sot është një paralajmërim i mirë, por nuk do të jetë njëjtë. Është finale e Kupës ku besoj se do të jetë krejtësisht ndryshe, pra një Pelister tjetër. Pres një lojë më të rëndë se kjo që e zhvilluam sot", vazhdoi më tej Osmani. Ndërkohë, pas kësaj fitore, ekipi shkon 20-të pikë larg vendit të dytë që i takon Vardarit me të cilën kuqezinjtë do të takohen të mërkurën në arenën "Filipi i dytë" në Shkup. ndërsa Osmani thotë se edhe në këtë ndeshje do të udhëtojnë për të arritur fitore. "Sigurisht se edhe kundër Vardarit do të luajmë për të fituar ndeshjen", përfundoi Qatip Osmani, trajneri i Shkëndijës.



E kam pritur këtë moment

Jahmir Hyka ka gjetur golin e parë të takimit në ditën e djeshme, teksa i futur në minutën e 67-të të takimi, ka barazuar me rezultatin 2-2 takimin që ekipi i tij San Hose zhvilloi ndaj Hjuston Dinamo. Në një intervistë për ndeshjes, futbollisti i Kombëtares është shprehur i lumtur për golin e realizuar. "Nuk ishte ndeshja jonë më e mirë dhe ne e dimë këtë gjë. Shpresoj se në ndeshjen tjetër do të luajmë më mirë dhe të arrijmë performancën e duhur. Festimi im ishte një dedikim për Joel, pasi i kisha premtuar se nëse do të shënoja, atëherë do të festoja në këtë mënyrë. Nuk është e lehtë të qëndrosh gjithë kohën në stol. Por nëse je futbollist profesionist, atëherë duhet të presësh mundësinë tënde. Kur të vjen shansi, atëherë ti duhet të bësh më të mirën tënde. Falë Zotit, unë ia arrita të ndihmoja ekipin tim dhe të shënojë", është shprehur Hyka. Ndërkohë edhe trajneri Mikael Stahre ka përgëzuar mesfushorin shqiptar për golin e realizuar. "Hyka shënoi një gol të rëndësishëm për ne. Hyri në fushë si zëvendësues dhe erdhi me energji dhe kualitet. Jam shumë i lumtur për të", ka thënë trajneri i San Hose.

FSHF konfirmon miqësoren me Jordaninë



Pas mediave ndërkombëtare dhe Federatës së Jordanisë, edhe Federata Shqiptare e Futbollit zyrtarizoi miqësoren e 10 tetorit në "Elbasan Arena" përballë përfaqësueses së vendit arab.

Kjo do të jetë miqësoria e dytë për kuqezinjtë, gjatë periudhës kur skuadra e drejtuar nga Kristian Panuçi do të jetë e angazhuar në grupet e Ligës së Kombeve. Federatat e dy vendeve kanë gjetur akordin për zhvillimin e ndeshjes, ndërsa në këtë

mënyrë Shqipëria plotëson kuadrin e gjashtë takimeve që do të luajë në periudhën nga muaji shtator deri më nëntor të 2018-ës, me katër sfida zyrtare përballë Skocisë dhe Izraelit në grup dhe dy takime testuese. Përpos miqësorës së 10 tetorit me Jordaninë, Kombëtarja kuqezi do të luajë edhe më 20 nëntor miqësoren me Uellsin e drejtuar nga Rajan Giggs dhe të yjeve Bejll apo Aron Ramsey, edhe ky një duel që do të luhet në impiantin e Elbasanit.

KRYESIA LARGON ÇEDOMIR JANEVSKIN

Babunski, trajner i ri i Vardarit

Shkup, 16 prill - Çedomir Janevski nuk është më trajner i skuadrës së Vardarit. Deri te kjo erdh pasi Vardari të dielën luajti baras 1-1 ndaj FC Shkupit, por edhe si pasojë e rezultateve të dobëta në kohët e fundit. Në vend të Janevskit deri në fund të sezonit në stolin e trajnerit do të qëndrojë Boban Babunski, i cili do të ketë një test të vështirë,

kur të mërkurën përballë me Shkëndijën. Ndryshe, Janevski te KF Vardar erdh në prag të përballjes me Fenerbahçen, ku gjeti recetën e suksesit historik. Mirëpo, në vazhdim, pasuan rezultate e dobëta në kampionat dhe Kupën e Maqedonisë, pas së cilës Vardari këtë sezon do të mbetet pa asnjë trofe. Pjesë të fajit do të bartin

edhe drejtuesit e klubit, të cilët kishin disa vendime të çuditshme, mes të cilëve edhe urdhri për të luajtur me futbollist të rinj ndaj Sileksit dhe Shkëndijës në Kupën e Maqedonisë. Në anën tjetër Babunski ka filluar karrierën te Vardari, ndërsa kjo është hera e parë që do të drejtojë skuadrën kuqezi në rolin e trajnerit



PAS TITULLIT KAMPION NË FRANCË ME PSZH

ALVES BËHET FUTBOLLISTI MË I SUKSESSHËM NË HISTORI

Ka nga ata që do të bënin gjithçka për të pasur një medalje të artë në shtëpi. Por, jo të gjithë fitojnë në futboll. Pastaj, ka edhe ata, që në një karrierë 20-vjeçare sollën në shtëpi jo pesë, jo dhjetë, jo njëzet, por më tepër tridhjetë e nëntë trofe: i fundit prej tyre në mbremjen e së dielës, më 15 prill. Dani Alves është lojtari me më shumë trofe të fituar në historinë e futbollit. Të paktën, në një nivel të lartë, nuk ka njeri tjetër, që të ketë të njëjtin numër medaljesh

sa Dani Alves, i cili ka triumfuar në Evropë dhe në botë, me ekipe të ndryshme dhe kombëtaren e tij. Ai ka fituar medalje në Ligën e Kampioneve, në Seria A, në Kupën e Amerikës, në Kupën UEFA. Alves, madje, ka fituar edhe Kupën e Botës, por për U-20. Dhe, në të gjitha kompeticionet, e vetmja medalje ari që i mungon është pikërisht ajo me kombëtaren e madhe të Brazilit, në Kupën e Botës. Duke fituar titullin e Ligue 1, pas rezultatit 7-1 kundër Mo-

nakos, Dani Alves mori trofeun e tretë francez, duke pritur të radhës, nëse PSZH triumfon edhe në Kupën e Francës, gjithashtu. Në këtë rast për ish-lojtarin e Barcelonës dhe Juventusit do të bëheshin dyzet suksese të tilla në karrierë. Çampion nuk ka ardhur për të në këtë sezon, por mbrojtësi i datëlindjes 1983 do të luftojë për të sjellë në shtëpi medaljen e kampionit të botës. Brazili është një nga tre favoritët e mëdhenj në tokën ruse. Është debatuar sh-



pesh se kush është fituesi më i madh në historinë e futbollit, por në nivel të totalit të trofeve të fituar, askush nuk e ka "plamarsin" më të mirë se Dani Alves.

Maksvell, Ibrahimoviç, Iniesta dhe Giggs janë ndaluar në kuotën maksimale të 36 trofeve, si dhe ish-legjenda e Liverpool, Kenny Dalglish.

Publicitet

Komisioni për grumbullimin e ofertave për realizimin e ekskursionit të nxënësve pranë SHMEK "Gostivar"-Gostivar publikon:

SHPALLJE

Për mbledhjen e ofertave për realizimin e ekskursionit të nxënësve pranë SHMEK, Gostivar, - Gostivar

Për mbledhjen e ofertave për realizimin e ekskursionit përfundimtarë viti shkollor 2017/2018, në pajtim me Programin për realizimin e ekskursionit përfundimtarë për nxënës, mendimit të Këshillit të Prindërve dhe Byrosë për zhvillimin e arsimit, SHMEK "Gostivar"-Gostivar organizon:

Ekskursion disa ditë me nxënës të vitit të tretë jashtë R.M. në relacionet:

1. Gostivar, Selanik, Keshan, Çanakale, Kushadasi, Efes, Soke -Gostivar, 6 (gjashtë) ditë dhe 5(pesë) net pansioni i plotë në hotel me 4*AI (meny për ushqim mëngjes , drekë dhe darkë-tryezë suedeze).- **PËR NXËNËSIT ME MËSIM NË GJUHËN SHQIPE.**

Kriteret minimale që duhet t'i plotësojë ofertuesi janë këto:

- Të jetë i regjistruar në pajtim me dispozitat pozitive në R.M. për ushtrimin e veprimtarisë përkatëse.
- Të ketë realizuar me sukses së paku tre(3) ekskursione jashtë vendit ;
- T'i plotësojë kushtet për transport të grupeve me fëmijë në pajtim me Ligjin për sigurim në komunikacion dhe rrugë dhe Rregulloren për kërkesa të veçanta teknike për automjetet me të cilat bëhet transporti i grupeve dhe nxënësve .
- Të posedojë para-rezervim ose kontratë me hotele me minimum me 4 *.
- Të posedojë dokument që i ka paguar tatimet dhe kontributet ndaj shtetit si dhe dokument me të cilin nuk i janë shqiptuar asnjë nga llojet e ndalesave për ushtrimin e veprimtarisë;

Oferta duhet të përmbajë të dhëna për :

- Çmimi për shërbim (për vendosje,transport dhe ushqim,sigurim gjatë udhëtimit dhe sigurim shëndetësor,udhëheqës-ciceron,shpenzimet për vizita në muzeume dhe në monumente të tjera.
- Kushtet për vendosje,
- Mënyra e pagesës- Prindër-kujdestari i nxënësit vetë e mbulon pagesën në AT (me para të gatshme ose në këste). Udhëheqës dhe Mjek . Kushte të vulltshme për nxënësit të cilët vijnë nga familje me kushte të vështira sociale dhe numri i arsimtarëve.
- Kriteret për zgjedhjen e ofertës më të vulltshme-çmimi më i ulët
- Me e ofertuesin e zgjedhur do të nënshkruhet kontratë për realizimin e ekskursionit me kusht të dorëzohet garancion bankar për realizimin kualitativ të ekskursionit në lartësi prej 5% nga vlera e përgjithshme e kontratës.
- Ekskursioni do të realizohet me aq nxënës sa do të paraqiten
- Programet në bazë të të cilës janë përpiluar ofertat mund të merren në shkollë çdo ditë pune prej orës 09-14:00.
- Ekskursioni do të realizohet në muajin Maj 2018.
- Ofertat duhet të jenë në zarf të mbyllur ndërsa në këndin e sipërm majta të shkruhet „Mos e hap.
- Ofertat me dokumentacionin e nevojshëm i dorëzohen Komisionit,në arkivin e shkollës ose me postë.
- Çdo ofertues është i obligueshëm të dorëzojë ofertë ta marrë prej Komisionit të shkollës programin për ekskursionin shkencoro-arsimor.
- Shpallja është e hapur 5 (pesë) ditë me ditën e publikimit.
- Hapja e ofertave do të bëhet pa prezencën e ofertuesve.

SHMEK „Gostivar, - Gostivar
Rr. „Zhviko Brajkoski„nr. 39
Gostivar

Në pajtim me Programin për realizim të ekskursioneve për nxënës dhe nenit 16 dhe 17 të Rregullores për mënyrën e realizimit të ekskursioneve për nxënës dhe aktiviteteve tjera të lira të nxënësve në shkollën fillore SHFK "Sv Kiril i Metodi" Veles publikon:

Shpallje Publike

Për grumbullimin e ofertave për realizim të ekskursioneve për nxënësit dhe aktiviteteve tjera të lira – verime në vitin shkollor 2017/18

Të gjithë ofertuesit e interesuar të dorëzojnë ofertat që do të përmbajnë të gjitha elementet dhe kushtet e theksuara në Rregulloren për mënyrën e realizimit të ekskursioneve për nxënës dhe aktiviteteve tjera të lira për nxënësit në arsimin fillor nr. 07-9992/2 të datës 05.06.2014, më së voni deri më 23.04.2018 deri në ora 12.00.

Të gjithë ofertuesit e interesuar, dokumentacionin mund ta marrin nga shkolla SHFK "Sv. Kiril i Metodi" Veles në adresën Arhiepiskop Mihail 156.
Tel. për kontakt: 043-233-676

UD Drejtor
Illço Stojanovski

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 62/05,106/08...167/2015), dhe nenit 80 dhe 82 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta zyrtare e RM nr. 103/08, 33/10,...30/2016), UD Drejtari i SHFK "Dame Gruiev" - Gradsko publikon:

SHPALLJE

Për plotësim të vendit të zbrazët të punës për kohë të caktuar të punës deri në fund të vitit shkollor 2017/2018

Mësimdhënës të matematikës me 21 orë mësimore të fondit javor, pagesa fillestare prej 20.645,00 denarë... **1 realizues**

Orari ditor i punës është 8 (tetë) orë edhe atë prej ora 07,30 deri në ora 15,30. Orari javor i punës me orar të plotë të punës është 40 orë të shpërndarë në 5 (pesë) ditë pune.

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të parapara me LMP duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme të parapara me nenin 42 dhe 80 të Ligjit për arsim fillor.

Së bashku me fletëparaqitjen për punësim parashtrihen dokumentet në vijim edhe atë:

- Certifikatë të shtetësisë
- Diplomë për arsim të mbaruar në pajtim me normativin e kuadrin mësimor.
- Dokumentet parashtrihen në original ose kopje të vërtetuara në noter.
- Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit të shpalljes në shtypin ditor.
- Zgjedhja e kandidatëve do të realizohet në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas përfundimit të afatit për parashtrim të dokumenteve.
- Fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e nevojshme të parashtrihen në adresën SHFK "Dame Gruiev" - Gradsko, rr. Marshall Tito nr. 68 - Gradsko

SHFK "Dame Gruiev" - Gradsko
UD Drejtor
Lençe Stojanova

Rexhep Nuredin nga Tetova me banim ne Suedi kërkon punëtores për shërbime shtëpiake në vendqëndrimin e tij në Suedi. Të interesuarat duhet të jenë të moshës 55-65 vjeçare. Kontakt telefoni 071 955 998

Shoqata Aksionare për Menaxhim me Hapësirë Afariste në Pronësi të Shtetit - Shkup

LAJMËRIM

për korrigjim të Shpalljes 2 (shpallje për herë të dytë)

Në bazë të Shpalljes numër 2 për dhënie me qira të hapësirës afariste në pronësi të Republikës së Maqedonisë nëpërmjet ankandit publik elektronik, e shpallur më 13.04.2018, Shoqata Aksionare e informon publikun se nga lista e shitjes është tërhequr hapësira afariste në vijim:

1. Për shkak të mospërpjethjes së të dhënave të vendosura në Shpalljen numër 2 (shpallje për herë të dytë) dhe të dhënave reale për objektin afarist, nga lista për dhënie me qira tërhiqet objekti që vijon:

I. Shkup, numri rendor 30, në PK 315, PK K. Vodë 2, IL 48980, Bul. K.J.Pitu nr. 15 (B1-1), kat, hyj 1, lokali nr. 3, me sipërfaqe prej 265 m² dhe me vlerë tregu prej 13.131.608,00 denarësh.

Shoqata Aksionare për Menaxhim me Hapësirë Afariste në Pronësi të Shtetit - Shkup

Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Teksti i pastruar – Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/2015), Lajmërimit nr. 12-11469/6 të datës 01.02.2018 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës së RM dhe Vendimit të u. d Drejtorit të SHMK Kosta Susinov" me nr. vep. 02-449/1 të datës 16.04.2018 shpall:

SHPALLJE

Për punësim për kohë të pacaktuar të punës

1. Mirëmbajtës të higjienës – 1 realizues për 40 orë pune

Orari i punës është pesë ditë pune në javë, e njëjta është në ndërrime, ndërrimi i parë prej ora 06.00 deri në ora 14.00 dhe ndërrimi i dytë prej 13.00 deri në ora 21.00. Pagesa është 12.000,00 denarë.

Kandidatët e paraqitur është e nevojshme të dorëzojnë dokumentacionin në vijim:

- Lutje (të bashkëngjitur me biografi të shkurtë – CV)
- Dëshmi për arsim të mesëm të mbaruar (diplomë apo dëftesa të vërtetuara në noter)
- Certifikatë të shtetësisë

Dokumentet e nevojshme të dorëzohen deri të SHMK "Kosta Susinov" Radovish, Kej 8 Septemvri nr. 8, Radovish (në arkiv). Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor. Zgjedhja e kandidatëve do të realizohet në afat prej 15 ditëve nga dita e përfundimit të shpalljes. Dokumentet e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysht gjatë shqyrtimit.

**SHMK "Kosta Susinov" Radovish
U. D Drejtor Goce Lllazarov**

I nr. 1958/2016

SHPALLJE PUBLIKE

Sipas nenit 46-b të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për përbarim Gazeta Zyrtare e RM nr. 8 të datës 17.01.2008 ndërsa në nenin 265 të LP Gazeta Zyrtare e RM nr. 72/2016 të datës 12.04.2016

Përmbasuesi Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivar në bazë të kërkesës për realizim të përbarimit nga kreditori Hallk Bank SHA Shkup nga Shkupi me seli në rr. "Sv. Kiril i Metodi" nr. 54, bazuar në dokumentin për përbarim Akti noterial ODU nr. 121/2015 të datës 20.02.2015 të Noterit Përparim Rexhepi, Gostivar, kundër borxhit Arditjan Ramadani nga Gostivar me seli në f. Belovishtë dhe debitorit të pengut Qemal Ramadani nga Gostivar me seli në f. Belovishtë, për realizim të përbarimit në vlerë prej 1.216.747,00 denarë për lëndën përmbasuese të regjistruar në nr. 1958/2016 të datës 05.04.2016:

FTON

- 1. Borxhliu Arditjan Ramadani dhe debitorin e pengut Qemal Ramadani të dy nga Gostivari me seli në f. Belovishtë, për shkak të dorëzimit të:
- Proceverbalit për shitje të patundshmerisë me ankand publik me gojë në batë të nenit 175 paragrafi 4 të LP I nr. 1958/2016 të datës 14.03.2018,
- Konkluzionit për shitje të patundshmerisë me ankand publik me gojë në batë të nenit 175 paragrafi 4 të LP I nr. 1958/2016 të datës 14.03.2018,
- Konkluzionit për shitjen e realizuar të patundshmerisë në bazë të nenit 175 paragrafi 7 të LP I nr. 1958/2016 të datës 15.03.2018
- Konkluzion për dorëzim të patundshmerisë në pronësi në bazë të nenit 178 paragrafi 1 të LP I nr. 1958/2016 të datës 15.03.2018
- Konkluzion për përcaktim të kohës për ndarje në bazë të nenit 192 paragrafi 1 të LP I nr. 1958/2016 të datës 19.03.2018
- Proceverbali për ndarje të shumës të aritur me shitjen e patundshmerisë në bazë të nenit 192 të LP I nr. 1958/2016 të datës 26.03.2018
- Konkluzion për përcaktim të kohës për ndarje në bazë të nenit 192 paragrafi 1 të LP I nr. 1958/2016 të datës 26.03.2018 të gjitha të Përmbasuesit Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari.

Në afat prej 1 (një) dite duke konsideruar nga dita e publikimit të kësaj thirrje publike në shtypin ditor.

PARALAJMËROHËN borxhliu Arditjan Ramadani, debitorit i pengut Qemal Ramadani se mënyra e këllilë e dorëzimit konsiderohet si e regullt dhe se pasojat negative që mund të dalin do t'i bartë vetë pala.

Kjo shpallje paraqet SHPALLJEN E GJASHTË.

Përmbasues
Aleksandar Kuzmanovski

URGJENTISHT

Shes truall të urbanizuar Po + Pr + 2 menjëherë në fillim të Industrisë së lehtë "Momin Potok" – Shkup, me sipërfaqe të përgjithshme prej 890 m² së bashku me objektet ekzistuese prej 180 m². Çmimi 178.000 euro. Numri i telefonit: 078 – 201 – 960

Koha, e martë 17 prill, 2018

Dëshira e tij është të luajë sezonin e ardhshëm në Madrid dhe të dielën ai la një tjetër shfaqje të shkëputjes nga ekipi parisien. Derisa shokët e tij u shpallën kampionë të Ligue 1, duke mundur 7-1 Monakon, transferimi rekord botëror (222 milionë euro) ishte në argëtim, duke luajtur poker "on line" në Brazil

NEJMAR VAZHDON TË TREGOJË SHKËPUTJEN E TIJ NDAJ PSZH

DËSHIRON TË TRANSFEROHET TE REAL MADRID



Derbi në Mançester për shërbimet e Alkantaras

Tiago Alkantara është mesfushori kreativ që Guardiola dëshiron ta marrë në "Etihad". "Sezonin e ardhshëm, David nuk mund të luajë çdo ndeshje, kështu që skuadra duhet të jetë e mrekullueshme", – shpjegoi trajneri spanjoll në një konferencë shtypi për Silva. Dhe, sipas "Daily Mail", Tiago Alkantara është i zgjedhuri i Pep për "kullën e regjisë" së Mançester Siti. Por, "qytetarët" nuk do të jenë vetëm në këtë betejë, sepse fqinj i tyre, Mançester Junajted, gjithashtu, e ka vendosur në objektivat e veta të merkatos ish-mesfushorin e Barcelonës. Ky operacion mund të kushtojë rreth 65-70 milionë euro. Kujtojmë se Alkantara la "Camp Nou" për të shkuar te Bajern Munihu nga kërkesa e Guardiols, ndaj nuk është çudi që t'i bashkohet ish-trajnerit të tij edhe te Mançester Siti.

Neymar nuk dëshiron të vazhdojë te Paris Sen Zhermen. Dëshira e tij është të luajë sezonin e ardhshëm në Madrid dhe të dielën ai la një tjetër shfaqje të shkëputjes nga ekipi parisien. Derisa shokët e tij u shpallën kampionë të Ligue 1, duke mundur 7-1 Monakon, transferimi rekord botëror (222 milionë euro) ishte në argëtim, duke luajtur poker "on line" në Brazil. Lojtari vetë u ngrit për ta fotografuar "Instagramin" e tij, ku ju mund të shihni se është duke luajtur poker, ndërsa në sfond është imazhi televiziv me takimin PSZH-Monako. I pranishëm në "Parc des Princes" ishte babai i tij. Me titullin e ligës tashmë të fituar, paraardhësi i Neymar Jr dëshiron që PSZH të bjerë dakord të negociojë me Real Madridin për transferimin e djalit të tij. Më 9 mars, "AS" zbuloi taki-

min që u mbajt nga emisarët e Real Madridit, babai i lojtarit dhe dy avokatët, në Paris, për të eksploruar nënshkrimin. Në takim, përfaqësuesit e klubit të bardhë informuan prindin e yllit brazilian për interesin që kanë të nënshkruajnë me djalin, si dhe strategjinë për të bindur PSZH dhe shpërblimet që do të marrë Neymar Jr., bonuse dhe pagë vjetore. Synimi i Real Madri-

dit është mbyllja e operacionit para fillimit të Kupës së Botës dhe PSZH fillon të ketë dyshime rreth vazhdimësisë së Neymarit në radhët e veta. Në fakt, siç është publikuar në "Le Parisien", në mbledhjen e mbajtur shkurtin e kaluar në mes Antero Henrike, drejtor sportiv i klubit të Parisit, dhe agjentit të një lojtari, identiteti i të cilit nuk është zbuluar. Përfa-

qësuesi ishte i interesuar mbi gjendjen e Neymar, pasi projekti i PSZH nuk do të jetë aq tërheqës, nëse braziliani nuk qëndron në skuadër. "A do të qëndrojë Neymar me ekipin në sezonin e ardhshëm?" – ishte pyetja. "Nuk mund ta garantoj atë", – tha Henrike, gjithmonë sipas informacioneve nga mediat franceze, shumë afër PSZH-së.



Të gatshëm të paguajnë çmimin për Levandovskin

Kur u duk se sulmuesi polak i Bajern Munih, Robert Levandovski do të jetë në gjendje të nënshkruajë me Real Madridin, klubit të bardhë i ka dalë një konkurrent i ashpër. "Daily Star", kur vjen puna për të treguar se Çellsit e ka bërë atë objektivin më të madh për sezonin e ardhshëm, flet me siguri. Blutë e Londrës do të paraqesin ofertat për ta mbyllur transferimin. Ata duan që golashënuesi dhe ylli i Bajern Munih të kalojë në "Stamford Bridge" sezonin e ri. Natyrisht, nuk duket të jetë një operacion i përballueshëm, pasi rrethanat e sulmuesit preferojnë të shkojnë te "Los Blancos". Por, problemi është se Çellsit është i gatshëm të paguajë çmimin që kërkohet dhe, në këtë situatë, Florentino Perez nuk dëshiron të hyjë në asnjë betejë, që mund ta bëjnë blerjen e polakut më të shtrënjtë.

Tevez do të përpiqet ta merr Buffonin te Boka



Gjigandët argjentinas të Boka Juniors janë vendosur të bëjnë një lëvizje sensacionale për të marrë legjendën e Juventusit, Gjilanluigi Buffon, pohan "Radio Continental". Ky raport mediatik pohan se Karlos Tevez do të përpiqet ta bindë shokun e tij të vjetër për të shkëmbyer Torinon me Buenos Aires në qershor, në mënyrë që t'i drejtojë përpjekjet e Bokas për të fituar titullin e "Copa Libertadores". Portieri veteran bardhezi nuk është deklaruar akoma nëse do të pensionohet në fund të këtij sezoni, apo jo. Ai do të ulet e të bisedojë me presidentin Anjeli, për të vendosur nëse do të luajë edhe një sezon,

apo do të tërhiqet. Vetë 40-vjeçari ka pohuar herë pas here se nuk do t'i bëhet barrë askujt, por do të luajë sa t'ia lejojë trupi, gjendja fizike. Buffon doli me karton të kuq në çerekfinalen e kthimit të Ligës së Kampionëve, pasi reagoi fuqishëm ndaj penalltisë së akorduar nga kryesori anglez, e cila eliminoi Juventusin në "Santiago Bernabeu". Shumë kanë thënë se kjo ishte ndeshja e fundit e tij në Çampions dhe nuk e meritonte një mbyllje të tillë, megjithatë mbetet të shohim nëse Buffon do t'i varë dorezat në gozhdë. Ai ka oferta, njëra prej të cilave vjen nga gjigandët argjentinas të Boka Juniors.

Me merkaton merret Raiola

Cjigjio Donnarumma i shmanget pyetjeve për të ardhmen e tij te Milani. "Nuk di asgjë për merkaton, me të merret menaxheri im dhe drejtuesit e Milanit. Unë jam këtu për të dhënë maksimumin për ekipin", – tha ai për "Premier Sport", teksa shmangu humbjen e kuqezinjve me Napoli, duke bërë një pritje vendimtare ndaj Milik në minutën e 92-të. Ndryshe, te Milani në sezonin e ardhshëm do të vijë Pepe Reina nga Napoli, por kohët e fundi flitet se edhe Hose Kalehon do të transferohet te kuqezinjët.

"Unë flas vetëm për futbollistët që kam në dispozicion. Kur të vijnë, nëse do të vijnë, do të flas për ta. Unë mbaj fort futbollistët e mi, që për mendimin tim janë më të mirët në botë", deklaroi trajneri Gattuso. Ndërkohë, edhe menaxheri i Milanit, Kristian Abbiati, ka larguar idenë e shkëmbimit, Kalehon-Suso. "Kalehon është një futbollit i madh, por ne kemi Suson që është një kampion dhe po të ishte në dorën time nuk do ta shija kurrë. Pastaj nëse Kalehon dëshiron të vijë, është i mirëpritur", u shpreh Abiati.





E DIJA QË NË SHTATOR SE SITI DO TA FITONTE TITULLIN

“Mendoj se fitorja në 'Stamford Bridge' na dha besimin se ne mund ta fitojmë titullin. Kjo, për shkak se sezonin e kaluar, kundër konkurrentëve të tjerë, nuk ishim aq të mirë. Këtë sezon, në përgjithësi, ishim mjaft të qëndrueshëm”, thotë Pep

Pep Guardiola pretendon se e ka ditur që Manchester Siti do të kurorëzohet kampion i Premier Ligës qysh kur ka mundur Çel-sin në shtator. Trajneri katalanas e pa skuadrën e tij të deklarorë synimet e veta mjaft herët në sezonin 2017-2018, me një barazim 1-1 në shtëpi ndaj Evertonit, në gusht, i pasuar nga 20 fitore në të gjitha garat. Kjo ecuri i çoi “qytetarët” në vendin e parë të kampio-

natit anglez, duke bërë, gjithashtu, përparim pozitiv në “Carabao Cup” dhe në Ligën e Kampionëve. Dy prej këtyre trofeve tani janë siguruar, me Guardiolen që zbulon se e dinte se suksesi ishte në dorën e të tijve, pasi morën një fitore të ngushtë 1-0 ndaj kampionëve të Premier Ligë më 30 shtator. “Mendoj se fitorja në 'Stamford Bridge' na dha besimin se ne mund ta fitojmë titullin. Kjo, për shkak se sezonin e kaluar, kundër

konkurrentëve të tjerë, nuk ishim aq të mirë. Këtë sezon, në përgjithësi, ishim mjaft të qëndrueshëm. Dhe Sergjo Aguero është një gjeni, një lojtar i nivelit të lartë, edhe pse rreth 30 vjeç. Lojtarët e tjerë janë 20, 21 vjeç, kështu që ne fituam me djem kaq të rinj. Duke luajtur në Ligën e Kampionëve në atë moshë, ndonjëherë është e komplikuar. Por, ndoshta do të jetë një mësim për sezonin e ardhshëm. Tani duhet të përqijemi të bëhemi më të mirë. Nëse lexoni atë që njerëzit thonë këtë javë, ne duhet të përmirësojmë disa gjëra”, pohoi Guardiola. “Por, ju nuk mund ta mohoni se ishim të mirë këtë sezon. Çdo javë. Për të fituar 18 ndeshje rresht, ju duhet të jeni mendërisht të fortë. Kjo është e rëndësishme për të ndërtuar klubin. Është e rëndësishme të besoni, sepse Manchester Siti nuk është si Manchester Junajted, Çells apo Arsenal. Ju i dini klubet e mëdha në Angli,



23 TROFETË SI TRAJNER TË PEP GUARDIOLA

ME BARCELONËN

2009 (6 trofe) – La Liga / Liga e Kampionëve / Kupa e Mbretit / Superkupa Spanjolle / Superkupa Evropiane / Botërori i Klubeve;
2010 (2 trofe) – La Liga / Superkupa Spanjolle;
2011 (5 trofe) – La Liga / Liga e Kampionëve / Superkupa Spanjolle / Superkupa Evropiane / Botërori i Klubeve;
2012 (1 trofe) – Kupa e Mbretit;

ME BAJERN MUNIH

2013 (2 trofe) – Superkupa Evropiane / Botërori i Klubeve;
2014 (2 trofe) – Bundesliga / Kupa e Gjermanisë;
2015 (1 trofe) – Bundesliga;
2016 (2 trofe) – Bundesliga / Kupa e Gjermanisë;

ME MANÇESTER SITI

2018 (2 trofe) – Kupa e Ligës / Premier Ligë;

GUARDIOLA, KOLEKSIONISTI I TROFEVE

Pep Guardiola e ka rritur rekordin e tij spektakolar si trajner me titullin e Premier Ligë 2017-2018, të fituar me Manchester Sitin. Ky është trofeu i dytë që merr në krye të “qytetarëve” për këtë sezon, pas Kupës së Ligës, të cilën e fitoi në finale ndaj Arsenalit (3-0), më 25 shkurt. Ish-trajneri i skuadrës katalanase ka gjithsej 23 trofe: 14 me Barçën, 7 me Bajern Munih dhe 2 me Sitin. Guardiola është i barabartë në këtë drejtim me 23 titujt e italianit Xhovanni Trapattoni dhe i afrohet “25” së brazilianit Luiz Felipe Skolari dhe Hoze Murinjo, “26” së skocezit Xhok Stein, edhe pse mbetet ende larg nga “30” e ukrainasit Valerij Lobanovsky, “32” e rumunit Mirçea Luçesku dhe, kryesisht, “49” së rekordmenit skocez, “Sir” Aleks Ferguson.

që kanë një histori të madhe pas tyre. Ne duhet të përqijemi të jemi më konsistentë sezonin e ardhshëm. Do të jetë më e ndërlikuar, por për klubin, lojtarët, të gjitha departamentet në klub, njerëzit mund të besojnë se jemi të mirë: Manchester Siti është një klub i mirë”, përfundoi Pep.

Publicitet

NUMËRIMI FILLOI!

- 7 ditë me OPEL – koha për ofertat më të mira
- Mundësi e papërsëritshme, vetëm njëherë gjatë vitit
- Sasi e kufizuar e veturave

18-25 PRILL 2018



7 ditë legjendare të OPEL.

Sërish në Maqedoni. Vizitoni sallonet e autorizuar dhe zgjidhni një nga modellet e përfshira në këtë ofertë atraktive.

opel.mk



E ARDHMJA I TAKON TË GJITHËVE

Modeli i shfaqur i veturës është vetëm për ilustrim dhe nuk ka të bëjë me këtë promovim. Opel Southeast Europe LLC dhe shitësit e autorizuar mbojnë të drejtën për të ndryshuar ose tërhequr ofertën në çdo kohë dhe pa njoftim paraprak. Për më shumë informacion kontaktoni shitësit e autorizuar Opel. Oferta vlen deri më 25.04.2018.

Auto CEM 044 353 330

Automakedonija 02 310 31 30

Ja rreziku që mund t'ju vijë nga antibiotikët



Këto janë imazhet tmerruese të një gruaje e cila përjetoj një reaktion të pamagjueshëm në 90% të trupit të saj pasi mori shumë antibiotikë. Sandy Duperval, 36 vjeç, mori sëmundjen toksik epidermal, që e la të luftonte me jetën e saj në spital. Mjekët e përshkruan diagnozën e saj si një infeksion që ajo e ka patur në trupin e saj 7 vite më parë. 10 ditë më pas ajo mori sëmundjen që për pak i mori jetën nga konsumi i shumë të antibiotikëve.

Ajo shkoi menjëherë në spital pasi gjendja e saj u përkeqësua, por mjekët e paralajmëruan familjen e saj se ajo mund të mos e kalonte natën. Megjithatë, këngëtarja nga Toronto, Kanada, ia doli me anë të një operacioni. Ajo që prej asaj kohe e ka ndarë me të tjerët sëmundjen e saj për t'i inkurajuar.



I thonë njëri-tjetrit "PO" në shtëpinë e të moshuarve



Maria, 90 vjeçe dhe Umbertoja, 85, kanë kurorëzuar ëndrrën e jetës së tyre pas 50 vjetësh së bashku. Të martuar në fakt në vitin 1971, me ritin civil "për mungesë të kohës", pas takimit të tyre të parë disa vite më parë në një festë në Alassio (Savona), çifti ka mundur më në fund të organizojë martesën fetare në brendësi të shtëpisë së pushimit në Bussero (Milano), ku nusja ndodhet prej muajit maj të vitit të shkuar. Një festë e madhe për të ftuarit, por edhe për rezidentët dhe punonjësit e Shtëpisë së Familjes për të Moshuarit. "Në vitin 1971 u martuam vetëm duke përgatitur letrat në gjendje civile për mungesë të kohës, -ka shpjeguar Imberto Maggiu, ish-drejtues i Poliklinikës së San Matteo të Pavia. - Unë isha i zënë nga puna në sallën operatore dhe në përgatitjen e relacioneve të shumta për të përgatitur për kongreset kombëtare dhe ndërkombëtare, ku isha thirrur të merrja pjesë", -është justifikimi i dhëndrit.



Përse na rrjedh gjak nga hundët?

Kur hunda juaj ka gjakderdhje, ajo shpesh ndodh si pasojë e sinusit, alergjisë apo të ftohtit, ajrit, e që mund të bëjë hundën tuaj shumë të ndjeshme. Sidomos tek vajzat kur ato janë afër ciklit menstrual, ndodh që hormonet mund të shkaktojnë gjak nga hundët. Mirëpo, gjakderdhja nga hunda ndodh më së shpeshti të njerëzit më të moshuar se 50 vjeç. Në mënyrë që gjakderdhja nga hundët të ndalojë, duhet të mbajmë kokën lartë për disa minuta, po ashtu gishtin tregues duhet t'a mbajmë me presion në anën ku kemi pas gjakderdhje përreth 3 minuta. Por nëse gjakderdhja fillon të bëhet përditshme, atëherë është e rëndësishme që të vizitoni mjekun për të mësuar arsyet e vërteta të kësaj gjakderdhje.

Ku përfundon jashtëqitja e tualeteve të aeroplanit?



Ka shumë gjëra që nuk e dimë me saktësi se si funksionojnë. Ta zëmë, guaska e zakonshme e tualetit nëpër shtëpitë tona i largon mbetjet përmes ujit dhe i dërgon në sistem të kanalizimit. Por, në aeroplanë të udhëtarëve ky sistem nuk mund të jetë i njëjtë. Tualeti i aeroplanëve moderne ishte shpikur nga James Kemper më 1970. Më parë, pasagjerët ishin të detyruar që jashtëqitjet t'i bënin brenda një kove të zakonshme nëpër banjo të aeroplanëve. Sistemi vakum i Kemperit së pari u nxor në përdorim në aeroplanët Boeing më 1982. Kur pasagjerët shtypin një buton të posaçëm, përmes vakumit pneumatik i merr dhe i izolon mbetjet brenda një sistemi të mbyllur të jashtëqitjeve. Megjithatë, përkundër gojëdhënave, piloti nuk e ka mundësinë të lëshojë mbetjet njerëzore direkt nga ajri, por sistemi pastrohet kur aeroplani të ketë ateruar në tokë.

858 - Benedikti III përfundon sundimin e tij si Papë Katolik
1492 - Kristofor Kolombo nënshkruan marrëveshje me Spanjën për gjetjen e rrugës për Indi
1524 - Giovanni Verrazano, a florentine navigator, discovers New York Bay
1704 - Gazeta e parë e suksesshme në SHBA botohet në Boston nga Xhon Kam-bell
1711 - Karli VI i Habsburgëve shpallet mbret i Austrisë
1793 - Beteja e Varshavës
1865 - Arrestohet Mari Surrat si konspirator në atentatin ndaj Abraham Linkolnit
1907-11,745 imigrant arrijnë në Ellis Island, NY
1920 - Formohet NFL (Liga profesionale e futbollit amerikan)
1924 - Metro Pictures, Goldwyn Pictures dhe Louis B Mayer Co shkrihen dhe formojnë MGM
1939 - Stalini nënshkruan paktin anti-nazist mes Britanisë, Francës dhe Rusisë
1941 - Lufta e II Botërore: Mbretëria e Jugosllavisë i dorëzohet Gjermanisë
1946 - Siria shpall pavarësinë nga Administrata franceze
1971 - Formohet federata mes Egjiptit, Libisë dhe Sirisë (FAR)
1982 - Kanada miraton kushtetutën e saj.

KALENDARI HISTORIK 17 PRILL

Peshkaqenët dhe peshqit raxha, janë të vetmet kafshë të njohura nga njeriu, që nuk preken nga kanceri. Shkencëtarët besojnë se kjo ka të bëjë me faktin se ata nuk kanë kocka, por kërce në trupin e tyre.



Argjendi i pastër nuk është realisht i tillë. Për shkak se argjendi i pastër është shumë i butë, dhe për të qenë i përdorshëm në shumicën e sendeve, përzihet me bakër në raportin 92.5 për qind argjend me 7.5 për qind bakër.



Krimbi Caenorhabditis Elegans ka ekuivalentin moshor të 5 viteve jetë njerëzore për çdo ditë që jeton, kështu që ata zakonisht ngordhin pas rreth 14 ditësh. Por kur janë të stresuar, bien në një gjendje kome, e cila mund të zgjasë për dy ose më shumë muaj.



GRUAJA DHE KOKA

- Grua, sot isha te mjeku. Ma fotografuan kokën, por nuk gjetën asgjë! - iu drejtua burri gruas.
- Këtë edhe e kam pritur! - i përgjigjet grua.



Çdo ditë të dhurohen njëzet e katër orë të arta; janë nga të paktat gjëra që, në këtë tokë, të janë dhuruar gratis. Përdori sa më mirë të jetë e mundur.
(Nikolas Spark)

THËNIA E DITËS

A E DINI SE...

BARSOLETA